



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë:	16.03.2022
Referencë:	15-030101-14499
Nga:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
Për:	z.Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal
Lënda:	Raporti vjetor Janar – Dhjetor 2021 i punës së zyrës së kryetarit dhe Drejtorateve Komunale



Me anë të kësaj shkresë po ju dërgojmë raportin vjetor Janar – Dhjetor 2021 i punës së zyrës së kryetarit dhe drejtorateve komunale.

Shtojcë:

Raporti vjetor Janar – Dhjetor 2021 i punës së zyrës së kryetarit dhe drejtorateve komunale.



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



R A P O R T
I PUNËS I ZYRËS SË KRYETARIT DHE
DREJTORATEVE KOMUNALE
JANAR – DHJETOR
2021

Mars, 2022

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit.....	3
Përbledhje Ekzekutive.....	5

ZYRA E KRYETARIT

1. Zyra e Protokollit	5
2. Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore	5
3. Avokatja Publike Komunale	6
4. Sektori për Marrëdhënie me Publikun	8
5. Njësia për Auditim të brendshëm	9
6. Sektori i Personelit	10
7. Sektori pronësor – juridik	12
8. Zyra Lokale për Komunitete	13

DREJTORATET KOMUNALE

1. Drejtorati për Administratë.....	14
2. Drejtorati për Arsim	18
3. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport	26
4. Drejtorati për Buxhet dhe Financa	28
5. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim	40
6. Drejtorati i Inspektoriatit	43
7. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	44
8. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....	54
9. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër	58
10. Drejtorati i Shërbimeve Publike	59
11. Drejtorati i Prokurimit.....	64
12. Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari	68
13. Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim.....	71

FJALA HYRËSE E KRYETARIT

Të nderuar këshilltarë, qytetarë, media dhe gjithë ju të pranishëm në këtë mbledhje të Kuvendit Komunal të Lipjanit, më lejoni që para jush të prezentoj raportin vjetor, Janar-Dhjetor 2021, të punës së zyrës së kryetarit dhe drejtoreve komunale.

Kjo periudhë raportuese, paraqet veprimet administrative dhe punën e përditëshme menaxheriale të ekzekutivit, shërbimit profesional - administrativ të komunës me synime në përmbushjen e objektivave bazuar në priorititet e definuara edhe në axhenden buxhetore të vitit 2021. Pra, ky raport vjetor përmbanë rezultatet e arritura, vështërësitë dhe sfidat që kanë përcjellë punën tonë në periudhen raportuese.

Padyshim që edhe viti 2021 mund të cilësohet vit i pandemisë Covid -19, megjithatë mundë të konstatohet i suksesshëm bazuar në parametrat zhvillimore dhe duke marrë parasysh realizimin e objektivave të planifikuara.

Shikuar në aspektin e realizimit të tē hyrave si dhe në shpenzimin e buxhetit të planifikuar është shënuar disiplinë dhe ritëm i veçantë, duke vendosur standarde mbi mesataren e kënaqëshmërisë në nivel vend. Viti 2021 shënon progres financiar në aspektin e tē hyrave vetanake të komunës në të gjitha kategoritë, me theks të veçantë tatimit në pronë. Buxheti i miratuar i komunës së Lipjanit për tē hyrat vetanake për vitin 2021 ishte në vlerë 1,907,316.00€ dhe janë realizuar tē hyra në vlerë 2,425,741.34€. Pra, tejkalimi i tē hyrave vetanake është 518,425.34€, ose shprehur në përqindje 27.18%. Ndërsa shpenzimi i buxhetit komunal për vitin 2021 është realizuar në vlerë 17,808,413.89€, ose shprehur në përqindje 96.09%. Kjo shkallë e realizimit të buxhetit shënon nivelin më të lartë të administrimit dhe shpenzimit të buxhetit.

Gjatë vitit 2021 janë realizuar rreth 110 projekte investive në teren, kryesisht në rrugë, trotuare, ndriçim publik, kanalizime, ujësjellës, objekte e fusha sportive, në shkolla e ambiente shkollore, në lumenjtë dhe hapësira gjelbëruese si dhe në mirëmbajtjen e tyre dhe këto projekte të realizuara përbëjnë pjesën kryesore të investimeve kapitale.

Këtu padyshim dua të veçoj projektet: Shtigjet e ecjes rreth shtratit të lumbit Sitnica, përrurimin e tri shtatoreve në qytetin e Lipjanit, të dëshmorëve Haredin Bajram dhe Xhavit Kozhani, si dhe të humanistikës dhe veprimitarit, Ruzhdi Shabani, ndërtimi i shëtitores te pishat në Gadime, objekti shtesë i shkollës "Vëllëzërit Frashëri" në Lipjan, shkolla e mesme në Gadime, poligoni sportiv në gjimnazin "Ulpiana" në Lipjan, ndriçimi publik në qytetin e Lipjanit, renovimi i objektit të Stomatologjisë, mirëmbajtja e hapësirave publike në tē gjitha vendbanimet etj.

Disa projekte të tjera me rëndësi të veçantë drejt finalizimit janë edhe renovimi i objekteve shumëbanesore në qytetin e Lipjanit, palestra sportive si dhe objekti i ri i Administratës së Komunës në Lipjan.

Në fushën e arsimit, jemi angazhuar për krijimin e kushteve sa më të mira duke i dhënë një prioritet tē veçantë investimeve dhe realizimit të projekteve në infrastrukturën shkollore, në ndërtimin e hapësirave të reja dhe renovimin e atyre ekzistuese, furnizimin e shkollave me inventar, paisje të teknologjisë informative dhe ndërtimin e sallave sportive. Por, edhe këtë vit për shkak të Covid - 19, jemi ballafaquar me probleme dhe sfida të vazhdueshme në funksionimin e mirëfillt tē institucioneve edukativo-arsimore, siç janë orari i shkurtër i orës mësimore, ndarja e klasëve në grupe, masat parandaluese për Covid-19 etj.

Në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit kemi ndarë subvencione për Klube Sportive dhe për Organizata Jo Qeveritare për organizimin e aktiviteteve sportive, rinore e kulturore si dhe kemi investuar në rregullimin e infrastrukturës sportive në qytetin tone. Në vitin 2021 për herë të parë është filluar me mirëmbajtjen e shtatoreve, lapidareve dhe varrezave në tërë territorin e Komunës së Lipjanit.

Viti që lam pas në fushën e bujqësisë ka shënuar rritje tē subvencionimit të fermerëve me serra nga Komuna e Lipjanit, ndërsa në bashkëpunim në mes të komunës dhe organizatave të ndryshme, janë shpërndarë edhe mekanizëm bujqësor.

Administrata komunale ka vazhduar tē ketë përformancë të mirë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Ndjehem mire që komuna jonë është vlerësuar lartë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, tē cilat merren me matjen e përformancës komunale. Pra, në raportet e monitorimet siç janë: MAPL, GiZ, DEMOS, KDI dhe Instituti GAP përsëri është

konfirmuar që mbetemi komuna me transaprencën më të lartë, në veçanti në transparencën e prokurimit publik ku jemi renditur e para në nivel vendi.

Gjatë vitit që lam pas bashkëpunimi me institucionet relevante ndërkombe të ka qenë mjaft produktiv dhe janë realizuar disa projekte siç janë projektet me Demos, projektet me Giz, CDI, Sfidat e Mileniumit, Chatar Qarity, IADK etj.

Pas të gjitha sfidave, unë ndjehem mirë për rezultatet e arritura dhe dua të falënderoj të gjithë qytetarët e Lipjanit dhe partnerët vendor e ndërkombe të përkushtuar e përbashkëta gjatë kësaj periudhe raportuese.

I nderuar Kryesues,

Të nderuar Këshilltar Komunal,

Të nderuar të pranishëm,

Përgjithësisht mund të konstatojm se vitin 2021 është vazhdimësi e angazhimeve dhe përkushtimit në përputhje me përgjegjësitë tona ligjore në implementimin e objektivave për qeverisje komunale transparente dhe përmbrushjen e standardeve për qeverisje të mirë me impakt në mirëqenien e qytetarëve.

Ne patjetër se do vazhdojmë të përkushtohemi në konsistencë për të mbajtur ritmin dhe dinamikën e punës për ta shendërruar administratën komunale në funksion dhe shërbim të qytetarëve dhe objektiv e përhershme e jona mbetet qeverisja e ligjshme, transparente dhe llogaridhënëse.

Raporti në fjalë përfshinë në mënyrë të detajuar punën dhe aktivitetet e ndryshme të secilit drejtorat të Komunës.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport për vitin 2021, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara nga Kryetari i Komunës dhe qeverisja lokale. Raporti është në përpjekje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Në periudhen Janar-Dhjetor 2021 angazhim kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale ka qenë përkushtimi për zbatimin e rendit, ligjit dhe disiplinës në punë. Në vazhdim po e paraqesim raportin që përmban informata për punën e Zyrës së Kryetarit dhe të gjitha Drejtoreve dhe zyrave në kuadër të komunës.

ZYRA E KRYETARIT

ZYRA E PROTOKOLLIT

RËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Zyra e protokollit gjatë periudhes reportuese janar – dhjetor 2021 është angazhuar maksimalisht për organizimin sa më të mirë të të gjitha aktivitetave të organizuara nën patronatin e Kryetarit të Komunës si dhe organizimin e takimeve të ndryshme.

Në vitin 2021, Zyra e Protokollit në Komunën e Lipjanit ka kryer këto punë:

- Organizimin e takimeve protokollare të kryetarit të komunës;
- Evidencimin dhe mbikqyrjen e takimeve të kryetarit të komunës;
- Organizimin e takimeve të kryetarit me qytetarët e komunës së Lipjanit;
- Organizimin e dy takimeve publike ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale;
- Bashkëpunim me drejtoret e komunës për aktivitetet e organizuara nën patronatin e kryetarit.

SEKTORI PËR PËRFAQËSIM DHE ÇËSHTJE LIGJORE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës reportuese vazhdimi është bërë përcjellja e dispozitave ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës.

Sipas kërkesave të Drejtoreve të Komunës dhe sektorëve të komunal janë dhënë këshilla juridike në përgatitjen e akteve nga kompetenca.

Konform dispozitave ligjore në fuqi, në vitin 2021 janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimitaria e Komunës në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës janar-dhjetor 2021, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore pa lëndët e përfaqësimit nga kompetenca e Avokates publike komunale me kërkesë të Kryetarit ka përgatitur Vendime, Urdhëresa, Shkresa të ndryshme, Marrëveshje, Kontrata, Propozim Rregullore dhe Propozim Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës të cilat i kemi specifikuar në tabelën në vijim:

STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore për periodën janar-dhjetor 2021:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendimet	414
2.	Shkresat	409
3	Urdhëresa	6
4.	Kontrata	28
5.	Marrëveshje	2
6.	Propozim Rregullore	6
7.	Propozim Vendime	30

Nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2021 në pajtim me dispozitat ligjore sipas vendimeve të kryetarit të komunës janë shpenzuar të gjitha mjetet e planifikuara në këtë kategori.

SFIDAT

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur sfide si pasoj e pandemise Covid - 19 edhe në vitin 2021 e cila në shumë raste na ka penguar apo kufizuar për mbajtjen e takimeve me publikun me numër më të madh qytetarësh për prezentimin – konsultimin e Draft- Rregulloreve, Draft planeve dhe dokumentacionin tjetër me rëndësi për publikun.

REKOMANDIME

Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore rekomandon që muajve në vijim të ketë një përkushtim edhe më të madh nga ana e të gjitha drejtorateve dhe sektorëve që në vazhdimi të përcjellin dispozitat ligjore nga fushëveprimtaria dhe kompetenca e Drejtoret, Zyrës apo Sektorit përkatës në veçanti gjatë hyrjes në fuqi të dispozitave të reja ligjore nevojitet një koordinim dhe bashkëpunim më i madh me Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore me qëllim të harmonizimit të tyre me aktet e Komunës.

AVOKATJA PUBLIKE KOMUNALE

Përbledhje e përgjithshme e raportimiti:

Sipas lëndëve të pranuara nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruesa në regjistrin e lëndëve Avokatja Publike Komunale brenda afatit të kërkuar bën këtë raport të punës me sa vijon;

Lëndë të bartura nga vitet paraprake janë 984 lëndë, ndërsa të pranuara deri me dt.31.12.2021 janë 444, në procedurë kanë qenë gjithsej 1428 lëndë.

- Në procedurë janë 1224 lëndë
- Të përfunduara janë 204 lëndë

Në procedurën administrative kemi bashkëpunuar me të gjitha drejtoret komunale për sigurimin e provave materiale për seancat gjyqësore dhe kompletimi i lëndëve por kemi dhënë edhe ndihma juridik kur kanë kërkuar drejtoret përkatëse.

Punët dhe aktivitetet e realizuara:

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 315 seanca gjyqësore, kemi ushtruar 54 ankesa, 383 përgjigje në padi në procedurë civile, procedurë përmbaruese kemi ushtruar 39 propësime, 128 ankesa, kemi ushtruar 8 propozime për ekzekutim tek përmbaruesit privat 3 lëndë janë për tatimin në pronë, 3 lëndë janë për shpronësimit të pronës komunale dhe 2 janë për lokale afariste, kemi ushtruar 2 padi në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme dhe një propozim për caktimin e vlerës

së pronës së vlerësuar nga MF-Departamenti për vlerësimin e pronave në Gjykatën Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan si dhe kërkesa –parashtresa të tjera sipas nevojës në të gjitha procedurat.

Si palë e dëmtuar kemi marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore në procedurë penale duke propozuar që kërkesa pasurore juridike të realizohet gjatë të njëjtës procedure për dëmin e shkaktuar për se cilën lëndë veq e veq.

Statistikat:

Paraqesë skemën tabelave të lëndëve në procedura të ndryshme dhe atë me sa vijon:

Nr.	Llojet e procedurave	Lëndë të bartura	Lëndë të Pranuara	Nr. i përgjithshëm i lëndëve	Lëndë në Gj.Th.P-Dega ne Lipjan – P.Privat	Lëndë në Gjykatë Apelit	Lëndë në Gjykatë Suprem	Lëndë Poedur Administrative	Lëndë të Kryera	Lëndë në Procedurë
1.	Procedurë penale	15		15	/	/	/	/	5	10
2.	Procedurë civile	640	387	1027	970	54	3	/	27	1000
3.	Procedurë përmbaruese	329	38	367	239	128	/	/	153	214
4.	Procedurë administrative	0	19	19					19	0
5.	Gjithsejtë	984	444	1428	1209	182	3		204	1224

Në procedurë civile për lëndët e ish „Kosovatransit“ janë 10 lëndë që kërkojnë kompensimin e të ardhurave personale prej vitit 1990 deri 1999 duke u bazuar në Aktit për pranim dorëzim të ish „Kosovatransit“ në mes të AKP-së dhe Komunës së Lipjanit të nënshkruar në vitin 2012 dhe shuma e këruara për të gjitha lëndët është **113,335.43€**, e krejt kjo është si pasoj e pranimit të NP „Kosovatrans“ në Lipjan sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike dhe aktit të cekur ma lart, lidhur me këtë çështje në procedurë është edhe një lëndë me numër të përgjithshëm të punëtoreve prej 83 punëtorë të cilët kërkojnë kthim në punë dhe kompensim e të ardhurave personale nga viti 1990 deri 1999.

Në kontest civile gjithsej janë 1027 lëndë disa prej tyre janë fituar e disa janë humbur por janë në shkallën e dytë ndërsa shumica prej tyre janë në procedurë siq shihet në tabelën.

Në procedurë përmbaruese në vitin 2021 janë gjithsejtë 367 lëndë prej tyre janë ekzekutuara 153 lëndë në shumë prej **251,086.30 € + kamata dhe shpenzimet e procedurës**, ndërsa të pa ekzekutuar janë 214 lëndë dhe borxhi i mbetur i komunës-debitorit deri ne ketë fazë mund të jetë **254,231.52 € + kamata dhe shpenzimet e procedurës** i cili borxh është i punëtorëve të arsimit, punëtorëve të shëndetësisë, shpronësim dhe Operatorë Ekonomik.

Në procedurë penale janë të përfunduara 5 lëndë ndërsa lëndë tjera që aktgjykimet janë bërë të plotfuqishme po nuk po ka mundësi të ekzekutohen për shkak të çështjeve të pa definuar në mes të MBZHR dhe komunës e që kanë mbetur pa u ekzekutuar deri me tanë, por ne me një parashtresë ja kemi dërguar mbi 80 aktgjykime MBZHR- Agjencisë së Pyjeve të Kosovës dhe tanë ky agjencion është duke ekzekutuar këto lënd me përmbarues privat.

Çështje tjetër që mbetet të rregullohet është edhe çështja e zjarrfikësve në mes të Komunës dhe MPB-Agjencinë e Emergjencës së Kosovës nga se është i pa definuar mire statusi i tyre se punëtorë të kujt janë, ndërsa Komuna pritet që për se cilin punëtor-zjarrfikës ti paguan përafërsisht nga **5000€ për punën gjatë festave, ndërrimin e natës, fundjavës dhe shtesat tjera që po i kërkojnë shpenzimet e udhëtimin dhe shujtën**.

SFIDAT

Gjatë periudhave raportuese të kaluara por edhe kësaj periudhe, kanë qenë sfidë kryesore që edhe kanë paraqitur problem gjatë mbrojtjes ligjore të interesave të Komunës, mungesa e dokumentacioneve nga arkiva dhe mangësia, vështirësitë për gjetjen e dokumenteve arkivore të viteve të paraluftës.

Gjithashtu sfidë tjetër është edhe e Kontratave kolektive të arsimit dhe shëndetësisë në të cilat Komuna nuk është fare nënshkruese e tyre por janë ministritë përkatëse, të cilat nuk kanë menduar fare për gjetjen e mënyrës së ekzekutimit të obligimeve që rrjedhin nga këto kontratë në procedurë administrative në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i komunave në procedurë gjyqësorë dhe të krijohen shpenzime të pa nevojshme.

Rekomandime:

Në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës – Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të gjindet zgjidhje për kërkesat që dalin nga Kontratat Kolektive Sektoriale e poashtu të definohet statusi i zjarrëfikëve pëershakak të dualitetit dhe përzirjes së komceptencave mes të AME-së dhe Komunës.

SEKTORI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Sektori për Marrëdhënie me Publikun në vitin 2021 është angazhuar maksimalisht në realizimin e detyrave dhe përmbushjen e obligimeve në mënyrë që Komuna e Lipjanit tē vazhdoj tē jetë në mesin e komunave të para sa i përket transparencës dhe llogaridhënieve.

Edhe në këtë vit, Komuna e Lipjanit ka qenë e hapur për qytetarë. Në web faqen zyrtare të Komunës janë publikuar materiale të ndryshme në mënyrë që qytetarëve tu ofrohen të dhënët e nevojshme. Kjo web faqe ka qenë edhe një udhëzim shështë dhe transparent në të cilën janë publikuar të gjitha vendimet, shkresat, njoftimet, rregulloret, raportet e shpenzimeve financiare, kontrata, planifikimi i buxhetit, ndarja e subvencioneve si dhe shumë material tē tjera.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë vitit 2021, Sektori për Marëdhënie me Publikun ka kryer punët në vijim:

Është bërë përcjellja e aktiviteteve të kryetarit të komunës, aktiviteteve të tjera komunale brenda dhe jashtë komunës dhe pastaj përgaditja e lajmeve për publikim në web faqen zyrtare, rrjetet sociale si dhe në media të ndryshme;

Sipas kërkesave të Drejtoreve dhe sektorëve të tjerë janë publikuar materialet e ofruara për zyrën e informimit;

Janë publikuar ne web faqe të gjitha vendimet e kryetarit, gjitha vendimet dhe rregulloret nga sektori i Kuvendit në gjuhen shqipe dhe në gjuhen serbe; Publikimi i raporteve të drejtoreve për çdo muaj; Po ashtu janë publikuar në web faqe vendime, njoftime dhe konkurse të shumta të cilat janë ofruar në zyrën për informim; Konkurset me kërkesen e përgjegjësve janë publikuar në gazeten ditore.

Gjithashtu është bërë publikimi i kontratave të prokurimit sipas kërkesës nga Drejtoreti i Prokurimit, si dhe është bërë edhe publikimi i vendimeve të OSHP-së dhe vendimet e autoritetit kontraktues.

Në vitin 2021 janë vizituar të gjitha projektet që janë implementuar në terren dhe janë bërë fotografi për nevoja të zyrës si dhe të njejtat janë arhivuar, ku po ashtu janë vizituar shumica e punëve që janë bërë dhe janë duke u bërë në teren duke marrë pamje me kamerë për nevojat e zyrës për infomim. Janë ofruar informata për gazetarë duke ju referuar kërkesave të tyre si dhe janë pranuar dhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike. Është bërë përgaditja e Buletinit për qdo muaj si dhe përgatitja e reportazhit për vitin 2021 si dhe punë tē tjera që dalin në kuadër të zyrës për informim.

STATISTIKAT

Sektori për Marrëdhënie me Publikun gjatë vitit 2021 ka publikua mbi **260** lajme/ informacione në web faqen e Komunës, kemi pranuar gjithësej **25** kërkesa për qasje në dokumente publike dhe të gjithave u është lejuar qasja. Janë publikuar në web faqen dy raporte të kryetarit dhe plani i punës për vitin 2021, është bërë publikimi i mbi **82** vendimeve të kryetarit, janë publikuar **120** njoftime, **29** konkurse, **18** marrëveshje, **35** vendime tē kuvendit **6** rregullore, **1** plan, **10** shqyrtime publike, të gjitha kontratat e nënshkruara nga Prokurimi, vendimet e OSHP-së dhe vendimet e Autoritetit kontraktues drejtar operatorëve, pra rreth **853** dokumente të ndryshme tē prokurimit, **156** raporte tē drejtoreve, publikimi i të gjithë materialit për seancat e mbajtura në vitin 2021, mbi **46** Procesverbaleve dhe ftesa tē kuvendit dhe komitetet e komunitetit si dhe materiale tē tjera të ndryshme me interes për publikim, të cilat ka pranuar sektori ynë në vitin që lamë pas. Përditësim i vazhdueshëm i web faqes së Komunës me material tē ndryshme e në interes tē qytetarëve, publikimi edhe i akteve komunale në gazetën zyrtare tē Republikës së Kosovës.

Janë ralizuar mbi **1600 foto** të projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme mbi **29 video** ngjarje – transmetime live si dhe është bërë Mirëmbajtja e panellevës në hyrje të qytetit të Lipjanit,

Menaxhimi i 2 Kontratave per Sherbime mediale.

SFIDAT

-Sfidë që na ka përcjellur gjatë gjithë vitit ka qenë problemet e shfaqura të kohë pas kohshme rreth funksionimit normal të web faqes zyrtare të komunës.

NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Plani strategjik për vitet 2021-2023 , dhe plani vjetor i punës për vitin 2021 , pas përpilimit nga udhëheqësi i NJAB-së janë prezantuar për shqyrtim në Komitetin e Auditimit dhe pas miratimit të tyre janë aprovuar nga Kryetari i Komunës dhe janë dërguar edhe në NJQHAB.

Në përputhje me Planin Strategjik për vitet 2021-2023, është hartuar edhe plani vjetor i punës për vitin 2021. NJAB ka filluar së implementuari detyrat e parapara me Planin e aprovuar vjetor të Punës që ti kryej Auditimet e sigurisë sipas këtij plani.

Me Ligjin e Auditimit të Brendshëm nr 03/L-128, Komiteti i Auditimit është kompetentë për aprovimin e planeve të Njësisë së auditimit të brendshëm dhe raporteve te punës dhe ndërmjetësues në mes të Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe ZKA me qëllim të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Njësia e auditimit të brendshëm.

Angazhimi i NJAB në vitin 2021 ka pasur për objektiv realizimin e auditimeve të planifikuara sipas planit të punës të aprovuar për vitin 2021 dhe kryerjen e rishikimeve për auditimet e kryera, pas pranimit të planit të zbatimit të rekomandimeve nga drejtoret e drejtive ku është kryer auditimi dhe përbajtjes së orarit për rishikim të cilin NJAB i dërgon me Raportin Final, ndërsa NJAB pas rishikimit ka përgatitur informatë me shkrim së bashku me formularin 4001 , me të cilën ka njofuar edhe ZKA-në lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve nga NJAB.

Puna që është kryer gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021, i referohet pikërisht përbushjes së objektivave të parapara me këto Plane të cekura më lartë.

Me planin e punës të aprovuar të NJAB-së për vitin 2021 , kishte planifikuar 10 detyra Auditimeve rregullta për dhënie të sigurisë.

PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë vitit 2021 NJAB ka Finalizuar 10 Raporte të Auditimit të cilat janë kryer në këto entitete:

- 1.) Auditimi i procedurave të prokurimit për Vitin 2020 Fushëveprimi: 01.01.2020 - 31.12.2021.
- 2.) Auditimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë Periudha Janar 2020 – Janar 2021
- 3.) Auditimi i të hyrave nga lejet ndërtimore ne Drejtorinë për Urbanizëm dhe mbrojtje të Mjedisit, periudha prej 01.08.2019 - 31.07.2020.
- 4.) Auditimi i shpenzime në drejtorinë Komunale të Arsimit për periudhën Korrik 2019 – Mars 2021
- 5.) Auditimi i zyrës për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën 01.05.2019 – 30.04.2021
- 6.) Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë- Fushëveprimi 01.07.2019 – 30.06.2021.
- 7.) Auditimi i procedurave për menaxhimin e kontratave me rastin e implementimit të projekteve në Drejtorinë për Shërbime Publike për periudhën Qershori 2020 - Qershori 2021
- 8.) Auditimi i të hyrave nga participimi i qytetarëve për shërbime mjekësore në QKMF – DSHMS
- 9.) Auditimi i Shpenzimeve në Administratën Komunale (13 programet buxhetore) prej fushëveprimi: prej 01.10.2020. - 30.09.2021
- 10.) Regjistrimi dhe Menaxhimi i Pasurive Komunale për periudhën 01.11.2020 – 30.10.2021

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2021 , NJAB ka monitoruar edhe shkallën e implementimit te rekomandimeve te cilat janë dhënë me rastin e kryerjes së auditimeve të brendshme dhe për të cilat menaxhmenti (zyrtarët përgjegjës të entitete ku është kryer auditimi), ka përgatitur planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të NJAB-së.

-Në këtë periudhë janë kryer edhe 8 Rishikime të auditimeve sipas orarit të paraparë për rishikim.
-Të gjitha raportet finale janë dorëzuar për përgjegjësitë e entiteteve të audituara dhe Zyrës së Kryetarit dhe Komitetit të Auditimit.

STATISTIKAT

10 Auditime të rregullta të planifikuara janë përfunduar sipas planit vjetor të punës të ndryshuar për vitin 2021 dhe 9 Rishikime të Auditime të kryera më herët nga NJAB me qëllim të monitorimit të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe dërgimi informative të shkruara përgjegjëse të entiteteve të audituara dhe menaxhmentit (kryetarit të komunës) lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve.

-Eshtë mbajtur një trajnim me USAID me temën sigurimi i cilësisë së auditimit dhe Auditimet e performances si dhe takimi lidhur me prezantimin e përmbytjes së kritereve përfomancë nga lëmia e financave, prokurimit, burimeve njerëzore dhe auditimit të brendshëm – me DEMOSIN.

Gjatë këtij viti janë mbajtur edhe pesë takime të rregullta me Komitetin e Auditimit ku janë shqyrtuar raportet e punës së NJAB-së për periudhat:

Takimi i parë është mbajtur me komitetin në Muajin Janar 2021, për shqyrtimin e raporteve të punës së NJAB-së për periudhën TM4-2020,

Takimi i dytë për raporti për Tremujorin e parë 2021, (TM1-2021) takimi është mbajtur në Muajin Prill - 2021.

Takimi i tretë me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e dytë (TM2-2021) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Korrik 2021.

Takimi i katërt me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e tretë (TM3-2021) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Tetor 2021 .

Takimi i pestë me Komitetin e Auditimit për aprovin e planit strategjik të NJAB-së për vitet 2022-2024 dhe planit vjetor punës për vitin 2022 është mbajtur më 23.12.2021 .

SFIDAT

Pjesëmarrja në trajnimet të cilat organizohen nga IKAF lidhur e Auditimin e brendshëm me qëllim të plotësimit të obligimit ligjor për sigurimin e 30 orëve për EVP për auditorët e brendshëm.

Vazhdimi i pandemisë dhe paraqitja e problemeve me mungesa të zyrtarëve të cilët janë identifikuar me kovid.

REKOMANDIME

-Trajnimet për qasje në sistemin e Fri- ballancit

Vlerësimi i Rrezikut nga menaxhmenti dhe monitorimi i rregullt i rrezikut.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga NJAB-së dhe atyre nga ZKA –it

SEKTORI I PERSONELIT

PËRMBLEDHJA E PËRGHITHSHME E RAPORTIMIT

Në kuadër të fushës veprimtarisë së saj dhe në përputhje me kornizat ligjore në fuqi, që përfshinë shërbimin civil dhe atë publik të Komunës së Lipjanit, Sektori për personel është angazhuar në kryerjen e punëve me përgjegjësi të plotë në hartimi e vendimeve dhe shkresave brenda fushëve përgjegjës të Sektorit për Personel, vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe koordinimin e trajnimeve të stafit, Rregullimin dhe digitalizimin e dosjeve të stafit dhe futjen në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe ne dosje personale, të tjera ndryshimet, transferimet, pagesat retroaktive, largimet bëhen nga Zyra e Personelit për Sistem të Pagave si dhe (kërkesa të ndryshme individuale të stafit: pushime, vërtetime) etj.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Sektorit për Personel ka sistemuar formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të zyrtarëve duke i vendosur nëpër dosje fizike dhe elektronike si dhe raportimin pranë MPB/MAP – it për përqindjen e vlerësimit, përgatitja e planit të trajnimit për vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe koordinimin e trajnimeve të stafit duke ju drejtuar me një kërkesë të tillë MPB/MAP – it , punimi i vendimeve të ndryshme sipas kërkesave të palëve dhe zyrtarëve të administratës komunale kërkesa të ndryshme individuale të stafit: pushime, vërtetime etj, si dhe përgatitja e formularëve për ndryshime, transferimet, pagesat retroaktive për Sistem të Pagave.

STATISTIKAT

Për më shumë, në formë statistikore, gjeni të bashkangjitur një tabelë, pjesë e këtij raporti përmbledhës.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Raporte mujore	12
2	Tabela informuese për Antikorrupsion	1
3	Pushime mjekësore.	91
4	Pushime vjetore.	313
5	Pushime mjekësorë Covid-19	4
6	Punimi i listës për dëshmi të vaksinimit Covid-19	1
7	Punimi i listës për pagesë për sistem të pagave për anëtarët e kuvendit	326
8	Punimi i listave për ardhje-shkuarje për Kulturë, Rini dhe Sport	36
9	Punimi i listave për ardhje dhe shkuarje për praktikant me pagës nga ministria	130
10	Kërkesa për ID- kartela zyrtare	16
11	Punimi i formularëve për ndryshime	41
12	Punimi i formularëve për punëtorët e larguar – drejtor	21
13	Punimi i formularëve për punëtorët të rinj	22
14	Punimi i formularëve për transferim bankar	10
15	Punimi i formularëve për retroaktiv	23
16	Punimi i planit të punës dhe vlerësimi zyrtarëve komunal në SIMBNJ	13
17	Punimi i formularit me te dhënat për zyrtaret publik për MBPB	2
18	Vërtetim për kryerjen e praktikës	11
19	Vërtetim për përvojë të punës për punëtorët	15
20	Vendime për kryerjen e praktikës	23
21	Vendim për Transferime	4
22	Pëlgim për Transferime	2
23	Printimi, shpërndarja dhe mbledhja e listave të pagave	240
24	Shkresa të ndryshme zyrtare për mes imelles zyrtare	246
25	Vendim për Pushim të Lehonisë	2
26	Vendime përfundimin e marrëdhënies së punës me arritjen e moshës së pensionimit	3
27	Vendim për ndërprerje e marrëdhënies se punës	2
28	Raporti i listave ardhje dhe shkuarje për punëtoret	164
29	Vendim për shkarkim	1
30	Vendim për emërim	17
31	Kompletimi i dosjeve me te dhëna personale sipas ligjit të ri	47
32	Vendim për page shtesë me rastin e pensionimit	2
33	Vendimin për lirimin nga detyra	8
34	Njoftim për arritjen e moshës së pensionimit	1
35	Njoftim për Komisionin Disiplinor	1
36	Njoftim përfundimin e periudhës provuese	2
37	Kërkesë për mjete buxhetore për pagesë retroaktive	15
38	Kërkesa të ndryshme	4
39	Kërkesë për aprovim te konkursit lëvizje paralele	4

41	Përgjigjeje në Kërkesat e KPMK-së	9
42	Përgjigjeje ne kërkesat e Avokatës Komunale	18
43	Përgjigjeje në Kërkesë DSHPS	2
44	Vendime për punë shtesë	1
45	Vendim për pagesë shtesë	11
46	Vendim për kthim në vendin e punës	3
47	Vendim për shfuqizim	2
48	Vendim për pushim të përdëllimit	3
49	Vendim me dorëheqje nga puna	1
50	Vendim për pushim të lehonisë	2
51	Vendim për pushim me rastin e vdekjes se anëtarit te ngushte	2
52	Vendime për Udhëtime Zyrta	3
53	Vendime për formimin e komisionit rekrutues	1
54	Pëlqimi	1
55	Punim i formularit për deklarim të rregullt vjetor të pasuris 1 deri 31 mars 2021 në formular Excel	1
56	Shkresë njoftim për mbarim të funksionit të anëtarit të asambles së Kuvendit Komunal	21
57	Shkresë njoftim për emrim të funksionit të anëtarit të asambles së Kuvendit Komunal	19
58	Shkresë njoftim për të gjithë zyrtaret e lartë publik që nënshkruhen me marrjen e njoftimit për deklarim të pasurisë së rregullt	1
59	Pushim Martesor	2
60	Ftesa dy për Komisionin Disiplinor	2
61	Shkresa lidhur me njoftimin e zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e pasurisë së rregullt muajin mars	52
62	Vendime për punë shtesë	3
63	Përgjigjeje në kërkesë	9
64	Pushim i Atësi	1
65	Publikimi i konkurseve përllevizje paralele	6
66	Publikimi i konkursit në Shëndetësi dhe arsim	2
67	Kërkesë për Komision Disiplinor	3
68	Vendim për Autorizim	1
69	Kompletimi i lëndëve për Auditor të Brendshëm	32
70	Vendim për formimin e komisionit rekrutues	3
71	Ftesa për Komision Disiplinor	3
72	Imella zyrtare	108
73	Regjistri për dosjet personale	33
74	Regjistri për auditorët e jashtëm	1
75	Vërtetim për pagë mujore	1
76	Gjithsejt	2239

SEKTORI PRONËSORO – JURIDIK

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës raportuese është bërë përcjellja e dispozitave ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës. Gjatë tërë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimitaria e Komunës në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës raportuese të vitit 2021 me kërkesë të Kryetarit janë përgatitur Vendime, Shkresa të ndryshme Pëlqime, Kontrata dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori Pronësoro-Juridik për vitin 2021:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendime	10
2.	Shkresa	176
3.	Pëlqime	11
4.	Kontrata	3
5.	Propozim-Vendime	5

Sektori Pronësoro-Juridik ka pranuar lëndë nga Drejtori i Administratës Komunale, Sektor të komunës si dhe lëndë të parashtruar nga palët, në procedurë administrative kemi pranuar gjithsej 217 lëndë, prej tyre të kryera 205 dhe në procedurë janë 12 lëndë.

SFIDAT

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur sfida, kryesisht në udhëzimin e palëve për kompletimin e dokumentacionit gjatë parashtrimit të kërkesave të tyre si dhe në sjelljen e dokumentacionit për kompensim nga ana e pronarëve bazuar në legjislacionin në fuqi të cilëve i është prekur prona e paluajtshme për shpronësim lidhur me ndërtimin e rrugëve.

ZYRA LOKALE PËR KOMUNITETE

Gjatë kësaj periudhe, ZKKK-ja, krahas aktivitetave tjera të rregullta, ka punuar në zgjidhjen e problemit të familjeve të riatdhesuara, punën me organizatat joqeveritare, zgjerimin e akomodimit të familjeve të riatdhesuara.

Aktivitetet në të cilat ka punuar ZKKK-ja gjatë kësaj periudhe:

Pjesëmarrja në punën e komisionit komunal për riintegrin e familjeve të riatdhesuara; Takimet me organizatat joqeveritare; Pjesëmarrja në punën e Komitetit për komunitete; Puna në data bazën e MAPL-së; Regjistrimi i pësonave të riatdhesuar; Dhënia e konfirmimeve; Pjesëmarrja në seminar; Ndarma e ndihmave financiare familjeve të varfëra; Vizita në teren; Zgjidhja e problemeve të pësonave të riatdhesuar; Ndarma e subvencioneve familjeve të riatdhesuara; Shpërndarja e kuponave familjeve të varfëra.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 7 familje me 11 anëtarë. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 12 konfirmime për familjet e riatdhesuara për të ushtruar të drejtat e tyre në zyrën e punës.

Është regjistruar 1 i kthyer nga Serbia. Janë nënshkruar 2 kontrata për strehim dhe integrim të të huajve.

Në bashkëpunim me koordinatorin e MPB-së, 2 familjeve të riatdhesuara u shpërndanë 2 pako ushqimore dhe higjienike. Kemi marrë pjesë në punën e komisionit për hartimin e planit trevjeqar të banimit 2021-2024

Eshte mbajtur takimi me përfaqësuesit e fshatrave nga komuniteti RAE dhe organizatat joqeveritare SHPRK (Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore në Kosovë), ku përfaqësuesit e fshatit njihen me të drejtat e grave në pronë.

Takim me OJQ-në Nënë Tereza lidhur me aplikimin online për planin e biznesit.

Kemi marre pjese ne seminaret të cilat janë organizuar nga organizatat joqeveritare dhe institucionet e Kosovës

Kemi vizituar familjet skamore në Magure. Po ashtu kemi vizituar edhe familjet ne Janjev të cilat kanë problem me ujin e pijshëm.

Me organizatat joqeveritare Nena Terez, Voice of Rae, GIZ, Caritas, IOM, UNMIK, Advancint Together dhe te tjere kemi pasur takime ne lidhje qeshtjet me te cilat merret organizatat joqeveritare.

ZKKK-në e vizitoi një delegacion i Agjencisë Kombëtare të Diasporës në Zyrën e Diasporës të Kryeministrat të Shqipërisë. Tema e takimit ishte: Procesi i riintegrimit të personave të kthyer dhe integrimi i të huajve në Kosovë.

Është mbajtur një takim me FSK-në lidhur me pranimin e kandidatëve nga komunitetet pakicë në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

ZKKK-ja ka marrë pjesë në shpërndarjen e bonove për familjet skamnore sociale në vlerë prej 360 €. Donator ishte Bashkimi Evropian, i realizuar përmes IOM-it dhe Qendrës për Punë Sociale. Janë dhënë 124 kupona.

Kemi vizituar persona të rrezikuar social të cilët kanë aplikuar për ndihmë të njëherëshme. 15 familje morën ndihmë të njëherëshme.

Fituesit e projektit u ftuan në ZKKK të nënshkruajnë dokumentet për dorëzimin e pajisjeve nga Caritas.

Morëm pjesë në mbledhjen e Këshillit Koordinues Bashkiak për Mbrojtjen e Viktimate të Dhunës – Barazi Gjinore.

Ne morëm pjesë në një takim online me temë: Ndihma për Kthimin dhe Kthimi i Qëndrueshëm.

DREJTORATET KOMUNALE

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Përgjatë vitit 2021 përgjithësisht kemi një mbarëvajtje të mirë të punës si dhe realizim të detyrateve dhe planeve të punës në bazë të planifikimit të paraparë.

Gjatë fazës Janar-Dhjetor 2021, drejtorati i Administratës ka realizuar takime të përditshme dhe në bazë të agjendave të parapara me nivelin qendror si dhe organizata të ndryshme lidhur me aktivitetet dhe punët që kanë të bëjnë me Administratën.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Në periudhën e tremujorit të parë të vitit në menaxhimin dhe koordinimin e punës me stafin e QSHQ- së aktivitetet janë të organizuara në mënyrën më të mirë dhe më efikase në cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarë, në kohë pandemie në vazhdimësi janë të kujdesur edhe në menaxhimin e punës me masa të mbrojtura nga virusi.

Në sektorin e gjendjes civile në fillimin e tremujorit të parë të vitit raportues është ngritur numri i kërkesave nga qytetarët për tu pajisur me certifikata dhe dokumente te gjendjes civile kurse ne fundin e tremujorit të parë të këtij viti ka pasur rënje per shkak te rënies se fluksit te qytetarëve dhe se me angazhimin e stafit janë kryer shërbimet në kohë të shpejtë pa pasur pritje të qytetarëve.

Përgjatë muajit Shkurt kemi vizituar zyret e vendit në Gadime, Janjevë, Kraishtë, Magure dhe Shalë kemi evidentu problemet edhe çështjet tjera se me qka ballafaqohen këto zyre, i kemi evidentu kërkesat e zyrtarëve dhe kemi ndërmarrë hapa për plotësimin e këtyre kërkesave me qëllim rregullimin dhe funksionimin sa më të mirë për zyret e vendit.

Hapat e ndërmarrë për zyret e vendit në mënyrë specifike tek zyrja e vendit në Magurë si dhe në Shalë me çrast gjatë muajit Prill zyra e vendit në Magurë është zhvendos për shkak të kushteve jo të mira teknike për mbarëvajtje e mirë të punës nga lokacioni zyres së vjetër tek pjesa hyrëse e Qendrës Rinore Rekreative të Magurës.

Objekti ku ndodhet zyra e vendit në Shalë në pjesë të caktuara është renovuar si dhe është pastruar në bashkëpunim me një organizatë rinore lokale nga Shala.

Përgjatë muajit Prill kemi krijuar një kartelë të re të veturave lidhur me shpenzimet e riparimit dhe harxhimeve të naftës për veturat që operojnë në kuadër të Administratës.

Në sektorin e gjendjes civile në përfundim të gjashtëmujorit të parë, numri i kërkesave nga qytetarët për të u pajisur me certifikata dhe dokumente te gjendjes civile ka qenë në rritje marrë parasysh kohën e pushimeve nga mërgimtarët.

Në secilën periudhë është vlerësuar puna e shërbimeve me qytetarë, të cilat janë kryer me sukses dhe të gjitha punët me korrektësi dhe transparencë ndaj qytetarëve.

Për sa i përket sektorit të mirëmbajtjes dhe njësitet të transportit përgjatë gjithë kohës kemi pasur fokus menaxhimin e shfrytëzimit në mënyrë të drejtë dhe korrekte të veturave zyrtare nga ana e zyrtarëve komunal.

Me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë dhe llogaridhënjës format e raportimit të shefave të sektorëve si dhe zyrtarëve janë bërë në vazhdimësi në periudha te rregullta javore dhe mujore.

Përgjatë gjashtëmujorit të dytë kemi pasur poashtu aktivitete në kuadër të sektorëve që janë nën kompetencë të Administratës. Për sa i përket gjashtëmujorit të dytë në Administratë të përgjithshme dhe në sektorin e Gjendjes Civile në vazhdimësi ka qenë punë aktive me palë si dhe në fundvit planifikime për vitin vijues.

Nga sektori i mirëmbajtjes dhe operimit kemi ndërmarrë hapa dhe planifikime konkrete për avansimin dhe kontrollin e veturave si dhe kërkesa për vetura shtesë, për monitorimin e veturave është planifikuar që gjatë vitit vijues të pajisemi me GPS cdo veturë në kuadër të Drejtoratit të Administratës.

STATISTIKAT

SEKTORI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Nr.	Emërtimi i Llojit të Punës	Sasia
•	Protokollimi i kérkesave, ankesave si dhe aktet tjera te personave fizik dhe juridik, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë	
1	Kérkesa të regjistruara nga personat fizikë dhe juridik	15046
2	Kérkesa për mbajtës familje dhe shtesa për fëmijë jashtë vendit	734
3	Kérkesat gjendjes civile të regjistruara në sistemin e intranetit	39608
•	Pranimi dhe Dërgimi i shkresave bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të brendshëm zyrtarit të postes së institucionit.	
4	Aktvendime të Shpërndara	342
5	Ftesa të Shpërndara	1880
6	Vendime të Shpërndara	267
7	Fletëparaqitje për Gjykatë	576
8	Njoftime të Shpërndara	426
9	Të Arritura me Postë	327
10	Të Dërguara me Postë	3021
11	Fatura tatimore të Qirasë	126
12	E veçantë për të raportuar harxhimet në të holla për dorëzim në postë janë 3793,60€	
•	Zyrtari i Pranimit/Logistikës	
13	Futja e të dhënavës në SIMFK – Frebalanc	2542
14	Komentet në raportin e pranimit të mallit me modul të blerjes.	2542
15	Pranimin e mallit të cilën është porositur malli nga furnitorët ekonomik.	350
16	Përgatitja e formularëve të shënimëve për mallrat e pranuara me anë të kérkesës interne nga organet përkatëse të cilët kanë kërkuar furnizim të mallit.	350
17	Përgatitja e formularëve për mallin e pranuar me anë të fletë dërgesës nga operatoret ekonomik, hyrje – dalje	350
18	Regjistrimi i faturave në librin hyrës dhe dalje.	361

19	Shpërndarja e mallit të pranuar nga operatoret ekonomik.	323
20	Regjistrimi i Faturave të Op. Ek. Hyrje – Dalje për inventarizimin dhe paisjeve të IT në programin E-Qeverisja	184
21	Stoqe të grumbulluar me material në depon e komunës	98
22	Gjithsej	69453

SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Ekstrakt i lindjes	30789
2	Certifikatë e martesës	6517
3	Certifikatë vdekje	2910
4	Certifikatë Vendbanimi	1676
5	Certifikatë Shtetsie	577
6	Certifikatë e Statusit martesor	1846
7	Certifikatë të lindjes	16171
8	Certifikatë e BF	4734
09	Aktvendime nga lëmia e gjendjes Civile dhe Akt Vdekje	317
10	Gjithësejt	65537

SEKTORI I KUVENDIT

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
11	Mbajtja e procesverbalit nga mbledhjet e KK	10	223 faqe
2.	Nxjerra e Ekstraktit nga mbledhjet e KK	10	102 faqe
3.	Nxjerra e Vendimeve dhe akteve të tjera nga mbledhjet e Kuvendit	41	87 faqe
4.	Përkthimi i Ekstrakteve	28	120 faqe
5.	Përkthime zyrtare-simultane në organe të ndryshme	90	173 orë
6.	Përkthimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorateve	125	365 faqe
7.	Përkthimi i shkresave të tjera	106	185 faqe
8.	Fotokopjimi	350	77000 faqe
9.	Mbajtja e Procesverbalit nga mbledhjet e KPF-së	6	39 faqe
10.	Nxjerra e Ekstrakteve nga mbledhjet e KPF-së	6	28 faqe
11.	Mbajtja e procesverbalit dhe Nxjerra e Ekstraktit nga mbledhjet e komiteve tjera dhe komisioneve të ndryshme	17	88 faqe
12.	Mbajtja e procesverbalit dhe nxjerra e ekstraktit nga mbledhja e KKSBB	3	40 faqe
13.	Përgaditja e ftesave të ndryshme për mbledhje dhe tubime të ndryshme.	55	750 faqe

14.	Përgaditja e rexhistrave të ndryshëm (për meditjet e anëtarve të Kuvendit dhe komiteteve e të ngjajshme).	68	132 faqe
15.	Të ndryshme(dërgimi i dokumenteve për veb faqe,dokumenteve të skenuara në MAPL etj. të ngjajshme)	216	701 faqe
16.	Rregullore,Plan, Korrniza e të ngjajëshme-	7	83 faqe
17.	Lektorim të materialeve të ndryshme (rregullore, vendime ekstrakte,raporte,ftesa etj. të ngjajëshme)	198	438 faqe
19.	Gjithsejt	1334	80294 faqe
			Përveq kësaj që pasqyrohet me faqe janë edhe 173 orë përkthim gojor

SEKTORI PER MIREMBAJTJE DHE OPERIM

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Furnizim me lëndë djegëse - karburant për gjenerator	/	433.82 Litra
2	Furnizimi me lëndë djegëse /naftë/ për ngrohje qendrore		7640 Litra
3	Furnizim me lëndë djegëse – karburant për automjete	19	15730.77 litra karburante
4	Evidentimi i kilometrave të kaluara të automjeteve dhe mesatarja e shpenzimeve.	19	178472 km mes; 8.81 lit/100 km
5	Harxhimet e ujit të pijshëm	/	
6	Furnizim me material teknik për mirëmbajtje të objekteve	/	
7	Furnizim me material higjenik		
8	Ndërrimi – meremetimi i dorëzave për dyer të drurit	48	
9	Rregullimi dhe debllokimi i ujit në nyjën sanitare	14	
10	Mirëmbajtja e higjenës në sipërfaqe	/	3200 m²
11	Mirëmbajtja e parkut - kositja e barit,	9	
12	Servisimi i automjeteve	15	
13	Servisimi i gjeneratorëve	1	
14	Servisimi i kalldatorëve	2	
15	Servisimi i centralit kundër zjarri (Alarmi)		
16	Servisimi i aparatave kundër zjarri		
17	Bartja e zyrtarve komunal ne trajnime-Prishtine me Kombi	362	
18	Vazhdimi i regjistrimit të autojemjeteve	14	
19	Mirëmbajtja e teknologjisë kompjuterike		
20	Vendosje e pompave zhytëse në pishinë		2 pompa
21	Kerkesa per vetura zyrtare	2081	
	Gjithsej	3002	

NJËSITI PËR BARAZI GJINORE

Skema grafike e punëve JANAR – DHJETOR 2021

Trajnine	Takime	Debate	Tryezë e rrumbullakët	Të ndryshme
27	76	9	4	Këshilla dhe sugjerime me palë në zyre 115

SFIDAT

Sfidë mbeten problemet me intranetin si dhe rrjetin qeveritar të internetit ku në vazhdimësi ballafaqohemi me probleme dhe ndërprerje të vazhdueshme në kohën e fluksit të madh të qytetarëve ballafaqohemi me ndërprerje të internetit dhe ngadalësim të sistemit të Intranetit.

DREJTORATI PËR ARSIM

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtorati i Arsimit gjatë vitit 2021 me qëllim të realizimit të punëve detyrave, zhvillimit dhe përmirësimet të proceseve arsimore në të gjitha segmentet dhe ngritjes së cilësisë në përgjithësi në shkollat e Komunës së Lipjanit, ka realizuar aktivitet e saj sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë për këtë periudhë kohore, por njëkohësisht edhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura.

Duke qenë se ndodheshim në një situatë jo normale pas paraqitjes së pandemisë, MASHT-i në bashkëpunim me akterët e tjerë, përfshirë drejtore të arsimit në nivel Komunal, , filloj planifikimet për organizimin e procesit mësimor në përputhje me masat e parapara nga qeveria IKSHP dhe MASHT.

Fillimi i vitit të ri shkollor solli shumë sfida për shkollat, mësuesit, fëmijët dhe prindërit, të cilëve u duhej të përshtateshin me metodën e re të mësimdhënieve dhe të nxënësit në kushtet e imponuara nga pandemia COVID-19. Në rrethanat e reja, cilësia dhe gjithpërfshirja ishin fokusi kryesor i institucioneve shtetërore si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Mbyllja e shkollave nuk pengoi vetëm zhvillimin normal të mësimit por edhe mirëqenien e tyre psiko-emocionale. Gjithsesi, sigurimi i shëndetit, mos prekja nga virusi ishte sfida kryesore për t'u përballuar me vendimin e hapjes së shkollave.

Duke mos qenë një vit i zakonshëm, viti i ri shkollor 2020/21 në Kosovë filloj me vonesë në kushte të kufizimeve, me maska mbrojtëse, matje të temperaturës, dezinfektim duarsh dhe mjedisesh, si dhe distancë fizike. Autoritetet arsimore në nivel qendror dhe lokal parashikuan organizimin e procesit mësimor sipas tre skenarëve: **Skenari A**–mësimi në shkollë; **Skenari B**–mësim i kombinuar dhe **skenari C**–mësim në distancë, të përcaktuar në udhëzuesin e përgjithshëm të MASHTI për organizimin e vitit shkollor 2020/21 në kushtet dhe rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19. Përzgjedhja e skenarëve bëhet varësish nga situata epidemiologjike në vend dhe kushtet specifike të institucioneve parashkollore/shkollave.

Kjo mënyrë e organizimit të mësimit në kushte pandemie, qoftë mësimit në shkollë, atij të kombinuar apo mësimit në distancë, u përcoll me sfida të shumta, si për mësimdhënësit ashtu edhe për prindërit, nxënësit dhe komunitetin arsimor në përgjithësi.

Kjo për arsy se përvçe sfidave të tjera, sistemi ynë arsimor nuk ishte i përgatitur për një mënyrë të tillë të të mësuarit. Ngritja e cilësisë në mësim, në veçanti përmirësimi i praktikave vlerësuese të nxënësve, ka qenë prioritet në mënyrë që shkollat tona të arrijnë në stadin e shkollave të përparuara në aspektin zhvillimor.

AKTIVITETET DHE PUNËT E REALIZUARA NGA DKA - deri në këtë periudhë raportuese

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor, vizita të përgjithshme në institucionet arsimore,
- Raportim i vazhdueshëm në SIA dhe MASH rrëth mbajtjes së procesit mësimor, paraqitjes së rasteve me covid-19 të mësimdhënësve, nxënësve apo personelit tjetër vaksinimi i personelit të shkollave
- Përfundimi i vitit shkollor 2020/2021
- Përgatitja e të dhënave për libra.
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i kuadrit arsimor të kualifikuar arsimore, përgatitja dhe shpallja e konkursit të rregullt për mësimdhënës, konkursit për drejtë, zëvendësdrejtëtor dhe personel tjetër arsimor
- Planifikimi i regjistrimit të nxënësve (klasa e I-parë dhe klasa e X-dhjetë),
- Shpallja e konkursit për pranimin e fëmijëve në QEAP “Çerdhja”

- Furnizimi i të gjitha shkollave me maska dhe dezinfektues, dezinfektimi dhe deratizimi në të gjitha institucionet arsimore në Lipjan (hapësirat brenda objekteve).
- Mbajtja e takimit me drejtoret e të gjitha shkollave
- Përpunimi i statistikave të pranuara nga shkollat
- Vlerësimet e brendshëm dhe të jashtëm (testit të arritshmërisë dhe testit të maturës),
- Përgatitjet në të gjitha shkollat për fillimin e viti të ri shkollor 2021-2022 si në aspektin e përgatitjeve tekniko-higjenike ashtu dhe përgatitjes për furnizim me tekste shkollore të nxënësve të nivelit fillor.
- Mbajtja e testi PIRLS me nxënësit e klasave të katërtë nga 8 shkolla filllore të komunës tone.
- Është mbajtur trajnimi për kurrikulë-programi fillor për mësimdhënësit që fillojnë me zbatu kurrikulën nga viti shkollor 2021/2022.
- Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
- Plotësimi i formularëve mbi kualifikimin e mësimdhënësve.
- Furnizimi i nxënësve me tekste mësimore
- Furnizimi i shkollave me material higjenik dhe pedagogjik
- Çertifikimi i disa mësimdhënësve për "Shkathtësitë bazë dhe zhvillimi i lidershipit", trajnim ky i organizuar nga Britich council dhe MASHT-i,
- Vlerësimi i dosjeve te mësimdhënësve qe kane punuar me klasat me kurrikule dhe do certifikohen pas vlerësimit te dosjeve (parafillor dhe fillor),
- Dërgimi i pyetësorit tek drejtoret e shkollave i pranuar nga Instituti ED GUARD rrëth pajisjes me tekste shkollore (problematikat me te cilat ballafaqohen shkollat gjate shpërndarjes se teksteve shkollore),
- Në bashkëpunim me MASHT dhe policinë e Kosovës më datën 27.10.2021 në SHFMU "Ismail Luma" në Lipjan është ligjëratë me nxënës me temën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Gjatë kësaj fushatë e kemi organizuar edhe garën me të gjitha shkollat e Kosovës ku përmes punimeve të tyre në artin figurativ do ta pasqyrojnë temën kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe në fund të fushatës MASHTI ka hapur një eksposítë me punimet e nxënësve ku janë përzgjedhur dhe shpërblyer tri punimet më të mira të përzgjedhura nga një komision profesional.
- Nënshkrimi dhe harmonizimi I kontratave dhe normave.
- Përurimi i sallës së sporteve në Sllovi
- Pranimi i donacionit – maskave nga FSK
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese,
- Përurimi i qendrave për edukim të hershëm me bazë në komunitete në Magurë dhe Shalë
- Furnizimi i shkollave me material higjenik (dezinfektues dhe maska)
- Furnizimet e shkollave me material shpenzues, inventar shkollor, mjete didaktike, pajisje të teknologjisë informative
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me material didaktik
- Furnizimi me material për mirëmbajtje të objektit në Çeap "Çerdhja" në Lipjan
- Furnizimi me mallra për mbjelljet pranverë-vjeshtë për periudhën 3-vjeçare (kontratë kornizë 2021-2023)
- Pranimi dhe shqyrtimi i aplikacioneve për ndarjen e bursave
- Operimi i ekipit vlerësues profesional përfëmijët me nevoja të veçanta arsimore,
- Furnizimi i disa shkollave me lëndë djegëse përvitin shkollor 2021/2022,
- Furnizimi i SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan me pajisje të IT, donacion nga MZHEA,
- Instalimi i kamerave në të gjitha institucionet edukativo arsimore me përjashtim të Qerdhës dhe SHFMU " Kadri Beba " – Ribar i Madh
- Furnizimi me material, punim i gilinderëve dhe montimi i tyre në Shfmu "Ernest Koliqi" në Babush i Muhabherëve,
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë,
- Kryerja e shërbimeve të transportit të nxënësës në relacione të ndryshme,
- Bashkëpunimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve dhe memorandumeve të mirëkuptimit me OJQ dhe organizata neveritare.

Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor dhe furnizimi i shkollave me material higjenik (dezinfektues dhe maska)

- Drejtoria e Arsimit, në funksion të realizimit të punëve dhe detyrave me përgjegjësi, zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë në arsim në shkollat e Komunës së Lipjanit, gjatë vitit shkollor 2020/21 ka realizuar vizita në të gjitha

institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar. Vizitat kishin karakter mbështetës, kontrollues dhe këshillues për drejtuesit e institucioneve dhe stafin mësimdhënës.

- **Raportim i vazhdueshëm në SIA dhe MASH rreth mbajtjes së procesit mësimor, paraqitjes së rasteve me covid-19 të mësimdhënësve, nxënësve apo personelit tjetë vaksionimi i personelit të shkollave**
- Me qëllim të zbatimit të masave anti covid dhe parandalimit të përhapjes së mëtutjeshme të pandemisë dhe në mënyrë që të kihet parasysh situata në teren mbi numrin e të infektuarve dhe të vaksinuarave. DKA ka mbajtur statistika sipas kërkesave dhe udhëzimeve të MASH-it.
- **Përfundimi i vitit shkollor 2020/2021**
- Duke mos qenë një vit i zakonshëm, viti i ri shkollor 2020/21 në Kosovë filloi me vonesë dhe në kushte të kufizimeve, për këtë arsyedhe përfundimi i vitit shkollor është shtyer.
- **Përgaditja e të dhënave për libra**
- Si çdo vit edhe në vitin 2021 bazuar në të dhënat mbi numrin e nxënësve në secilën shkollë janë bërë planifikimet mbi numrin e teksteve me të cilat duhet të paisen nxënësit. Gjithsesi janë marrë parasysh edhe numri i teksteve të cilat mundë të janë të përdorshme nga viti i kaluar. Tekstet janë shpërndarë nëpër shkolla sipas kërkesës dhe specifikacionet e drejtorëve të shkollave.
- **Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i kuadrit arsimor të kualifikuar për institucionet edukativo arsimore dhe sistemimi i mësimdhënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, si rezultat i ndryshimeve kurrikulare**
- Plotësimi i vendeve të punës me kuadër adekuat arsimor, zëvendësimet për lehonat dhe zëvendësimet e pa planifikuar gjithmonë kanë qenë sfidë për DKA-në sepse vendet e pa plotësuar ndikojnë drejt përsë drejti në procesin arsimor dhe cilësinë në arsim. Me gjithë atë DKA ka arrit që me kohë të bëj planifikimet e duhura dhe plotësimin e vendeve të lira ose zëvendësimet përmes konkursit të rregullt dhe konkurseve plotësuese të kohë pas kohshme sipas nevojave të paraqitura.

Planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasën e I-parë dhe në klasën e X-dhjetë për vitin shkollor 2021/2022

	Emri i shkollës	Numri i paraleeve	Numri i nxënësve
1	SHFMU " VËLLËZËRIT FRASHËRI "	7	238
2	SHFMU "ISMAIL LUMA "	4	73
3	SHFMU "ZENEL HAJDINI "	5	56
4	SHFMU "DY DËSHMORËT"	4	45
5	SHFMU " IBRAHIM BANUSHI "	3	42
6	SHFMU "HARADIN BAJRAMI "	5	90
7	SHFMU "EMİN DURAKU "	3	52
8	SHFMU " HASAN Z KAMBERI "	2	46
9	SHFMU "MIGJENI "	3	40
10	SHFMU " ERNEST KOLIQI "	2	40
11	SHFMU " SHTJEFËN GJEQOVI "	2	35
12	SHFMU " KADRI BEBA "	3	38
13	SHFMU " SKENDERBEU "	2	20
14	SHFMU " KATËR DËSHMORËT "	2	27
15	SHFMU " V. DOMANEKU "	2	25
16	SHFMU " HASAN PRISHTINA "	1	25
17	SHFMU " IBRAHIM KRASNIQI "	1	16
18	SHFMU NEZË BUJANI "	2	25
19	SHFMU " FEHMI AGANI "	2	29
20	SHFMU " DRITA "	1	20
21	SHFMU " REGJEP AKLLAPI "	2	10
22	SHFMU "VEZIR KOLSHI "	2	35
23	SHFMU " 7 MARSI "	1	15
24	SHFMU - "17 Shkurti" GLLOGOVC	1	15
	GJITHSEJ	62	1057

Më datë 28.06.2021 është shpall konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të (dhjetë) të Gjimnazeve dhe të shkollave Profesionale, për vitin shkollor 2021/2022

Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan

Nr.	Klasa	Drejtimi	Numri i parale leve	Numri i nxënësve
1	X	Gjimnazi Natyror	6	224
2	X	Gjimnazi Shoqëro-Gjuhësor	7	192
Gjithsej:			13	416

Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan, paralelja e ndarë fizike në Gadime

Nr.	Klasa	Drejtimi	Numri i parale leve	Numri i nxënësve
1	X	Gjimnazi Natyror	1	32
2	X	Gjimnazi Shoqëro-Gjuhësor	1	32
Gjithsej:			2	64

SHML "Shaqir Hoxha" në Shalë

Nr.	Klasa	Drejtimi	Numri i parale leve	Numri i nxënësve
1	X	Gjimnazi Natyror	1	28
2	X	Gjimnazi Shoqëro-Gjuhësor	1	28
Gjithsej:			2	56

ShMP "Adem Gllavica" në Lipjan

Nr.	Klasa	Drejtimi	Profili arsimor	Numri i parale leve	Numri i nxënësve
1	X	Ekonomi	Banka dhe sigurime	2	64
2	X	Ekonomi	Kontabilitet	1	32
3	X	Ekonomi	Marketing	1	32
4	X	Administratë	Asistent juridik	2	64
5	X	Elektroteknikë	Informatikë	1	32
6	X	Elektroteknikë	Instalues elektrik	1	32
7	X	Makineri	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	1	32
8	X	Makineri	Automekanik	1	32
9	X	Trafik	Trafik rrugor	1	32
10	X	Bujqësi	Hortikulturë	1	32
11	X	Bujqësi	Agrobiznes	1	32
12	X	Ndërtimtari	Ndërtimtari	1	32
13	X	Ndërtimtari	Arkitekturë	1	32
Gjithsej:				15	480

Planifikimi i regjistrimit të fëmijëve në qerdhe

Shpallja e konkursit për regjistrimit e fëmijëve në çerdhe është bërë me datën 29.06.2021 sipas ligjit mbi edukimin parashkollor dhe kritere të përcaktuara nga DKA. Shpallja është bërë për plotësimin e vendeve të lira për të gjitha grupmoshat.

Furnizimi i shkollave me material higjenik (dezinfektues dhe maska)

Janë bërë vizita sidomos për verifikimin e zbatimit të masave dhe rekomandimeve nga IKSHP me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes nga COVID 19.

Që në muajin janar në bashkëpunim me UNICEF-in janë siguruar një sasi e konsiderueshme e mjeteve mbrojtëse kundër virusit COVID 19 (sapunë për duar, dezinfektues, domestos dhe termometra). Gjithashtu edhe nga buxheti komunal janë siguruar maska dhe dezinfektues në sasi të mjaftueshme për të gjitha shkollat. Është bërë dezinfektimi i rregullt i IEA-ve përmes kontraktimit të një operatori i cili ka bërë dezinfektimin e hapësirave shkollore në interval të ndryshme kohore.

Vlerësimi i brendshëm dhe të jashtëm (testit të arritshmërisë dhe testit të maturës)

Në kuadër të vlerësimeve të jashtme ndërkombëtare janë mbajtur testi PISA për nxënës të shkollave të mesme dhe PIRLS për nxënësit e klasave të katërtë, gjithashtu këtë vit janë mbajtur testi i arritshmërisë për klasat e IX dhe testi i maturës shtetërore për nxënësit e klasave të XII, afati i qershorit.

Edhe këtë vit shkollar janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme: Testit të Arritshmërisë dhe Provimit Shtetëror të Maturës (afati i qershorit) duke i krahasuar me rezultatet e vlerësimit të brendshëm. Kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen që do të reflektojnë pozitivisht në përmiresimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimdhënies në procesin edukativo-arsimor. Drejtoria e Arsimit në Lipjan çdo fundvit shkollar bënë një vlerësim dhe analizë të përgjithshme për ecurinë dhe përfomancën e procesit edukativo-arsimor, analizon suksesin e nxënësve për rezultatet e arritura për të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Testi ndërkombëtar PIRLS - 2021

Me 15.06.2021 është mbajtur testi PIRLS me nxënësit e klasave të katërtë nga 8 shkolla fillore të komunës tone: SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, SHFMU "Ismail Luma" në Lipjan, SHFMU "Nez Bujani" në Bujan, SHFMU "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë, SHFMU "17 Shkurti" në Glogovc, SHFMU "Vëllezërit Domanaku" në Toplliqan, SHFMU "Zenel Hajdini" në Gadime dhe SHFMU "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe.

Testi ndërkombëtar PISA - 2021

Po ashtu në kuadër të vlerësimeve të jashtme me datën 6, 7 maj është mbajtur edhe testi ndërkombëtar PISA 2021 ku kanë marrë pjesë nxënësit e klasëve të nënta të shkollave të mesme. Testi është mbajtur nën monitorimin e komisionerëve të përcaktuar nga MASH.

SUKSESI NË TESTIN E ARRITËSHMËRISË, QERSHOR 2021

	Emri i shkollës	Gjithsej nx. Pjesmarrës në test	Përqindja në nivel shkolle	Numri nx.me 50 deri 100 poena	Pozitiv me %	Numri nx.me 1 deri 49 poena	Negativ me %
1	SHFMU "VËLLEZËRIT FRASHËRI "	173	62.19	125	72.25	48	27.75
2	SHFMU "ISMAIL LUMA "	66	46.16	23	34.84	43	65.16
3	SHFMU "ZENEL HAJDINI "	57	38.94	10	17.54	47	82.45
4	SHFMU "DY DËSHMORËT"	49	42.61	15	30.61	34	69.38
5	SHFMU "IBRAHIM BANUSHI "	30	41.66	7	23.33	23	76.66
6	SHFMU "HARADIN BAJRAMI "	75	42.12	19	25.34	56	74.66
7	SHFMU "EMIN DURAKU "	53	49.56	21	38.25	32	61.75
8	SHFMU " HASAN Z KAMBERI "	49	44.61	15	30.61	34	69.39
9	SHFMU "MIGJENI "	28	39.67	6	21.43	22	78.57
10	SHFMU " ERNEST KOLIQI "	32	45.22	9	28.12	23	71.87
11	SHFMU " SHTJEFËN GJEQOVI "	30	40.4	11	36.66	19	63.33
12	SHFMU " KADRI BEBA "	39	46.12	12	30.77	27	69.23
13	SHFMU " SKENDERBEU "	32	42	4	12.5	28	87.5
14	SHFMU " KATËR DËSHMORËT "	25	44.76	10	40	15	60

15	SHFMU " V .DOMANEKU "	21	40.47	4	19.05	17	80.95
16	SHFMU " HASAN PRISHTINA "	18	61.05	12	66.66	6	33.33
17	SHFMU " IBRAHIM KRASNIQI "	26	58.65	23	88.46	3	11.53
18	SHFMU NEZË BUJANI "	15	54.77	12	80	3	20
19	SHFMU " FEHMI AGANI "	17	37.8	5	29.7	12	70.3
20	SHFMU " DRITA "	15	51.4	9	60	6	40
21	SHFMU " REGJEP AKLLAPI "	8	36,25	1	12,5	7	87,5
22	SHFMU "VEZIR KOLSHI "	30	53.63	16	53.33	14	46.66
23	SHFMU " 7 MARSI "	15	45.26	5	33.33	10	66.66
24	SHFMU - "17 Shkurti" GLLOGOVCI	11	35.90	2	18.18	9	81.81
	GJITHSEJ	914	41.95	376	44.24	538	55.76

REZULTATET E TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE, AFATI I PARË 26.06.2021

GJIMNAZI"ULPIANA" LIPJAN					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHSEJ NXËNËS
NATYROR	202	86.32%	32	13.68%	234
SHOQËROR-GJUHËSOR	171	63.33%	99	36.67%	270
GJITHSEJ	373	74.01%	131	25.99%	504

SHMP"ADEM GLLAVICA" LIPJAN					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
EKONOMI	13	16.88%	64	83.12%	77
ADMINISTRATË	16	22.54%	55	77.46%	71
HOTELERI		#DIV/0!		#DIV/0!	0
KIMI-TEKNOLOGJI	1	16.67%	5	83.33%	6
BUJQËSI	4	6.15%	61	93.85%	65
TEKN.USHQIMORE		#DIV/0!		#DIV/0!	0
ELEKTROTEKNIKË	8	16.00%	42	84.00%	50
KOMUNIKACION		#DIV/0!		#DIV/0!	0
MAKINERI	5	10.64%	42	89.36%	47
NDËRTIMTARI	8	33.33%	16	66.67%	24
GJITHSEJ	55	16.18%	285	83.82%	340

SHML"SHAQIR HOXHA" SHALË					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
NATYROR	17	80.95%	4	19.05%	21
SHOQËROR	4	13.33%	26	86.67%	30
EKON:Kontabilitet					
GJITHSEJ	21	41.18%	30	58.82%	51

NË NIVEL KOMUNE

POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
449	50.17%	446	49.83%	895

Mbështetja dhe bashkëpunimi i vazhdueshme me institucionet edukativo-arsimore në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim

Bashkëpunimi me Caritasit Zviceran për rregullimin e klasave për parafillor në kuadër të marrëveshjes së bashkëfinancimit mes tyre dhe Komunës së Lipjanit.

Bashkëpunimi me UNICEF-in për trajnimin e mësimdhënësve për përdorimin e platformës ZOOM.

Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore

Ekipi profesional për nxënësit me nevoja të veçanta ka vazduar me punën e tyre duke bërë vlerësimin pedagogjik të nxënësve varësisht nga kërkesat e drejtoreve të shkollave. Punën e ekipit në fjalë e ndihmon shumë edhe angazhim i logopedës që të bëjnë një vlerësim sa më real të nxënësve që kanë nevojë për vlerësimin e ekipit në fjalë.

Aspekti infrastrukturor pajisjet e shkollave me inventar dhe pajisje të teknologjisë informative dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore

Përmirësimi i infrastrukturës shkollore na e mundëson realizimin më të lehtë të procesit të reformave arsimore dhe cilësinë në arsim.

Komuna e Lipjanit dhe DKA është angazhuar duke i dhënë një prioritet të veçantë me numër të madh të projekteve për investime në objekte shkollore duke investuar direkt në infrastrukturën shkollore ndërtim, renovim, furnizimin e shkollave me inventar, paisje të teknologjisë informative dhe ndërtimin e sallave sportive:

Investime kapitale:

- Ndërtimi i aneksit në SHFMU "V. Frashëri" Lipjan
- Ndërtimi i çerdhes në fshatin Gadime e Ulët
- Ndërtimi i çerdhes në fshatin Sllovi
- Instalimi i ngrohjes qendrore në SHFMU „Rexhep Akllapi,, në Akllap, SHFMU „Vezir Kolshi,, p.n.f Resinovc, dhe SHFMU „Haradin Bajrami,, p.n.f Qylagë
- Rikonstruimi i dyshemesë dhe tualeteve ne Gjimnazin „Ulpiana,, në Lipjan.
- Renovimi i banjove në SHFMU „Ibrahim Banushi,, në Shalë
- Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse DRU dhe PELET për të gjitha IEA-at për vitin shkollor 2021/2022.
- Furnizimi i shkollave me maska dhe dezinfektues
- Furnizime i shkollave me Laptop
- Furnizimi me libra për bibliotekë SHFMU „Vezir Kolshi,, Baice, SHFMU „Ibrahim Krasniqi,, - Smallushë dhe SHFMU „Dy Dëshmorët,, në Dobrajë e Madhe
- Ndërtimit të shkollës së mesme në Gadime,
- Furnizimi me inventar i shkollës së mesme SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan dhe SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan,
- Realizimi i projektit "Zbatimi i masave të eficiencës së energjisë në objektet publike në 2-dy shkolla:
 - Shfmu "Zenel Hajdini" në Gadime dhe
 - Shfmu "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve.
- Rregullimi i infrastrukturës rrrethoja parkingje në disa shkolla,
- Instalimi i kamerave nga MASH-i në këto shkolla: Shfmu "Ibrahim Krasniqi" në Smallushë, Shfmu "Katër Dëshmorët" në Krojmir, Shfmu "Vezir Kolshi" në Baicë dhe Resinoc, Shfmu "Rexhep Akllapi" në Akllap, Shfmu "Ismail Luma" në Lipjan, Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, Shfmu "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe, Shfmu "Skenderbeu" në Kraishtë, Shfmu "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë, Shfmu "Hasan Prishtina" në Llugaxhi, Shfmu "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve, Shfmu "7 Marsi" në Poturoc dhe SHMLM "Shaqir Hoxha" në Shalë
- Gjithashtu nga banka botërore kanë fituar projekte këto shkolla: Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, Shfmu "Ismail Luma" në Lipjan dhe Shfmu "Emin Duraku" në Banullë.
- Janë blerë 80 Laptop dhe kompjuterë për nevoja të gjitha shkollave fillore dhe të mesme.

Mallra & Shërbime

Furnizimi i shkollave me material didaktik (ditar, leter etj).

Furnizimi i shkollave me material higjenik

Furnizimi i shkollave me material të mirëmbajtjes

Furnizimi i çerdhes me libra dhe lodra pë fëmijë

Bashkpunimi me me MASH, organizata qeveritare dhe jo qeveritare për ngritjen cilësisë, përfshirë nënshkrime të memorandumeve të bashkpunimit:

Në kuadër të bashkpunimit me Ministrin e Arsimit për nevoja të nxënësve janë shpërndarë 120 tabletë.

Marrëveshje bashkpunimi mes Komunës së Lipjanit dhe OJQ "Zëri i Ashkalive dhe Egjiptasëve"

Në kuadër të përkrahjes së komuniteteve Romë dhe Ashkali të përcaktuar në Planin Lokal të Veprimit 2018-2022 nënshkruhet marrëveshja e bashkpunimit për menaxhimin e 5 qendrave mësimore:

Qendra Mësimore në SHFMU "Ismail Luma" në Lipjan,

Qendra Mësimore në SHFMU "Haradin Bajrami" në Magurë,

Qendra Mësimore në SHFMU "Fehmi Agani" në Medvec,

Qendra Mësimore në SHFMU "Zenel Hajdini" në Gadime dhe

Qendra Mësimore në SHFMU "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë.

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëfinancimit mes Komunës së Lipjanit dhe Caritasit Zvicran me qëllim të realizimit të Projektit "Vendosja e Standardeve Para-shkollorë të Cilësisë së Lartë duke përforcuar Arsimin, Shkencën dhe Ekonominë eshtë bërë:

- Pjesëmarrja në punëtori e zyrtares për arsim e organizuar nga Caritasi Zvicran, lidhur me informatat Sasiore dhe Cilësore për Sigurimin e Cilësisë në Klasat Parafilllore: Databaza, Raportet dhe Udhëzuesit.
- Dërgimi i listës së 40 mësimdhënësve, përfshirë të gjitha shkollat të cilët do të fillojnë me trajnimin për teknologjinë e avancuar dhe për platformën Zoom të organizuar nga MASH dhe UNICEF-i.
- **Zbatimi i marrëveshjes së bashkpunimi mes DKA-së dhe OJQ- së ED GUARD për projektn Essilor Vision For Life, ku pas kontrollit të syve për nxënësit nga klasa I-parë deri IX-nëntë, u janë shpërndarë syzet.**

**-Takim me përfaqësuesit e organizata NIRAS dhe Science for Change Kosovo me të cilët kemi organizuar aktivitete -
Ditët e Informimit për Cilësinë e Ajrit dhe eshtë mbajtur punëtori me nxënësit e tri shkollave**

-Marrëveshje bashkpunimi mes Komunës së Lipjanit dhe The Ideas Partnership:

- Fillimi i projektit "Education for All" që financohet nga BE / EIDHR në Kosovë, organizat ndërkombtare. Ky projekt ka të bëjë me përkrahjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut me fokus në promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve.

-Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe ESVET PRO- Lux-Development S.A në emër të Projektit KSV/801 "Mbështetja e Bashkimit Europian për Rikualifikimet Profesionale dhe Profesionet në AAP të financuar nga Bashkimi Evropian, e cila ka për qëllim të ofrojë mbështetje për Institucionet e AAP-së në nivel Komunal, veçanërisht në zhvillimin e kurrikulave (duke përfshirë Standardet e Profesionit –Sp).

Vazhdimi i bashkpunimit mes Komunës dhe Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim - QSHHZH:

- Implementimin e programit për zhvillim në fëmijëri të hershme, arsim gjithëpërfshirës dhe mbrojtje të fëmijëve. Me këtë rast përfituese janë SHFMU "Ibrahim Banushi" – Shalë dhe SHFMU " Haradin Bajrami" Magurë ku eshtë mundësuar hapja e paraleleve për parashkollar të moshës 0-6.

Trajnimet e mësimdhënësve

Sa i përket trajnimeve, mësimdhënësit e komunës sonë edhe gjatë vitit shkollor **2020/2021** kanë vazhduar me trajnime të ndryshme.

MASHT-i edhe këtë vit ka paraparë trajnimet për zbatimin e kurrikulës për mësimdhënësit që nga muaji shtator i vitit shkollor **2021/2022** do fillojnë mësimin me parafillorët, klasa e parë, klasa e gjashtë dhe klasa e dhjetë për fushat:

Parafillorët, Klasa e parë, Gjuhët dhe komunikim, Matematikë, Shkencat Natyrore, Shkencat Shoqërore, Tik, Artet dhe Edukim Fizik. Trajnim i janë mbajtur në fund të muajit Gusht 2021.

60 mësimdhënës janë trajnuar për procesin e kurrikulës (programi fillor dhe gjuhët dhe komunikim), 40 mësimdhënës janë trajnuar nga MASH në bashkëpunim me UNICEF-in për Platformën Microsoft Teams, 15 mësimdhënës kanë ndjekur trajnimin e organizuar nga EDUMEN me temën "Menaxhimi i stresit tek nxënësit pas Pandemisë COVID-19, veprimet parandaluese të atakimit të jetës së njerëzve në të ardhmen. Gjithsejtë deri më tani janë trajnuar 115 mësimdhënës.

Punë dhe aktivitetë të ndryshme

Sikurse edhe viteve të kaluara edhe këtë vit, ne jemi ballafaquar me probleme të vazhdueshme në funksionimin e mirëfilltë dhe sa më të mirë të institucioneve edukativ-arsimore. Nga këto sfida po përmendim vetëm disa:

- Vet procesi i organizimit të mësimit në kushte pandemie,
- Mbrotja nga infekzioni Covid-19, kundër të cilit janë marrë masat parandaluese,
- Orari i shkurtër i orës mësimore (minutazha e orës e shkurtuar),
- Ndarma e nxënësve nëpër grupe,
- Zbatueshmëria e planeve mësimore të hartuara nga MASH,
- Lëndët mësimore të reduktuara, mbajtja e maskës,
- Pasiguria në aspektin e pritshmërisë se çfarë dhe si të veprohet në një situatë në të cilën asnjë institucion shkollor nuk ka qenë më herët,
- Zëvendësimi i personelit arsimor i cili gjatë kësaj kohe ka qen i infektuar me Covid 19,
- Pamundësia e mbuluëshmerisë së orëve mësimore në rastet kur kemi pasur mësimdhënës të cilët kanë qenë të infektuar me COVID-19,
- Organizimi i hyrjes dhe daljes së nxënësve në shkollë dhe në oborrin e shkollës,
- Ndërprerja e aktivitetave të ndryshme në shkollë,
- Mungesa e nxënësve në shkollë,
- Vështirësi në arritjen e objektivave mësimore lëndët:

Edukim Fizik (2 orë për secilën klasë), Kulturë Muzikore (1 orë), Kulturë Figurative (1 orë) dhe Mësimin zgjedhor (1 orë) të zhvilluara sipas skenarit C (mësimi në distancë).

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (pushime të lehonisë, pushime mjekësore, pushime pa pagesë) si dhe kërkesa të tjera të cilat kanë qenë të adresuara në drejtorin tonë.

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Synimi i punës së Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport është që të arrihen suksese të mëtutjeshme dhe sa më të mëdha në funksion të aktivitetave kulturore, rimore dhe sportive dhe sektoreve perkatës konform kompetencave që ka ky drejtorat.

Në kuadër të kompetencave tona kemi punuar sipas planit të punës dhe arritjes se objektivave dhe qellimeve të drejtoratit, drejtorati ka arritur të përmbushe objektiva sipas planit të punës.

Gjatë muajve Janar - Dhjetor në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitetet që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Aktivitetet e Realizuara

Aktivitetet e DKRS-së mund të themi qw janw ndikuar nga Covid -19, por është e rëndësishme që në secilin moment është ruajtur shëndeti i qytetarëve.

Në vitin që lam pas janë organizuar këto aktivitete: aktivitetet e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, subvencionimi i OJQ-ve sportive dhe kulturore për vitin 2021, është dorëzuar raporti vjetor i Bibliotekës së Qytetit në Bibliotekën Kombëtare, kemi nënshkruar mëmorandum bashkëpunimi me organizatën UNICEF-Kosova, mbi të drejtat e fëmijëve dhe vazhdimi i bashkëpunimit edhe për pesë vitet e ardhëshme, kemi bërë dekorimin e qytetit të Lipjanit me flamurë kombëtar dhe shtetëror, hapja e ekspozitës së fotografit Lipjanas Valdrin Aliu, ku është prezantuar komuna e Lipjanit përmes fotografisë, organizimi i debatit me të rinjët e komunës së Lipjanit dhe kryetarit. Gjithashtu kemi bërë dezinfektimi i të gjitha sallave dhe objekteve që janë nën menaxhim të DKRS-së, ka vazduhar puna në klasifikimin dhe ndarjen e materilait arkivore, kemi shnuar ditët e rëndësishme të Komunës së Lipjanit, atë të 12 qershorit, Dita e Çlirimtë Komunës së Lipjanit dhe 14 qershorin, Dita e Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit duke mbajtur akademi perkujtimore, homazhe pranë lapidarëve dhe varrezave të të rënëve, martirëve dhe dëshmorëve të Komunës së Lipjanit, realizimi i filmit dokumentar kushtuar dëshmorit Vezir Kolshi nga fshati Baicë dhe e kemi shfaqur në përvjetorin e tij të rënjes.

Në këtë periudhë raportuese kemi rikthyer aktivitete sportive, duke hapur sallat e sportit, ndërsa aktivitetet e klubeve sportive i kemi zhvendosur në dy sallat sportive të shkollave të qytetit për shkak se kemi liruar qendrën arsimore sportive "Better Life" të përdoret si qendër vaksinimi. Në qendrën sportive në Magure kemi ofruar një zyre për administratën komunale që të shfrytëzohet si zyre e vendit,

Në vitin 2021 kemi filluar implementimin e projektit "Fuqizimi i transparencës mbi të drejtat e njeriut" që implementohet nga IKMK dhe financohet nga CDF, kemi shnuar ditën e Tokës me aktivitetin e ngjyrosjes së ulseve në parqet e qytetit të Lipjanit, është shnuar dita e Librit, duke mbajtur takim dhe bashkëbisedim me autorë të ndryshëm të komunës sonë, si dhe është hapur një zyre për të rinjët e fshatit Shalë në bashkëpunim me projektin e fituar nga Ipko Foundation dhe komuna e Lipjanit.

Po ashtu janë promovuar tre libra: libri i autorit Isuf Buxhovi "Kosova Histori e Shkurtër", libri i autorit Sefer Tasholli "Plojë e Madhe" si dhe libri i autorit Xhevati Berisha "Kthem në burgun tim".

Gjatë kwsaj periudhe raportuese kemi realizuar edhe aktivitete të ndryshme në javën e diasporës, turniri "Kupa e Diasporës 2021" si dhe Koncerti festiv për bashkëatdhetarët në sheshin "Adem Jashari".

Gjithashtu kemi organizuar garën tashmë tradicionale me bicikleta "Tour de Lipjan", është prezantuar shfaqja "Çelësi Magjik" nga të rinjët e komunës së Lipjanit në bashkëpunim me OJQ Art Polis, organizimi i turnirit në lojën e Shahut në objektin e bibliotekës së qytetit, eksposita në sheshin "Adem Jashari", eksposita e piktorit Lipjanas Beg Kerpuzi "Piccaso", shfaqja e koncertit të baletit në shtëpinë e kulturës "Tahir Sinani", organizimi i tryezës "Roli i të rinjëve shqipëtar në proceset vendimarrëse përgjatë historisë". Dita Nderkombëtare e Rinisë është shënuar me Konferencën Rinore Lokale 2021, të mbajtur në bibliotekën e qytetit si dhe është shënuar muaji i mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuar dhe muaji rozë i kancerit të gjirit. Në fund të vitit është bërë dekorimi i qytetit të Lipjanit për festat e fundvitit.

Investimet Kapitale

Ka përfunduar Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Sillovi

Ka vazduhar Rregullimi i Fushës së Futbollit në Magure, ndërtimi i tribunave dhe zhveshtoreve në stadionin e futbollit të Dobrajës së Madhe.

Ka vazduhar ndërtimi i Palestrës së re sportive në Lipjan,

Ka përfunduar ndërtimi i stadionit të qytetit Sami Kelmendi në Lipjan,

Ka përfunduar fusha sportive në gjimnazin "Ulpiana" në Lipjan,

Ka përfunduar ndërtimi i shtatoreve në qytetin e Lipjanit, Haredin Bajrami, Xhavit Kozhani dhe Ruzhdi Shabani,

STATISTIKAT

Pasqyra totale e lëndëve të pranuara nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Hedhur Poshtë	Pezulluar
256	195	61	0	0	0

Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara (kopje nga Arkivi)	Mungese dokumetacionit
104	80	603	-

Raport për Bibliotekën e Qytetit në Lipjan, Gadime, Shalë

Lexues të rinjë	Përpunim i librit	Lexus në sallën e leximit
1209	967	7036

DISKUTIME PUBLIKE

- Diskutime publike me të rinjët e komunës sonë, për të parë nga afër se cilat janë sfidat dhe problemet që hasin ata.

DREJTORATI PËR BUXTET DHE FINANCA

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtorati për Buxhetet dhe Financa ka siguruar implementimin e plotë të Ligjit mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, Ligjin mbi prokurimin Publik Nr. 04-L-042, Rregullat Financiare dhe legjislacionin tjetër në fuqi për menaxhimin e parasë publike.

Ky raport përfshinë të dhënat vjetore nga sektorët e Drejtoratit për Buxhetet dhe Financa si:

- Sektori i Buxhetit dhe Financave duke përfshirë edhe të dhënat nga Regjistrimi i Pasurisë Komunale dhe Arka,
- Sektori i Thesarit dhe
- Sektori i Tatimit në Pronë.

PUNËT DHE AKTIVITETETE E REALIZUARA(IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Sektori për Buxhetet dhe Financa

Në përputhje me legjislacionin në fuqi Sektori per Buxhetet dhe Financa kryen këto aktivitete:

- Pasqyrat financiare.
- Planin e rrjedhes së parasë.
- Propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake nga viti paraprak në vitin vijues.
- Raporte dhe njofton drejtoritë mbi ecurinë e shpenzimeve, përmes programit "Free Balance".
- Raporte tremujore, gjashtëmujore, nëntemujore dhe vjetore për Asamblen Komunale,
- Pergaditë Planifikimin e Buxhetit në bazë të qarkoreve buxhetore – KAB.
- Alokimin e mjeteve.
- Zotimin e mjeteve.
- Regjistrimin e të hyrave në SIMFK, kërkesen për alokimin e të hyrave, barazimin me Thesar-MF, barazimin e të hyrave me drejtorate.
- Evidentimin dhe regjistrimin e pasurisë komunale.
- Inkasimet dhe raportimet nga arka.

Sektori i Thesarit

Objektiv parësor i Sektorit të Thesarit është kyerja dhe procesimi i lëndëve në kohë dhe në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi si dhe përshkrimi i procedurave:

- Për aprovim të shpenzimeve në sistemin e SIMFK.
- Qertifikimin e lëndeve të të gjitha drejtoreve.
- Evidentinimin dhe regjistrimin e shpenzimeve sipas fondeve, programeve, kodeve dhe kategorive ekonomike.
- Arkivimi i lëndeve.

Sektori i Tatimit në Pronë

Në përputhje me Ligjin e Tatimit në Pronën e Paluejtëshme dhe akteve nënligjore, Rregulloren komunale për caktimin e Shkallës Tatimore - Sektori i Tatimit në Pronë:

- Bën evidentimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pronës së paluejtshme.
- Regjistrimin e pronave të reja.
- Futjen e të dhenave në sistemin e tatimit në pronë.
- Modifikimin e pronave të regjistruara të tatimpaguesëve.
- Shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesve, shqyrtimi i lëndeve sipas ankesave dhe dalje në teren për verifikim.
- Lëshon qertifikatë-veritetim për kryerjen e obligimeve të tatimit ne pronë sipas kërkeses së tatimpaguesëve (qertifikata të ndryshme).
- Regjistrimi i kontratave të shitëblerjes në programin e tatimit në pronë.
- Marrëveshje me tatimpagues për kryejen e obligimit në tatimin në pronë.
- Shtypja e faturave për nevojat e tatimpaguesëve nga Zyra e tatimit pronë.
- Te hyrat e realizuara në tatimin në pronë.

STATISTIKAT

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

Përgaditja dhe dorëzimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2020

Pasqyrat Fiannciare janë përgatitur dhe dorëzuar në MF më 31 Janar 2021, brenda afateve të përcaktuar kohore. Këto pasqyra kanë reflektojë një situatë reale mbi menaxhimin e buxhetit dhe menaxhimin financier të Komunës së Lipjanit.

Dorëzimi i planit të punës për vitin 2021

Plani i punës është dorëzuar në Janar të vitit 2021, dhe ka përfshir objektivat dhe aktivitetet e të tri sektorëve të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa për vitin 2021. Një ndër objektivat kryesore të këtijë plani ka qenë transparenca dhe publikimi i të gjitha raporteve lidhur me menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, raporteve rreth inkasimit të të hyrave vetanake dhe menaxhimin e pasurisë.

Dorëzimi i raportit të punës për vitin 2020

Raport i punës për vitin 2020, është dorëzuar në janar të vitit 2021. Ky rapport i përgjithësuar ka ofruar informacione rreth punëve, me të cilat kanë qenë të ngarkuar të tre sektorët dhe ka ofruar një informacion të shpenzimit të buxhetit sipas burimeve të financimit dhe kategorive ekonomike, menaxhimit dhe inkasimit të të hyrave vetanake, menaxhimit të pasurisë, tatimin në pronë dhe pagesat e kryera nga sektori i thesarit. Raporti vjetor i shpenzimeve dhe realizimi i të hyrave vetanake per vitin 2020 është raportuar në mbledhjen e muajit janar të Kuvendit Komunal nga Drejtori për Buxhet dhe Financa.

Alokimi i mjeteve

Alokimi i mjeteve nga granti qeveritar (10), ka filluar në janar 2021. Pas aprovimit të buxhetit alokimi i mjeteve në të gjitha kategoritë është bërë në periudha tremujore, siç është kerkuar me planin e rrjedhës së parasë.

Të gjitha drejtoratet dhe ZKA, janë njoftuar me kohë për alokimin e mjeteve, me qëllim të incimit të kërkesave për zotim të mjeteve. Kërkesat mujore janë dërguar me rregull në Thesari Qendror për alokimin e të hyrave vetanake.

Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara të vitit 2019 dhe 2020 në vitin 2021

Është përgaditur dhe dorzuar propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2020 në vitin 2021, si dhe është aprovuar në seancën e Kuvendit Komunal të muajit Mars, shuma e bartur 930,195.96 €.

Bartja e të hyrave Vetanake nga viti 2019 dhe 2020 në vitin 2021 është bërë në këto programe dhe kategori ekonomike:
-Mallra dhe shpenzime: 72,053.06 €; Shpenzime komunale: 28,026.53 €; Subvencione dhe transfere: 33,142.86 €; Pasuritë jofinanciare 796,973.51 €.

Pranimi i Qarkores së Parë Buxhetore

Qarkorja e parë buxhetore na është dorëzuar nga MF në muajin maj 2021, e cila ka pasë për qëllim ofrimin e kufijve fillestare të financimit të Buxhetit Komunal, afatet kohore për përgaditjen e buxhetit të propozuar dhe kërkesat për ndarjet buxhetore për vitet 2022-2024.

Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024

Duke u bazuar në Qarkoren e parë buxhetore kemi punuar në zhvillimin dhe përpilimin e KAB 2022-2024. Përveç kësaj janë shqyrtuar priorititetet e Buxhetit Komunal, duke punuar dhe koordinuar me drejtoratet në vendosjen e kufijve të brendshëm buxhetor, në përputhje me Financimin Komunal me Qarkoren e Parë Buxhetore.

Në KAB-in 2022-2024 janë planifikuar shpenzimet e përgjithshme Komunale 2022-2024, sipas kategorive ekonomike. Pas konsultimeve të shumta me drejtoret e drejtorateve, hollësish janë analizuar investimet të cilat do të bëhen në vitin 2022-2024. Gjatë muajit qershor 2021 KAB-i është analizuar në strukturat Komunale dhe është prezantuar në Bordin e Drejtoreve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete dhe strukturat e grupet tjera.

Drejtoreve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete dhe strukturat e grupet tjera. Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024 është aprovuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal në muajin Qershor 2021, në afatin e rregullt të paraparë nga Ministria e Financave dhe e kemi dorzuar.

Qarkorja e Dytë Buxhetore

Qarkorja e dytë buxhetore është pranuar nga Ministria e Financave në muajin Gusht 2021, e kemi shpërndarë te Drejtoritë Komunale të angazhuara në hartimin e planifikimit të buxhetit 2022-2024.

Bazuar në udhëzimet e dhëna me këtë qarkore buxhetore, në masën e planifikuar monetare për paga dhe meditje është përfshirë kostoja e përvojës së punës, 0.5% të pagës bazë për cdo vit pune.

Sipas Qarkores Buxhetore, struktura e shpenzimeve për Buxhetin Komunal për vitin 2022 ka qenë si vijon:

Buxheti për vitet 2022-2024 do të financohet:

FONDI BURIMOR	2022	2023	2024
Granti i Pergjithshëm	6,069,137.00	6,339,028.00	6,645,155.00
Granti specifik i Arsimit	7,242,060.00	7,604,163.00	7,984,371.00
Granti specifik i Shendetësisë	1,996,362.00	2,096,180.00	2,200,989.00
Të hyrat vetanake	2,108,823.00	2,198,525.00	2,300,555.00
Sherbimet Rezidenciale	177,250.00	180,000.00	180,000.00
Gjithësejt:	17,593,652.00	18,417,896.00	19,311,070.00

Mjetet financiare shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	2022	2023	2024
Paga e Méditje	9,986,000.00	10,113,500.00	10,113,500.00
Mallra dhe Shërbime	1,998,000.00	1998,000.00	1998,000.00
Shërbime Komunale (Komunalit)	330,000.00	330,000.00	330,000.00
Subvencione dhe Transfere	666,000.00	742,000.00	772,000.00
Investime Kapitale	4,613,652.00	5,234,396.00	6,097,570.00
TOTALI	17,593,652.00	18,417,896.00	19,311,070.00

Përgaditja, planifikimi dhe aprovimi i buxhetit 2022-2024

Buxheti për vitet 2022-2024 është dorzuar në seancën e Kuvendit Komunal në muajin Shtator brenda aftatit kohor, është aprovuar nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, ku i njejti është dorëzuar në Ministrinë e Financave. Sipas procedurave të dhënët nga planifikimi buxhetor janë futur në sistemin e BDMS dhe PIP.

Buxheti i planifikuar, i aprovuar nga Kuvendi Komunal në shtator te vitit 2021, për vitin 2022 ka qenë 17,593,652.00€. Në ndarjen e planifikuar të buxhetit sipas fondeve burimore pjesëmarrja e grantit qeveritar ka qenë në vlerë 15,484,809.00€ shprehur në perqindje 88.01%, ndërsa pjesëmarrja e planifikuar e të hyrave vetanake në buxhetin e Komunës ka qenë 2,108,823.00€ shprehur në perqindje 11.99%, të buxhetit të përgjithshëm.

Siç kërkohet me Qarkore Buxhetore, në Ministrinë e Financave janë dorëzuar këto dokumente:

-Shkresa përcjellëse, e nënshkruar nga Kryetari i Komunës, bazuar në Aprovimin e Buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitet 2022-2024.
-Vendimi i Kuvendit Komunal mbi miratimin e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitet 2022-2024.

- Tabelat e Buxhetit Komunal BDMS dhe PIP.
- Tabela 4.1, e shtypur nga BDMS dhe e nënshkruar, e cila përfshinë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të Komunës për vitet 2022-2024.
- Tabela 4.2, e shtypur nga Sistemi PIP dhe e nënshkruar, e cila përmbanë financimin vjetor të projekteve Kapitale për vitet 2022-2024,
- Tabelen 4.3, e shtypur nga BDMS dhe e nënshkruar, e cila përmban planin afatmesëm të të hyrave totale të Buxhetit Komunal

Transferi dhe rialokimi i buxhetit për vitin 2021

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Gusht, nga Kuvendi Komunal është aprovuar transferi dhe rialokimi i buxhetit në kategorinë ekonomike pasuri jofinaciare (investime kapitale) në vlerë 165,960.00 €, në të njejtën kategori ekonomike.

Bartja e rezerveve komunale

Me vendim të Kuvendit Komunal, në muajin shtator është bërë bartja e rezerveve komunale (pasuri jofinaciare), në vlerë 135,000.00€. Këto rezerva janë transferuar-rialokuar në të njejtën kategori ekonomike

Raportimet periodike për shpenzimin e buxhetit të vitit 2021

Duke u bazuar në raportin përbledhës nga Free Balanc-i, kemi përpiluar raportet përbledhëse për realizimin e buxhetit komunal, si dhe kemi rapportuar në baza të rregullta te ZKA dhe te secili drejtorat. Raportimet periodike të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa janë bërë si vijon:

- Raportet javore për realizimin e buxhetit komunal dhe aktivitetet gjatë periudhës reportuese.
- Raportet mujore të cilat janë publikuar në Web-faqen e Komunës së Lipjanit, rapportet mujore për obligimet financiare të reportuara në MF.
- Raporti 3 mujor i shpenzimit të buxhetit, si dhe të hyrave vetanake dhe realizimit të projekteve kapitale, raportim në mbledhjen e Kuvendit Komunal.
- Raportet 3 mujore rreth realizimit të Investimeve kapitale dhe të gjitha kategorive tjera ekonomike për MF, ZKA.
- Raporti gjashtëmujor, raportim në mbledhjen e Kuvendit Komunal.
- Raporti nëntëmujor, raportim në mbledhjen e Kuvendit Komunal.
- Raporti vjetor, raportim në mbledhjen e Kuvendit Komunal, si dhe raport vjetor për Kryetarin e Komunës.

Raporti vjetor i buxhetit dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve për vitin 2021 për Komunën e Lipjanit

Buxheti i Komunës së Lipjanit për vitin 2021 i miratuar në shtator të vitit 2020, ka qenë në vlerë 16,719,155.00€, ndërsa buxheti perfundimtar në SIMFK , ka qenë 18,532,860.04 €. Ky ndryshim në mes të buxhetit të aprovuar në Kuvendin Komunal dhe buxhetit të alokuar, ka ardhur si rezultat i bartjes së të hyrave vetanake, huamarrjes, mjetet e alokuara me vendime të Qeverisë dhe donacioneve.

Shpenzimi i Buxhetit, deri më 31.12.2021, ka qenë në vlerë 17,808,413.89 € shprehur në përqindje 96.09%. Realizimi i shpenzimit në fondin burimor Granti Qeveritar ka qenë 98.48%. Kurse realizimi i shpenzimit të të hyrave vetanake të gjeneruara gjatë vitit 2021 ka qenë 88.65%. Shpenzimi i të hyrave vetanake të bartura ka qenë 71.52% si dhe huamarrja 99.89%.

Buxheti dhe shpenzimet sipas fondeve burimore

	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimi	Diferencia	Real. % shpenz.
4	FINANCIMET NGA HUAMARRJET	70,049.96	69,971.42	78.54	99.89
10	GRANTI QEVERTAR	15,258,817.88	15,027,299.15	231,518.73	98.48
21	TE HYRAT VETANAKE	1,907,316.00	1,690,783.75	216,532.25	88.65
22	TE HYRAT VETANAKE TË BARTURA	930,195.96	665,239.40	264,956.56	71.52
31,52,61,9 3,99	DONACIONET E BARTURA	366,480.24	355,120.17	11,360.07	96.90
	Totali i Përgjithshëm	18,532,860.04	17,808,413.89	724,446.15	96.09

Buxheti dhe shpenzimet kategorive ekonomike

	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	Real. % shpenz.
11	PAGA DHE MEDITJE	10,080,733.84	10,075,471.92	5,261.92	99.95
13	MALLRA DHE SHËRBIME	1,790,253.61	1,742,262.08	47,991.53	97.32
14	SHPENZIME KOMUNALE	308,026.53	266,640.11	41,386.42	86.56
22	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	603,142.86	445,909.27	157,233.59	73.93
30	INVESTIME KAPITALE	5,750,703.20	5,278,130.51	472,572.69	91.78
	Totali i Përgjithshëm	18,532,860.04	17,808,413.89	724,446.15	96.09

Buxheti dhe shpenzimet nga huamarrja(04)

	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	Real. % shpenz.
11	11-PAGA DHE MEDITJE	40,644.96	40,644.96	0.00	100.00
04	13 MALLRA DHE SHËRBIME	16,530.00	16,529.00	1.00	99.99
04	30 PASURITË JOFINANCIARE	12,875.00	12,797.46	77.54	99.40
	Totali i Përgjithshëm	70,049.96	69,971.42	78.54	99.89

Buxheti dhe shpenzimet nga granti qeveritar(10)

	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	Real. % shpenz.
10	11 RROGA DHE PAGA	9,981,228.88	9,981,228.88	0.00	100.00
10	13 MALLRA DHE SHËRBIME	1,399,750.00	1,371,139.17	28,610.83	97.96
10	14 SHPENZIME KOMUNALE	226,500.00	223,599.95	2,900.05	98.72
10	20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	70,000.00	67,723.00	2,277.00	96.75
10	30 PASURITË JOFINANCIARE	3,581,339.00	3,383,608.15	197,730.85	94.48
	Totali i Përgjithshëm	15,258,817.88	15,027,299.15	231,518.73	98.48

Buxheti dhe shpenzimet nga të hyrat vetanake(21)

	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	Real. % shpenz.
21	11 RROGA DHE PAGA	20,000.00	20,000.00	0.00	100.00
21	13 MALLRA DHE SHËRBIME	300,000.00	283,665.88	16,334.12	94.56
21	14 SHPENZIME KOMUNALE	53,500.00	23,285.27	30,214.73	43.52
21	20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	500,000.00	349,217.27	150,782.73	69.84
21	30 PASURITË JOFINANCIARE	1,033,816.00	1,014,615.33	19,200.67	98.14
	Totali i Përgjithshëm	1,907,316.00	1,690,783.75	216,532.25	88.65

Buxheti dhe shpenzimet nga të hyrat e bartura(22)

	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	Real. % shpenz.
22	13 MALLRA DHE SHËRBIME	72,053.06	70,525.03	1,528.03	97.88
22	14 SHPENZIME KOMUNALE	28,026.53	19,754.89	8,271.64	70.49
22	20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	33,142.86	28,969.00	4,173.86	87.41
22	30 PASURITË JOFINANCIARE	796,973.51	545,990.48	250,983.03	68.51
	Totali i Përgjithshëm	930,195.96	665,239.40	264,956.56	71.52

Buxheti dhe shpenzimet nga donatorët

	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	Real. % shpenz.
31	11 RROGA DHE PAGA	38,860.00	33,598.08	5,261.92	86.46
31	13 MALLRA DHE SHËRBIME	1,914.95	403.00	1,511.95	21.04
31	30 PASURITË JOFINANCIARE	745.21	0.00	745.21	0.00
52	31 PASURITË JOFINANCIARE	2.58	0.00	2.58	0.00
61	30 PASURITË JOFINANCIARE	323,662.69	320,578.38	3,084.31	99.05

93	13 MALLRA DHE SHËRBIME	5.60	0.00	5.60	0.00
93	30 PASURITË JOFINCIARE	1,289.21	540.71	748.50	41.94
	Totali i Përgjithshëm	366,480.24	355,120.17	11,360.07	96.90

Investime kapitale

Vlera e mjeteve në Buxhetin e vitit 2021, për kategorinë Investime Kapitale ka qenë 5,750,703.20 €.

Realizimi i Investimeve Kapitale nga Granti Qeveritar është 94.48%, ndërsa realizimi i investimeve kapitale nga të gjitha fondet burimore deri më 31.12.2021, është 91.78%. Shumica e pjesës së mbetur të mjeteve të pashpenzuara të investimeve kapitale, përfshinë mjetet nga të hyrat vetanake, të cilat inkasohen në muajin Nëntor dhe Dhjetor.

Tabela e Investimeve Kapitale për vitin 2021:

Pershkrimi per investime kapitale 2021 Lipjan	Buxheti për financimin e investimeve kapitale	Shpenzimi për investime kapitale	Diferencia
04 FINANCIET NGA HUAMARRJET	12,875.00	12,797.46	77.54
93060 ARSIMI FILLOR - LIPJAN	12,875.00	12,797.46	77.54
42131 MJETE KOKRETIZIMI,PAISJE TEKNOLOGJISC INFORMATIVË-LIPJAN	12,875.00	12,797.46	77.54
10 BUXHETI	3,581,339.00	3,383,608.15	197,730.85
16003 ZYRA E KRYETARIT - LIPJAN	50,000.00	50,000.00	0.00
89224 PAGESA PER VENDIME GJYQESORE	50,000.00	50,000.00	0.00
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	2,328,587.00	2,211,067.31	117,519.69
42143 RIKONSTRUIMI I NDRIQIMIT PUBLIK NE QYTETIN E LIPJANIT	7,396.00	7,395.84	0.16
42144 VAZHDIMI I NDERTIMIT SHTRATIT TE LUMIT NE DOBRAJE TE MADHE	22,350.00	22,349.32	0.68
44511 BASHKFINANCIMI ME DONATOR	60,000.00	17,302.29	42,697.71
47416 NDËRTIMI I SHTRATIT TË LUMIT BUJARI	79,000.00	71,733.39	7,266.61
47422 MIRMBAJTA INVESTIVE E NDRIQIMIT PUBLIK NE QYTET DHE FSHATRA	5,080.00	5,078.40	1.60
47436 ASFALTIMI I RRUGICAVE NË MEDVEC	58,444.00	53,671.22	4,772.78
47756 MIRËMBAJTA DHE REHABILITIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT	24,100.00	24,000.00	100.00
47776 MJETET L DEDIKUARA PËR SHPRONSIM	100,000.00	99,880.00	120.00
47780 NDËRTIMI I OBJEKSTIT TË RI TË ADMINISTRATËS KOMUNËS LIPJAN	200,000.00	199,986.30	13.70
49136 NDERTIMI I RRJETIT TE NDRIQIMIT PUBLIK PERGJAT' RRUGES LIPJAN	6,650.00	6,650.00	0.00
4948 ASFALTIMI I RRUGEVE NË KROJIMIR(AFERDITA QERIQI, RR. E SHPETIMIT	22,000.00	21,261.90	738.10
49158 NDERTIMI I RRUGES GRYKA E SHPETIMIT NE KROIMIR	90,000.00	89,969.82	30.18
49162 NDERTIMI I KOLEKTORIT TE UJRAVE TE ZEZA PER FSHATRAT BLINAJË, QYLAGE DHE DOBRAJE E MADHE	30,000.00	30,000.00	0.00
49333 ZGJERIMI I RRJETIT TE KANALIZIMIT NE QYTETIN E LIPJANIT DHE	14,601.00	14,600.00	1.00
49351 ASFALTIMI I RRUGICAVE NE GRACK TE VJETER	43,930.00	41,498.54	2,431.46
49358 NDERTIMI I TROTUARVE DHE NDRIQIMI PUBLIK NE F. DOBRAJE	35,000.00	34,982.45	17.55
49362 NDRIQIMI PUBLIK NE MEDVEC DHE VRELL TE MAGURES	16,054.00	16,053.08	0.92
49366 ASFALTIMI I RRUGICAVE NE RESINOVÇ	7,016.00	7,015.52	0.48
49372 ASFALTIMI I RRUGICAVE NE FSHATIN BAICE	13,200.00	11,958.82	1,241.18
49399 VAZHDIMI I NDERTIMIT TE SHESHIT ADEM JASHARI PJESA II	877.00	0.00	877.00
50767 ASF. I RRUGICAVE NE KONJUH DHE ZHAVORIMI I RR. NE BRANESH	70,017.00	68,571.51	1,445.49
50770 AS I RRUGICAVE NE HALLAQ TE V. RUFC TE RI DHE RUFC TE VJ.	70,853.00	64,149.55	6,703.45
50772 RIASFALTIMI I RRUGES SHEN FLORI DHE SKENDERBEU- LIPJAN	64,089.00	62,400.81	1,688.19
50777 ASFALTIMI I RRUGICAVE FAZA III NE GADIME TE EPERME DHE ULLT	65,000.00	63,000.90	1,999.10
50786 NDERTIMI I SHETITORES TE PISHAT NE GADIME	148,938.00	148,938.00	0.00
50787 ASFALTIMI I RRUGICAVE NE VARIGOVÇ	25,876.00	25,351.77	524.23
50788 ASFALTIMI I RRUGICAVE NE BUJARI FAZA II	63,101.00	62,399.00	702.00
50789 ASFAL. I RRUGICAVE , TROTUAREVE, NDRIQIMI PUBLIK I BREGU I ZI	79,000.00	79,000.00	0.00
50790 ASFALTIMI I RRUGICAVE NE SLOVI FAZA III	78,497.00	78,497.00	0.00
50791 ASFALTIMI I RRUGICANE NE JETEN E RE (TOPLIQAN I RI) FAZA II	54,200.00	50,171.45	4,028.55

50792 ASFALTIMI I RRUGICAVE NE GRACK TE VOGEL	37,855.00	36,180.77	1,674.23
50793 ASFALTIMI I RRUGEVE NE LIPJAN FAZA III	55,000.00	54,999.90	0.10
50794 NDRIQIMI PUBLIK NE HALLAQ TË MADH	26,402.00	26,341.20	60.80
50795 NDRIQIMI PUBLIK ME DOBRAJE E VOGEL, LLUGA DHE GLLANICË	47,723.00	46,453.87	1,269.13
50796 ZGJERIMI I NDRIQIMIT PUBLIK NE RIBARE TE VOGEL	35,000.00	34,478.33	521.67
50797 ZGJERIMI I RRJETIT TE KANALIZ. NE GLLAVICE, MAGURE , DOBRAJË	35,000.00	35,000.00	0.00
50841 NDRIQIMI PUBLIK NE LELETIQ DHE VERSHEVC	71,619.00	67,360.62	4,258.38
51095 ASFALTIMI I RRUGICAVE NE MIRENE	41,550.00	39,020.12	2,529.88
51199 REH RRJE TE KAN ATMOS.DHE UJRAVE TE ZEZA NE GRACKE TE VJ.	45,000.00	38,661.13	6,338.87
51200 ND.P.DHL RR.HAP.PUB.NE DO. M.RIB. M,B,G,KO,LL.MA.P.B.SM.R.RI	60,000.00	60,000.00	0.00
51309 ASF.RR.NE RUB,JANJ,AKLLAP,RUFC,BANU,ZLLAK,KROJM.DHE VERSH	34,905.00	34,905.00	0.00
51310 NDRIÇIMI PUBLIK NE BAINCE DHE RESINOV FAZA E II.	32,055.00	19,812.45	12,242.55
51311 NDERTIMI I TROTUARIT NE LIPJAN RRUGA BAJRAM GASHI	19,000.00	17,869.46	1,130.54
51312 NDERT. I TROTUARIT ME NDRIQIM NE RR. PER GJILAN NE GADIME	22,000.00	12,485.18	9,514.82
51313 ZGJ.RRJ.TE KAN.FAZA E II , VER,KROJM,GADIME, RIBAR I MADH	18,000.00	18,000.00	0.00
51314 ZGJ.NDRIQ.PUBLIK LAGJ. F. MAGURE F2 DHE NË HYRJE TË F.SLILOVI	25,000.00	24,423.40	576.60
89225 ASFAL.RRUG SHQ.HAJ.BAJRAMI	167,209.00	167,209.00	0.00
66320 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - LIPJAN	100,000.00	99,798.30	201.70
47448 HARTIMI I PROJEKTEVE DETALE	100,000.00	99,798.30	201.70
73200 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - LIPJAN	65,000.00	27,001.05	37,998.95
49395 RENOVIMI I OBJ. TË STOMATOLOGJISË DHE PULMOLOGJISË NË QK	35,000.00	24,242.80	10,757.20
51201 ND.RR.PAR.PARK.NE QMF LIPJ.DHE AMF DOB.MA.BAB.GAD.DHE KRA	30,000.00	2,758.25	27,241.75
75512 SHËRBIMET REZIDENCIALE - LIPJAN	29,657.00	26,978.82	2,678.18
47843 ANFX OBJEKT PER AKTIVIT. NI: SHTEPIN ME BAZE NE KOMUNITET	19,657.00	19,201.82	455.18
50893 RENOVIMI I SHTEPIS ME BAZE NE KOMUNITET	10,000.00	7,777.00	2,223.00
85003 SHËRBIMET KULTURORE -LIPJAN	357,120.00	345,322.98	11,797.02
49379 NDERTIMI I PALESTRES SË RE SPORTIVE NË LIPJAN	220,000.00	219,971.99	28.01
50831 NDERTIMI I LAPIDARVE, XHAVIT KOZHANI, HARADIN BAJRAMI, RUZHDİ SHABANI DHE PLLAKA PERKUTIMORE NE SLLOVI	120,000.00	108,230.99	11,769.01
50913 NDERTIMI I BAZAMENTEVË PLR VLNDOSJEN L LAPIDARVË DHE PLLAKES PERKUTIMORE	17,120.00	17,120.00	0.00
92250 ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHET - LIPJAN	210,000.00	210,000.00	0.00
47444 NDERTIMI I QERDHES SË FËMIJVE NE SLLOVI	80,000.00	80,000.00	0.00
49383 NDERTIMI I QERDHES NE FSHATIN GADIME E ULËT	130,000.00	130,000.00	0.00
93060 ARSIMI FILLOR - LIPJAN	265,975.00	264,245.58	1,729.42
42157 RREGULLIMI I INFRAS. RRETHOJAVE PARKINGJEVE NE SHKOLLA	45,000.00	45,000.00	0.00
49163 NDERTIMI I SHKOLLES FILLORE NE LIPJAN	145,000.00	144,947.91	52.09
50919 RIKONSTRUIMI I DYSHEMES DHE TOALETEVE NE GJIM. " ULPIANA	46,349.00	45,472.99	876.01
51094 INSTALIMI I NXEMJEVE QENDRORE NE SHKOLLAT: AKLLAP, QYLAGF, RESINOV ETJ.	29,626.00	28,824.68	801.32
94260 ARSIMI I MESEM - LIPJAN	175,000.00	149,194.11	25,805.89
42158 NDERTIMI I SHKOLLES SE MESMË GADIME E EPGRME	130,000.00	118,688.44	11,311.56
42159 NDERTIMI I POLIGONIT SOPRTIV TE SHKOLLAT E MESME NE LIPJAN	45,000.00	30,505.67	14,494.33
21 TE HYRAT VETANAKE	1,033,816.00	1,014,615.33	19,200.67
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	1,013,816.00	995,152.83	18,663.17
44511 BASHKFINANCIMI ME: DONATOR	315,335.00	298,110.03	17,224.97
47776 MJETET E DEDIKUARA PËR SHPRONSIM	160,000.00	159,765.30	234.70
47780 NDERTIMI I OBIJEKTIT TË RI TË ADMINISTRATËS KOMUNËS LIPJAN	150,000.00	150,000.00	0.00
50786 NDERTIMI I SHETITOSES TE PISHAT NE GADIME	30,000.00	30,000.00	0.00
50790 ASFALTIMI I RRUGICAVE NE SLLOVI FAZA III	20,000.00	18,796.50	1,203.50
89225 ASFAL.RRUG SHQ.HAJ.BAJRAMI	338,481.00	338,481.00	0.00

66320 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKCIIONI - LIPJAN	20,000.00	19,462.50	537.50
47448 HARTIMI I PROJEKTEVE DETALE	20,000.00	19,462.50	537.50
22 TË HYRAT VETANAKE- 2018	796,973.51	545,990.48	250,983.03
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	524,063.76	453,494.21	70,569.55
44511 BASHKFINANCIMI ME DONATOR	182,180.00	156,447.63	25,732.37
47776 MJETET E DEDIKUARA PËR SHPRONSIM	70,000.00	69,936.00	64.00
47780 NDERTIMI I OBJEKSTIT TË RI TË ADMINISTRATËS KOMUNËS LIPJAN	90,000.00	90,000.00	0.00
49136 NDERTIMI I RRJETIT TE NDRIQIMIT PUBLIK PERGJAT RRUGES LIPJAN	12,121.25	11,737.80	383.45
49146 ASFALTIMI I RRUGEVE NE FSHATIN GADIME E EPERME (ZEQIR BEHLULI, QAMERIA, SHEFKI AJETI, VLLEZERIT LIMANI, RRUGA NE MES DY RRUGEVE, EKZODI 99	12,500.00	11,992.99	507.01
49165 REHABILITIMI I RRJETIT TE UJESJELLSIT NE FSHATIN KROJMIR	8,888.50	0.00	8,888.50
49358 NDERTIMI I TROTUARVE DHE NDRIQIMI PUBLIK NE FSHATIN DOBRAJE	12,761.00	8,211.00	4,550.00
51190 ND.P. RR.LLUG.GAD.DHE GADI.E UI.,ND.TR.ND,P.LIP-RRITH.JANJEVË	115,000.00	105,168.79	9,831.21
51191 NDERTIMI I SHTRATIT TE LUMIT JANJEVKA NE LIPJAN	20,613.01	0.00	20,613.01
85003 SHËRBIMET KULTURORE -LIPJAN	124,718.00	37,236.59	87,481.41
42097 RREGULLIMI STADIUMIT NE DOBRAJ TE MADHE DHE MAGURE FAZA II	71,683.00	34,541.37	37,141.63
42146 NDERTIMI I FUSHËS NDIHMËSE NE DOBRAJE TE MADHE	3,035.00	2,695.22	339.78
49379 NDERTIMI I PALESTRES SË RE SPORTIVE NË LIPJAN	50,000.00	0.00	50,000.00
92250 ARSIMI PARAFILELLOR ÇERDHET - LIPJAN	70,000.00	19,193.32	50,806.68
49383 NDERTIMI I QERDHES NE FSHATIN GADIME E ULET	70,000.00	19,193.32	50,806.68
93060 ARSIMI FILELLOR - LIPJAN	78,191.75	36,066.36	42,125.39
42157 RREGULLIMI I INFRAST. RRETHOJAVE PARKINGJEVE NE SHKOLLA	28,191.75	7,574.21	20,617.54
49163 NDERTIMI I SHKOLLES FILLORE NE LIPJAN	32,000.00	15,521.05	16,478.95
51192 RENOVIMI I BANJOVE NE SHFMU "IBRAHIM BANUSHI" SHALE	18,000.00	12,971.10	5,028.90
31 GRANT I DONAT.TË MBRENDSHËM	745.21	0.00	745.21
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	553.54	0.00	553.54
72010 MEREMETIMI I KANALIZIMIT NE FSHATIN BUJAN	8.50	0.00	8.50
72011 RREGULLIMI I VENDKALIMIT LIPJAN-SHTIME	24.00	0.00	24.00
72210 NDERTIMI KANALIZIMI FEKAL LIPJAN-BANULË	10.00	0.00	10.00
72358 RREGULLIMI I KANALIZIMIT FEKAL-MIRENE	11.04	0.00	11.04
92064 RREG.RRJET.SEKOND.KANALIZ.NE FSHATIN MEDVEC	500.00	0.00	500.00
47003 BUQËSIA - LIPJAN	191.67	0.00	191.67
72332 BLERJA E MAKINAVE MJELESE	191.67	0.00	191.67
52 QEVERTA GJERMANE	2.58	0.00	2.58
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	2.58	0.00	2.58
95286 NDERTIMI I QENDRES INFORMUESE TURISTIKE	2.58	0.00	2.58
61 QEVERTA ZVICRANE	323,662.69	320,578.38	3,084.31
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	323,662.69	320,578.38	3,084.31
92069 NGRTJE E PERFORMANCËS 2020	3,028.69	0.00	3,028.69
92111 PERFORMANCE KOMUNALE 2021	320,634.00	320,578.38	55.62
93 COUNCIL OF EUROPE	1,289.21	540.71	748.50
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	747.10	0.00	747.10
99347 PROM.QEVERTIS SË MIRE DHE FUQIZ.ROMEVE NE NIV.LOK	747.10	0.00	747.10
85003 SHËRBIMET KULTURORE -LIPJAN	542.11	540.71	1.40
99347 PROM.QEVERTIS SË MIRE DHE FUQIZ.ROMEVE NE NIV.LOK	542.11	540.71	1.40
Totali i Përgjithshëm	5,750,703.20	5,278,130.51	472,572.69

Të hyrat vetanake

Buxheti i miratuar i Komunës së Lipjanit për të hyra vetanake për vitin 2021 ishte në vlerë 1,907,316.00 €. Realizimi i të hyrave vetanake deri me 31.12.2021 ka qenë 2,425,741.34 €.

Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetaake 2021

Kodet Ekonomike	Planifikimi 2021	Realizimi 2021	indeksi	%
16303 - ADMINISTRATA-LIPJAN				
50013 - TAX CERTIFIKATAT E LINDJES	50,000.00	47,929.00	95.86	-4.14
50014 - TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	2,500.00	2,772.00	110.88	10.88
50015 - TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES	2,000.00	1,208.00	60.40	-39.60
50016 - TAX CERTIFIKATA TJERA	6,000.00	3,404.00	56.73	-43.27
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	8,000.00	5,683.00	71.04	-28.96
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	10,000.00	0.00	0.00	-100.00
50019- QENDRA PER SHERBIME SOCIALE	2,000.00	0.00	0.00	-100.00
50107 - GJOBAT TJERA	5,000.00	3,000.00	60.00	-40.00
16715 - PROKURIMI		0.00		
50020 - TAX E PESMARJES NË TENDER	1,500.00	320.00	21.33	-78.67
17503 - BUXHETIMI-LIPJAN		0.00		
50002 - TAX RRUGORE	100,000.00	125,320.00	125.32	25.32
40110 - TATIMI NË PRONË	903,311.00	1,078,478.59	119.39	19.39
- TATIMI NE TOKE		0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
48003 - PLANIF.ZHV.EKONOM LIPJAN		0.00		
50290 - LIC.TJERA PËR AFARIZËM	1,000.00	0.00	0.00	-100.00
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	50,000.00	26,435.19	52.87	-47.13
16605 - INSPEKSIONI-LIPJAN		0.00		
50104 - GJOBAT MANDTORE	3,500.00	1,241.58	35.47	-64.53
50205 - LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	6,000.00	2,401.00	40.02	-59.98
65015 - SHËRBIMET KADASTRALE LIPJAN		0.00		
50017 - TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME	40,000.00	38,919.00	97.30	-2.70
50011 - TAX REGJISTRIMIN E TRASHIGIMIS	55,000.00	66,196.66	120.36	20.36
50504 - TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	40,000.00	56,385.00	140.96	40.96
66320 - PLANIF.URBAN.INSPEKCI. LIPJAN		0.00		
50009 - TAX PËR LEJE NDÉRTIMI	198,505.00	377,252.34	190.05	90.05
50013 - TAX NDERRIMI DESTINIMI I TOKES	40,000.00	71,197.00	177.99	77.99
50026 - TAX PER LEGALIZIMIN E OBJEKTE.	40,000.00	47,353.53	118.38	18.38
50045 - TAX PER LEJE MJEDISORE	30,000.00	31,188.53	103.96	3.96
20010 - TAX PER DEMOLIM (rrenimi i objekteve)	2,000.00	1,843.19	92.16	-7.84
18163 - INFRASTRUKTURA PUBLIKE		0.00		
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	10,000.00	1,897.50	18.98	-81.03
50406 - PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	49,500.00	33,357.52	67.39	32.61
50103- LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJETEVE	2,000.00	0.00	0.00	-100.00
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	500.00	0.00	0.00	-100.00
50029- TAX PER USHTRIMIN E VEPRIMTARIS	2,000.00	420.00	21.00	-79.00
85003 - SHËRBIMET KULTURORE-LIPJAN		0.00		
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE (RHIVA)	500.00	274.50	54.90	-45.10
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONFS PUBLIKE	500.00	0.00	0.00	-100.00
GJITHESEJT I:	1,661,316.00	2,024,477.13	121.86	21.86
92250 - ARSIMI PARAFI & QERDHJA-LIPJAN	40,000.00	51,993.00	129.98	29.98
73200 - SHËRBIMET E KUJDFSIT PRIMAR SHËNDETESIA 73200-50409	45,000.00	43,491.50	96.65	-3.35
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE (PARTICIPIM) A.GLLAVICA	10,000.00	7,596.00	75.96	-24.04
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	500.00	0.00	0.00	-100.00
50409- SHKOLLA E MESME ULIPIANA	500.00	108.00	21.60	-78.40
GJITHESEJT II:	1,757,316.00	2,127,665.63	121.07	21.07
GJOBAT E TRAFIKUT	135,000.00	249,102.00	184.52	84.52
GJOBAT E GJYKATES	13,800.00	47,690.00	345.58	245.58
AGJENCIONI I PYJEVE	1,200.00	1,283.71	106.98	6.98
GJITHESEJT III:	1,907,316.00	2,425,741.34	127.18	27.18

Krahasimi të hyrave vetaake 2020-2021

Kodet Ekonomike	Realizimi 2020	Realizimi 2021	indeksi	%
16303 - ADMINISTRATA-LIPJAN				
50013 - TAX CERTIFIKATAT E LINDJES	32,388.50	47,929.00	147.98	47.98
50014 - TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	1,530.00	2,772.00	181.18	81.18
50015 - TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES	719.00	1,208.00	168.01	68.01
50016 - TAX CERTIFIKATA TJERA	2,972.00	3,404.00	114.54	14.54
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	4,606.00	5,683.00	123.38	23.38
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	16.64	0.00	0.00	-100.00
50019- QENDRA PER SHERBIME SOCIALE	800.00	0.00	0.00	-100.00
50107 - GJOBAT TJERA	1,300.00	3,000.00	230.77	130.77
16715 - PROKURIMI	0.00	0.00		
50020 - TAX E PËSMARJES NË TENDER	550.00	320.00	58.18	-41.82
17503 - BUXHETIMI-LIPJAN	0.00	0.00		
50002 - TAX RRUGORE	109,830.00	125,320.00	114.10	14.10
40110 - TATIMI NË PRONË	752,842.53	1,078,478.59	143.25	43.25
- TATIMI NE TOKE	0.00	0.00	0.00	0.00
48003 - PLANIF.ZHV.EKONOM-LIPJAN	0.00	0.00		
50290 - LIC.TJERA PËR AFARIZËM	0.00	0.00		
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	5,937.26	26,435.19	445.24	345.24
16605 - INSPEKCIIONI-LIPJAN	0.00	0.00		
50104 - GJOBAT MANDTORE	1,810.00	1,241.58	68.60	-31.40
50205 - LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	1,125.00	2,401.00	213.42	113.42
65015 - SHËRBIMET KADASTRALË-LIPJAN	0.00	0.00		
50017 - TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME	31,251.00	38,919.00	124.54	24.54
50011 - TAX REGJISTRIMIN E TRASHIGIMIS	35,565.50	66,196.66	186.13	86.13
50504 - TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	21,250.00	56,385.00	265.34	165.34
66320 - PLANIF.URBAN.INSPEKC.-LIPJAN	0.00	0.00		
50009 - TAX PËR LEJE NDËRTIMI	355,284.76	377,252.34	106.18	6.18
50013 TAX NDERRIMI DESTINIMI I TOKES	37,388.00	71,197.00	190.43	90.43
50026 - TAX PER LEGALIZIMIN E OBJEKTE.	13,512.94	47,353.53		
50045 -TAX PER LEJE MJEDISORE	32,449.63	31,188.53	96.11	-3.89
20010- TAX PER DEMOLIM (rrenimi i objektev)	0.00	1,843.19	#DIV/0!	#DIV/0!
18163 - INFRASTRUKTURA PUBLIKE	0.00	0.00		
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	750.00	1,897.50	253.00	153.00
50406 - PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	17,343.00	33,357.52	192.34	92.34
50103- LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJETEVE	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50019- TAX TJERA ADMINISTRATIVE	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50029- TAX PER USHTRIMIN E VEPRIMTARIS	4,410.00	420.00		
85003 - SHËRBIMET KULTURORE-LIPJAN	0.00	0.00		
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE (ARHIVA)	277.50	274.50	98.92	-1.08
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
GJITHSEJTI:	1,466,221.58	2,024,477.13	138.07	38.07
92250 - ARSIMI PARAFI & QFRDHJA LIPJAN	11,915.50	51,993.00	436.35	336.35
73200 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETESIA 73200-50409	36,613.50	43,491.50	118.79	18.79
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE (PARTICIPIM) A.GLLAVICA	17,175.21	7,596.00	44.23	-55.77
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50409- SHKOLLA E MESME ULIPIANA	132.00	108.00	81.82	-18.18
GJITHSEJTI II:	1,532,057.79	2,127,665.63	138.88	38.88
GJOBAT E TRAFIKUT	199,892.00	249,102.00	124.62	24.62
GJOBAT E GJYKATES	12,500.00	47,690.00	381.52	281.52
AGJENCIONI I PYJEVE	416.22	1,283.71	308.42	208.42
GJITHSEJTI III:	1,744,866.01	2,425,741.34	139.02	39.02

Donacionet në vitin 2021, kanë qenë 349,447.57 €.

Obligimet Financiare

• Mallra dhe Shërbime	180,700.40€
• Shpenzime komunale	3,181.42€
• Shpenzime Kapitale	68,209.10€
Total obligimet finaciare	252,090.10€

REXHISTRIMI I PASURISE KOMUNALE

Raporti i pasurise kapitale mbi 1000€:

1	Kanalizimet	5,280,377
2	Ndërtesat	21,681,013
3	Toka	64,953,480
4	Pajisjet tjera	229,030
5	Ndrtimi i rrugave	46,946,336
6	Instalimet hidro sanitare	1,945,569
7	Mobiljet	0
8	Ujsjellsat	413,495
9	Automjetet transportuese	52,612
10	Paisje Mjeksore	18,329
11	Kapital tjeter	1,562,836
12	Struktura Tjera	3,580,836
13	Trotuare	2,187,649
14	Investime ne vijim	8,171,150
	TOTALI	21,681,013

SEKTORI I THESARIT

Kjo pjesë e raportit ka për qëllim raportimin mbi ecurinë e Shpenzimeve në Komunën e Lipjanit për periudhën e vitit fiskal, nga 01.01- 31.12.2021 për kategoritë ekonomike si vijon:

Mallra dhe Shërbime, Komunalni, Subvencione dhe Transfere si dhe Investime Kapitale.

Regjistrimi i shpenzimeve në SIMFK, certifikimi dhe aprovimi i shpenzimeve si dhe arkivimi i lëndëve është bërë sipas procedurave të parapara të cilat janë në interes të Organizatës sonë Buxhetore, Departamentit të Thesarit në nivelin Qendorr dhe në interes të qytetarëve.

Që nga fillimi i vitit fiskal 2021 deri më 31.12.2021 në Sektorin e Thesarit janë kryer 4219 lëndë në vlerë 7,732,941.97 €. Të gjitha këto lëndë janë bërë shpenzim, janë certifikuar, aprovuar në SIMFK pastaj janë regjistruar dhe i janë dorzuar zyrtarit të arhivës për arhivim.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë ekzekutuar :

340 lëndë të vitit 2020 në vlerë 575,637.85 € - 8.06%

3878 lëndë të vitit 2021 në vlerë 7,157,304.12 € - 91,94%

Tabela e mjeteve të ekzekutara nga Thesari Qendorr, për të paguar obligimet financiare të trashëguara deri me 31.12.2021

Mjetet financiare nga janë marrur-Vendim gjyqesor		Qellimi i pageses -Vendim gjyqesor
Nga kategoria ekonomike paga dhe meditje	587,420.62	Paga dhe meditje
Nga kategoria ekonomike mallra dhe sherbime	13,995.69	6,891.20€ paga dhe meditje 7,104.59€ mallra dhe shërbime 4,502.58€ Investime kapitale(projektim)
Nga kategoria ekonomike shpenzime komunale	95.58	Shpenzime komunale
Nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere	48,000.00	Investime kapitale(projektim)
Nga kategoria ekonomike investime kapitale	50,000.00	Investime kapitale(projektim)
Gjithësejt	699,511.89	

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Në sektorin e Tatimit në Pronë viti 2021 llogaritet si vit shumë i suksesshëm, si në realizimin e të hyrave dhe punëve tjera që janë kryer në sektorin e Tatimit në Pronë.

Në fillim të vitit 2021, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, gjegjësisht Departamentin e Tatimit në Pronë, kemi nxjerrë dhe printuar me kohë faturat e tatimit në pronë për vitin 2021. Faturat e tatimit në pronë për vitin 2021, janë shpërndarë përmes PTK-së, nga raporti i PTK-së që kemi pranuar janë shpërndar 14,331 fatura, Komuna sipas marrveshjes dhe kontrates obligohet të paguajë shumën 8,382.52€ për printimin, zarfimin dhe shpërndarjen e faturave.

Në zyrën e tatimit në pronë, sipas kérkesave të tatimpagaseseve dhe për nevoja të tatimpagaseseve, për periudhën Janar-Dhjetor janë printuar 47120 fatura, kemi pranuar 59 ankesa të tatimpagaseseve, të cilët nuk janë pajtuar me ngarkesën e tatimit në pronë, 54 ankesa janë aprovuar në favor të tatimpagasesve, ndërsa 5 ankesa janë refuzuar si të pa bazuara, ku të gjitha ankesat janë shqyrtuar mbrenda afatit ligjor.

Gjatë vitit 2021 kemi pranuar edhe kérkesa të tjera, të cilat janë parashtruar nga tatimpagasesit në zyrën e tatimit në pronë si për shembull: kérkesa për ndërrim të pronarit, regjistrome të pronave të reja, apo shlyerje pasi janë rrënuar prona egzistuese, pra të gjitha kérkesa për korigjim, të cilat janë kryer nga ekipi i zyrtarëve për vlerësim të pronave të paluajtshme në teren gjatë verifikimit.

Numri i përgjithshëm i kérkesave ka qenë 470 kérkesa, 449 janë aprovuar, 8 janë refuzuar si dhe 13 kérkesa janë në pritje, të cilat pritet të shqyrtohen në fillim të vitit 2022.

112 kérkesa të tatimpagaseseve janë aprovuar për të hyrë në marrëveshje për pagesën e tatimit me këste, me të cilët është zhvilluar kontakt i vazhdueshem nga inkasanti, për të percjellur marrëvestjen se a po paguhen kestet më kohë, sipas afatit të përcaktuar.

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor janë lëshuar 13,750 certifikata me qellim të regjistrimit të veturave, 4900 certifikata janë lëshuar me qëllim të kryerjes së shërbimeve në kataster dhe urbanizëm, për subvencione në bujqësi si dhe vërtetime për humbje të nënshtesës.

Inkasimi i të hyrave nga tatimi në pronë gjatë vitit 2021, i planifikuar ka qenë 903,311.00 €, është realizuar në vlerë 1,078,478.59 €, ka tejkaluar planifikimin për 175,167.59 €, shprehur në përqindje 19.39% më shumë se planifikimi.

DISKUTIME PUBLIKE

Dëgjimet Publike për Palinfikim të Buxhetit 2022-2024

Kryetari i Komunës me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa dhe ZKF kanë mbajtur 16 dëgjime buxhetore lidhur me projekcionet buxhetore për vitet 2022-2024, janë përfshirë, Kuvendi, komitetet, grupe të interesit (qyteti i Lipjanit, fshatra, OJQ-të e ndryshme, të rinjtë, Shoqata e gruas etj).

Njoftimi për dëgjimet publike është shpërndarë me kohë në çdo lokalitet që është ftuar për dëgjime buxhetore, në institucionet publike dhe në webfaqe të Komunës së Lipjanit.

SFIDAT

Edhe gjatë vitit 2021, sfidë ka qenë ekzekutimi i lëndeve nga Thesari - MF për pagesën e obligimeve financiare nga vitet paraprake, i cili shkakton implikime buxhetore, që si pasojë ka një pasqyrë jo të saktë të shpenzimit, nëpër drejtori, në kode ekonomike dhe kode të projekteve.

Sfidë në Sektorin e Tatimit ne Pronë mundë ti paraqesim si:

Identifikimin dhe regjistrimin e të gjithë tatimpagaseseve, të cilëve në programin e tatimit në pronë u mungon numri i letërnjoftimit, fotot dhe GPS.

Përbushja e planit të hyrave nga tatimi në pronë duke dërguar vërejtjet e fundit si dhe bllokimi i llogarive rrjedhëse të të gjithë tatimpagasesit të cilët nuk i kanë përbushur obligimet në tatimin në pronë.

Gjithashtu sfiduese mund ta llogarisim edhe grumbullimin e lëndëve për shpenzim në fund te vitit buxhetor, e cila po krijon disproporcionalisht përqindjes së shpenzimit të buxhetit në periudha raportuese.

REKOMANDIME

Hartimin e një plani për identifikimin dhe rianketimin e të gjitha gjitha pronave që nuk i posedojnë fotot dhe Gps ne programin e tatimit në pronë, që ato të tatimohen drejtë sipas zonës tatimore.

QËSHTEJJE TJERA

Qëshje tjetër e cila është me rëndesi të raportohet, e që nuk është përfshirë me lartë në raport mund veçojmë raportin e shpenzimit të buxhetit me kode ekonomike në bazë të linjave buxhetore në drejtoritë përkatëse. Ky raportim nuk është evidentuar për shkak të përbajtjes vuliminoze dhe i cili gjendet në raportin vjetor të prezentuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal, si dhe në web faqen e komunës.

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë vitit 2021, në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale, si dhe obligime të tjera nga e drejta pozitive në përgjethsi, duke përcjellur planin e punës dhe objektivat e drejtoratit për vitin 2021.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

-Projekti "Ndërtimi i Zonës/Parku Industrial në Qylagë", sipas MTI-së, ka vazhduar të ndërtohet edhe gjatë vitit 2021, Bazuar në informatat nga Drejtorati për Shërbime Publike, investimet infrastrukturore në Zonën Ekonomike/Industriale në Qylagë kanë vazhduar. Pjesë e këtij projekti janë kryer disa punime si asfaltimi i rrugës përgjatë Zonës Ekonomike në Qylagë, ka vazhuar punimet në trotuar, kanalizim ujësjellës dhe ndriqimi publik, gjithashtu pjesa prej 10/hektar, duhet të parcelizohet dhe të fillohet me procedurat e dhënies në shfrytëzim të kësaj pjesë të zonës ekonomike pasi që tani kjo pjesë është e gatshme për dhënie në shfrytëzim për zhvillim të aktiviteteve biznisore.

-Kemi punuar ngushtë me përfaqësuesit e Zyrës së EU-së në Kosovë, UNDP-së dhe Ministrisë së Kulturës dhe rreth projektit Memorandumi Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Kulturës dhe UNDP-së, është nënshkruar në vlerë prej 1.4 milion euro, i cili memorandum i paraprinë investimeve në Janjevë ku në si komunë kemi punuar ngushtë me përfaqësuesit e Zyrës së EU-së në Kosovë, UNDP-së dhe Ministrisë së Kulturës, nga informatet që kemi në bashkëpunim me UNDP-në, pritet nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit në vlerë prej 2 milion euro nga fondet e IPA III, rreth këtij projektit për zhvillim të turizmit dhe ruajtjes së trashëgëmisë kulturore. Vlera e projektit në total është 3.4 milion euro dhe, sipas Zyrës së EU-së në Kosovë, do të filloj të implementohet në pjesën e parë të vitit 2022.

-Gjatë vitit 2021, kemi punuar ngushtë me përfaqësuesit e Bankës Botërore dhe IFC-së rreth projektit "Përmirësimi i Klimës së Investimeve II përmes thjeshtëzimit të procedurave administrative". Së bashku me përfaqësuesit e Bankës Botërore, ASHI-së, Komuna e Lipjanit ka bërë lansimin e sistemit elektronik për thjeshtëzim të procedurave administrative, projekt i financuar nga Banka Botërore në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit.

-Sipas vendimeve parparake të kuvendit komunal të Lipjanit dhe vendimet mbi formimin e komisioneve për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale, komisionet e formuara kanë punuar shqyrtuar vlerësuar aplikacionet nga ofertuesit, për dhënie në shfrytëzim të lokaleve.

-Së bashku me Agjensinë për Zhvillim Rajonal kemi organizuar sesion informues në sallën e Kuvendit Komunal për bizneset mikro dhe të vogla për informim sa më të mirë dhe ndjekjen e procedurave të ndryshme për plotësimin e aplikacioneve përfitim të grandeve nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

-Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi mes Komunës së Lipjanit dhe Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, të cilit memorandum i ka paraprirë një projekt i dorëzuar nga DEZH dhe është kërkuar mbështetje financiare për asfaltimin e disa rrugicave në fshatin Gadime rrespektivisht në lagjen e komunitetit RAE, në vlerë prej 50.000.00, Euro.

-Në këtë vit kemi filluar procedurat për themelimin e ndërmarrjes publike "ULPIANA" kemi dorëzur në Ministrinë e Ekonomisë rrespektivisht në Njësin për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike kërkesën e kompletuar me dokumente të tjera sipas dispozitave ligjore për themelimin e së njejtës e cila sipas informacioneve që kemi është procesuar për këshill ministror, gjë që e njejtë pritet të funksionalizohet ne vitin 2022.

-Agjencia për Zhvillimin Rajonal ka shpallur fituesit e projektit "Përkrahja dhe fuqizimi i grave në Agrikulturë" për komunën e Lipjanit, me këtë rast kanë përfituar gjithsejt 5 përfitues ku së shpejti pritet nënshkrimi i kontratave, me përfituesit.

-Kemi dërguar shkresë në Ministrin e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë për vazhdimin në bashkëfinancim në Zonën Ekonomike në Qylagë, për pjesën tjetër të kësaj Zone Ekonomike.

- Gjatë këtij viti Zyra për Integrime Evropiane ka realizuar sesion me Zyren e Bashkimit Evropian lidhur me "Trajnimit mbi Agjendën e BE-së për Barazinë Gjinore", Ky takim kishte për qëllim t'i bëjë pjesëmarrësit të njihen me vlerat, strategjitet dhe politikat e BE-së për barazinë gjinore. Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore të vitit 2020, Plani i Veprimit Gjinor III i vitit 2020 dhe Strategjia e Grave pér Paqen dhe Sigurinë e vitit 2018 përbëjnë një organ kompakt të angazhimeve nga BE-ja në lidhje me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

- Zyra për Integrime Evropiane ka përgatitur dhe dorëzuar Raportin për Përbushjen e Obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane ku është paraqitur në detaje e gjithë puna e Komunës për secilin sektor. Në këtë raport gjithashtu të gjithë sektorët e Komunës kanë paraqitur të arriturat në përbushjen e rekondimeve të dala nga agjenda evropiane, pas plotësimit nga të gjitha drejtoratet të raportit e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane të njejtin e kemi kompletuar dhe dërguar në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.

-Zyrtarët nga drejtorati ynë kanë vlerësuar aplikacionet dhe dalur në teren sa i përket subvencionimit me serra dhe të njejit e kanë përpuluar edhe listën përfundimtare të përfituesve e cila është publikuar më datë: 29.11.2021.

-Kemi raportuar në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal mbi implementimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2019-2023.

-Zyrtarja për integrime evropiane ka përgaditur raportin për moniorim dhe zbatim të planit të integritetit.

STATISTIKAT

Shërbimet ndaj bizneseve dhe bizneset e regjistruara

Bazuar në të dhënat e zyrës One-Stop-Shop, numri i bizneseve aktive në Komunën e Lipjanit është 3704. Numri i bizneseve të regjistruara në periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2021 është 397 biznese ndërsa, numri i bizneseve të shuara është 17. Gjithsej gjatë kësaj periudhe kohore zyra One-Stop-Shop ka regjistruar në protokol 923 shërbime për biznese.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Pagesa bizneseve për ndryshime	196
2	Biznese të reja të regjistruar	297
3	Kërkesë ndryshim kapitali	4
4	Ndërrim i Çertifikatave të reja	138
5	Shtim i njësisë biznesit	24
6	Vërtetim që posedon biznes	18
7	Shuarje të biznesit	17

8	Shtim i aktivitetit te biznesit	70
9	Informatat e bizneseve	154
10	Ndërrim i pronarit	21
	Lëndë te regjistruar në portokol gjithsejt nga Janar – Dhjetor 2021	923

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim ka informuar Sekorin Pronësoro-Juridik për pagesën e qirave dhe obligimet bazuar në kontratat e lidhura për lokalet dhe pronat tjera komunale, sa i përket obigimeve që kanë patur shfrytëzuesit e objekteve të komunës së Lipjanit, ndërsa sipas vendimit të kuvendit komunal qiratë për lokale afarsite janë falur si pasoj e pandemisë Covid-19.

SFIDAT

Sfidë mbetët vazhdimi i investimeve nga MTI në Zonën Ekonomike/Industriale në Qylagë. Përfundimi i investimeve infrastrukturore në këtë zonë dhe funksionalizimi i shpejtë i saj është shumë i rendësishëm ngase pozita gjeografike e kësaj zone industriale shumë pranë Aeroportit të Prishtinës, afërsia me autostradën Ibrahim Rugova, afërsia me hekurudhën, autostradën Prishtinë-Shkup dhe pozita në mes të nyjes së rrugëve regionale e bënë këtë zonë shumë atraktive për investitorë.

Sfidë tjetër është menajimi jo i mirë i Shpellës së Mermertë në Gadime dhe mungesa e promovimit të mjafsheshëm nga instancat e larta relevante shtetërore. Si vend turistik me potencial shumë të fuqishëm për nxitje të zhvillimit ekonomik në nivel vendi Shpella e Mermertë e Gadimes është e rrallë dhe unike në tërë botën.

Sfidë është edhe menaxhimi i Rezervatit Blinaja ngase ende është e myllur për vizitorë. Blinaja është Rezervat unik dhe shumë i rendësishëm për zhvillimin ekonomik te Komunës se Lipjanit dhe ekonomise vendore. Siperfaqja prej mbi 3000 ha, flora dhe fauna me e pasur në nivel vendi, prezenca e mbi 30 liqeneve brenda Blinajes, pozita gjeografike vetëm disa dhjetra km nga kryeqyteti e bënë këtë pasuri natyrore si burim i madh i të hyrave dhe me ndikim në zhvillim ekonomik.

REKOMANDIME

Rekomandojmë rritjen e bashkëpunimit në mes të Ministrite relevante dhe Komunës së Lipjanit me qëllim që të mundësohet shpejt hapja e Blinajes për vizitorë. Kjo nuk duhet me qenë problem ngase të gjitha investimet infrastrukturore si rruga deri në Blinajë me ndriqim publik, rrugët brenda fshatit Blinajë, trotuari dhe investime brenda parkut kanë përfunduar.

Rekomandojmë rishikim të politikave shtetërore rreth menaxhimit dhe promovimit të Shpellës së Gadimes ngase kjo do te sillte shtim të të hyrave, zhvillim të veprimtarive ekonomike që përbëjnë ekonominë turistike përfshirë: hotelerinë, transportin, tregtinë, institucionet kulturore, rritjen e punësimit, standardit jetësor, investimet, zhvillimin e viseve të pazhvilluara.

QËSHTE TË TJERA

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik, përmes informimit rreth pronave komunale të gatshme për dhënje në shfrytëzim për investitorët potencial, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, në bashkëpunim me sektorin për çështje pronësore-juridike dhe zyrën për marrëdhënie me publikun, ka publikuar të gjitha pronat e lira komunale në web-faqe të Komunës.

Bazuar në Qarkoren e Bendshme Buxhetore të pranuar nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa është dorëzuar Planifikimi Buxhetor për 3 vitët e ardhshme për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024, dhe Planifikimin e Buxhetit 2021-2023. Në këto propozime janë përfshirë të gjitha shpenzimet në të gjitha kategoritë ekonomike si dhe investimet kapitale të nevojshme për zhvillim ekonomik lokal si nga niveli lokal ashtu edhe nga niveli qëndrorë.

DREJTORATI I INSPEKTORIATIT

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në vitin 2021 në agjendën tonë kemi pasur mbrojtjen e shëndetit publik, duke i respektuar rekomandimet e IKSHPK-së dhe zbatimin e masave nga Ministria e Shëndetësisë.

Meqë kishim një angazhim maksimalë ne kemi përegaditur planin dinamik të punës për tejkalimin e gjendjes gjithnjë në interes të konsumatorëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik të qytetarëve në Komunën tonë. Për realizimin e këtij plani ne kemi pasur një bashkëpunim edhe me policin e Lipjanit në të gjitha fushat.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

-Përqendrimi i kontrolleve kanë qenë qendrat tregtare dhe gastronomia, ku shpesh janë realizuar inspektimet përbashkëta me policinë me të cilët kemi vepruar së bashku.

-Kemi pasur një bashkëpunim të mirë me QKMF-në e Lipjanit dhe bizneset që veprojnë në Lipjan.

Inspektorët e tregut ju kanë ndihmuar bizneseve që të sillen në pajtueshmëri me ligjet në fuqi dhe vendimet e Qeverisë për parandalimin e Pandemisë covid-19.

-Nga sektori i mjedisit-ambientit gjatë vitit 2021 është punuar sipas planit dinamik të përgatitur, me disa ndryshime për arsyet e pandemisë Covid-19. Është bërë identifikimi i deponive të egra të mbeturinave, inspektimet për mbrojtjen e ajrit, ujërave të lumenjve, tokës nga ndotësit, mbikëqyrjen e lejeve mjedisore komunale, mbrojtjen e qytetarëve nga zhurma sipas ligjit, mbikëqyrjen e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe bartjes së tyre nga kompania e licencuar për menaxhim, pranimi i ankesave të qytetarëve dhe shqyrtimi i tyre në teren, si dhe kontrolla të tjera.

-Për çdo ankesë është konstatuar gjendja me procesverbal, aty ku janë gjetur parregullsi janë marrë masat ligjore varësisht prej natyrës së problemit, me ç'rast janë dhënë urdhëresa, vërejtje për sanimin e parregullsive, gjithashtu janë shqiptuar edhe gjoba mandatore dhe fletëparaqitje për gjykatë ndaj personave fizik apo subjekteve të cilët nuk kanë zbatuar urdhëresën.

-Është bërë identifikimi i deponive të egra të mbeturinave i cili bëhet çdo vit, si pjesë e komisionit për identifikim e deponive në bashkëpunim mes komunës dhe GIZ, si dhe krahasimi në vitet paraprake. Shumë deponi janë larguar nga Komuna e Lipjanit dhe numri i deponive është zvogëluar në krahasim me vitet paraprake. Gjendja është duke u përmirësuar falë shpërndarjes se shportave në çdo familje në fshatra të investuar nga Komuna dhe donacioneve nga donator.

-Kemi bashkëpunuar me ujësjellësin KUR "Prishtina" dhe me kompaninë "Pastrimi" për mirëmbajtjen e kanalizimit dhe menaxhim të mbeturinave, ndërsa aty ku ka pasur ankesa, u është kërkuar me procesverbal mirëmbajta e rrjetit të kanalizimit.

-Gjatë vitit 2021 inspektorët e ndërtimtarisë kanë inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në të gjitha zonat e ndërtimit dhe zonat tjera ndërtimore, duke përfshirë edhe periferinë e qytetit. Gjendja e ndërtimit për gjatë vitit ka qenë nën kontrollin e vazhdueshëm Inspektues. E arritura e inspeksionit të ndërtimtarisë gjatë vitit 2021, është se ka filluar aplikimi për raporte finale për t'u pajisur me certifikatë përdorimi objektet e përfunduara nga Investitorët.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektieme	Inspektimi me procesverbali	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Vendime për vëtizolim	Eks-humumi	Inspektimi bizneseve per orar te punes	Raporte finale per pranime teknike te objekteve	Verjetje, njoftime	Mbyllje e perkohshme e lokaleve	Vendosja te shiritave	Pelqime sanitare	Pune me pal, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuara	Lende te pezulluara, ekuivalentuara gjygesore	Gjoba mandatore	Inspektimi i bizneseve për respektimin masave COVID-19	Pranime teknike për projekte komunale	Të hyra nga pranime teknike	Inspektimi i reth orarit të punës	Kallëzime penale	Menaxhim i tregjeve	Aktivdime, ndalesa, urdhëresa	Inspektimi me polici	Inspektimi i bizneseve pa regjistrim pa pranim teknik	Asgjësim i mallit me kërkesë te palës	Mall me afat te skandular
Biznesi	1484	329	115	3		32		2		343	180					2475€				88	157	23	212				
Ambient	339	153		7			21		80	36	10	3							1		3	25					
Sanitarët	3730	200		8	2116	1			20	25	40			1000							20	300		151.720kg			
Ndërtimi	394	199		7		12	61	15	29	4	3		17					4		43							
Trafiku	995	315		22			28	8	166	15	16								72	1	10	0					
Gjithsej	6942	1196	115	47	2116	1	32	12	370	2	15	20	643	271	30	6	1000	17	2475€	5	160	224	448	212	151.720kg		

DISKUTIMET PUBLIKE

-Kemi pasur diskutime me auto-taksit të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë, si dhe auto-taksit në qytet, në lidhje me njofimin publik për tu pajisur me Licencë, po ashtu edhe me firmat e autobusëve përendë të udhëtimit që duhet të pajisen nga Ministria e Infrastrukturës..

SFIDAT

-Sfiduese për Drejtoret e Inspektoriatit ka qenë menaxhimi dhe zbatimi i masave anti covid – 19, duke angazhuar të gjithë stafin në ekipe punuese dhe kujdestari të rregullt për gjatë gjithë kohës.

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

-Edhe viti 2021 vazhdoi me Pandemi e me këtë edhe me respektimin e masave dhe rekomandimeve të Institutit dhe MSH. Lakorja e rasteve të infektuara ishte me ndryshime për të shënuar numrin më të madh të rasteve pozitive në muajin Shkurt (284), Mars (534) dhe Prill (350) e për të rënë pastaj muajëve në vazhdim.

-Ne kemi vazhduar punën dhe aktivitetet duke aplikuar gjitha masat paraprake për parandalimin e përhapjes së sëmundjës, trajnimi në vazhdimësi i stafit me të rejat më të fundit lidhur me virusin dhe Pandeminë Covid19, furnizimi në vazhdimësi me pajisje mbrojtese personale, dezinfektimi i rregullt i hapësirave të institucioneve shëndetësore dhe autoambullancave, furnizimi me antigjen teste (teste rapide) dhe realizmi i testimeve në QKMF etj.

-Komuna e Lipjanit përkundër të gjitha vështirësive të shfaqura i ka kushtuar prioritet Shëndetit Publik dhe menagjimit të periudhës me Pandeminë.

-Po ashtu është përkushtuar në vazhdimësi në realizimin e projekteve për përmirësimin e kushteve dhe krijimin e hapësirave më të mira, ofrimin e shërbimeve sa më të qasshme dhe sa më cilësore si dhe sigurimin e aparaturave moderne, të cilat do t'i paraqesim më poshtë!

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Pandemia për periudhën janar - dhjetor 2021, testimet me teste rapide antigen

Gjinia	Nr.i Pacientëve pozitiv sipas gjinisë	%
F	5721	58.08%
M	4129	41.92%
Total	9850	

Vaksinimi 2021

- Vaksinimi ka filluar me datë 07.04.2021, fillimisht në QKMF pastaj prej 15.06.2021 në sallën e sporteve "Better Life" me rekomandimet e MSH dhe IKSHPK –së i ashtuquajturi **Vaksinimi masiv** në gjithë vendin apo faza e tretë e fushatës së vaksinimit sipas **Planit shtetëror të vaksinimit**.
- Qysh prej fillimit të procesit janë zbatuar dhe janë në vazhdimësi duke u zbatuar rregullat dhe protokollet e caktuara sipas planit.
- Numri i vaksinave të administruara që nga fillimi e deri më 31.12.2021 është:

Doza 1 Covid19	Doza 2 Covid19	Doza 3 Covid19	Gjithësejt Covid19	Vaksinimi në shkolla	Ekipa mobile	Gjidhëse	Shtatzanat	Influenca vacc
31350	26344	179	57883	555	175	155	120	2337

PUNËT DHE AKTIVITET E PÊRGJITHSHME

Përpilimi i Planit orientues të punës për vitin 2022-2023 dhe dorëzimi i tij.

Planifikimin bugjetor për tri vitet e ardhshme i kompletuar dhe dorëzuar me kohë

Pyetësori për performancë – i dërguar me kohe përmes përsoneve përgjegjës për këtë.

Pyetësori me Auditorin i plotësuar dhe dërguar me kohë!

Promovimi dhe edukimi shëndetesor në disa vende rurale më të largëta në Komunën tonë (Brus, Baincë, Shalë, Dobrajë, Sllovi, Rubovc, Gadime, Babush etj.)

Shënim i Ditëve Botërore (Dita Botërore e Astmës, Diabetit, e Zemres etj)

Vizita të rregulla të gjithë sektoret dhe përcjellja e punës nga afër

Përzgjedha "Komuna Model" apo Qendra Demostruese, fituar nga AQH në kuadër të së cilës do të investohet në QKMF, QMF – Gadime renovim komplet dhe furnizim me paisje dhe inventor, si dhe AMF – Kraishtë – Telemedicina.

Furnizimi me paisje të telemjekësisë dhe trajnimi i stafit për përdorimin e tyre.

Broshura për njoftimin e qytetarëve lidhur me KPSH dhe shërbimet të cilat ofrohen në këto institucione, broshura për edukim lidhur me përdorimin e kripës dhe sheqerit, diabetin dhe hipertensionin etj.

Të Përditëshme

Furnizimi në vazhdimësi i stafit me maska mbrojtëse dhe pajisje tjera mbrojtëse

Furnizimi dhe shpërndarja e sapunit të lëngshëm në të gjitha ordinancat dhe toaletet për dezinfektimin e duarëve.

Furnizimi me dezinfektues të duarëve ne vazhdimesi

Investimet Kapitale:

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale, gjatë vitit 2021 gjithëmon në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe Planin Orientues ka zhvilluar aktivitetet e saj të cilat janë të planifikuar në buxhetin e Komunës, por krasas kësaj edhe shumë punë dhe zhvillime tjera si rrjedhojë Pandemisë.

Renovimi i Objektit të Stomatologjisë dhe Pneumoftiziologjisë.

Furnizimi me klima përfthohje në sallën e vaksinimit, 3 copë

Rregullimi – renovimi i këndit të Pediatrisë (Unicef, Ipko Fondation)

Hapja e pusit në QMF – Shalë, Qatar Charity

Sanimi i ujesjellesit në Magurë dhe Janjevë

Ka filluar instalimi (ndërtimi) i ashensorit në QKMF

Renovimi i AMF Kraishtë dhe furnizimi me pajisje mjekësore, AQH

Ndërrimi komplet i kulmit të AMF Kraishtë

Lyerja e rrethojave të AMF – Kraishtë (punë vullnetare e Solaborate dhe AQH –së)

Lyerja nga jashtë e AMF – Kraishtë

Furnizimi me qanta me pajisje mjekësore për mjek familjar (32copë) dhe qantat me pajisje për shërbimin urgjent përgjitha ekipet e urgjencës (5 copë) dhe shpërndarja e tyre

Funksionalizimi "Klasat për nana" nga AMC

Shërbimi i rregullt për nëna dhe fëmijë deri në 3 vjeq

Funizim me materiale mjekësore (Material medicional)

QENDRA KRYESORE E MJEKESISE FAMILJARE

STATISTIKAT

Përmbledhje e vizitave dhe shërbimeve mjekësore ne QKMF, QMF dhe AMF-Lipjan

Shërbimet shëndetësore

Nr.	Lloji i vizitave	Numëri i vizitave të realizuara
01	Vizita mjekësore në QKMF	97230
02	Vizita mjekësore në Punkte	50621
03	Vizita emergjente	45380
04	Vizita stomatologjike	8150
05	Vizita gjinekologjike	4236
06	Vizita pediatrike	2027
07	Vizita pulmologjike	353
08	Vizita paliative	1087
	Gjithsej vizita mjekësore	213084

Nr.	Shërbimi i ofruar	Numri i shërbimeve
01	Gjithsej injeksione	94917
02	Gjithsej infuzione	44889
03	Gjithsej lidhje-pastrim plage	15349
04	Gjithsej Rtg exponime	6228
05	Gjithsej pacient ne laborator	21445
06	Gjithsej lindje	4
07	Gjithsej EKG	4382
08	Gjithsej Mamogrifi	0
09	Gjithsej USG	957
10	Gjithsej vizita shtëpiake	821
11	Gjithsej transport me autoambulance	813
12	Gjithsej Imobilizime	472
13	Gjithsej Oksigenoterapi	996
14	Gjithsej Largim i Penjve	879
15	Gjithsej aksident trafiku	292
16	Këshillimorja	499
17	Gjithsej referime	20172
18	Gjithsej vaksina	11115
19	Gjithsej vaksina COVID-19	58354
20	Gjithsej shërbime	282123
21	Përqindja e referimeve	9.5%

Zyra e personelit

-Sektori i personelit të QKMF-së në Lipjan, duke u bazuar në dispozitat ligjore që janë aktualisht në fuqi, gjatë vitit 2021 ka kryer këto punë duke përpiluar këto akte juridike, si në vijim :

Nr.	Emërtimi i aktit	Nr. i akteve
1	Aktvendime për shfrytëzim të pushimit vjetor	170
2	Aktvendime për pagesën e punes së nates, jashtë orarit, festës	33
3	Aktvendime mbi masat diciplinor (Vërejtje)	2
4	Lëshime të vërtetimeve për provojë të punës për ish punëtort dhe punëtorve aktual	30
5	Evidentimi dhe procedimi i pushimeve mjekësore	40
6	Evidentimi dhe procedimi i lindjeve ne njësin e maternitetit	/
7	Aktvendimet për pushimet e Lehonis për punëtoret	3
8	Largim nga puna me vetë deshir dhe të larguar me procedur të rregullt	5
9	Pushimet pa pagesë	7
10	Rekrutime të reja të punëtorve	8
11	Vertetima që kanë përfunduar praktiken në QKMF	96
12	Vërtetima që kanë qenë në praktik vullnetare në QKMF	5
13	Akvendime për daljen në pension të punëtorve	3
14	Akvendim për nderprerjen e punës së punëtorve që kanë vdekur	/
15	Aktvendime të ndryshme dhe shkresa të ndryshme .	100
16	Ndryshime në listen e pagave të punetorve per vitin 2018	200
17	Pregaditja e pageses për shtesat Covid-19	10
18	Pregaditja e Autorizimeve për praktik	326
	Lëndet e punuara janë:	1,038.00

Shërbime të reja të ofrimit të shërbimeve shëndetësore nga KPSH-Lipjan për vitin 2021 janë:

- Formimi dhe funksionalizimi i komisionit për cilësi dhe shqyrtim të ankesave dhe parashtresave nga pacientët dhe stafi.
 - Komunikimi i rasteve për shqyrtimin e përkrahjes sociale pas vizitave nga ekipi i infermierave për vizita në shtëpi për nënët dhe fëmijët deri në tre vjeç (shërbime shëndetësore të integruara).
 - Vizita në shkolla për higjenë, me kërkesë të drejtorëve të shkollave
- Orari i punës në KPSH-Lipjan Vizita mjekësore dhe shërbime shëndetësore ne QKMF (Urgjenca dhe Materniteti) 24 orë, Shërbimet e mjekësisë familjare, pediatrisë, stomatologjisë 12 orë në dy ndërrime, në QMF 12 orë dy ndërrime dhe AMF 8 orë një ndërrim.**

Në sektorin e mjekësisë familjare Nga QKMF-Lipjan janë larguar 7 mjekë në specializime të profilit sekondar, dy mjekë janë larguar, pas punësimit në QKMF - Prishtinë. Gjashtë mjekë kanë filluar specializimin në Mjekësi familjare, në specializim me përkrahje të QKMF-së janë tre mjekë (1 Pediatri dhe 2 Biokimi), pushim të lehonisë një mjeke, pensionim një mjek, pushim të liruar nga masat anti-Covid dy mjekë, pra nga procesi janë larguar 16 mjekë kurse kemi pranuar 8 mjekë. Puna me mjekë ka qenë e organizuar sipas rrethanave të reja me pandeminë duke e kursyer stafin nga ekspozimi sipas rekomandimeve të MSh dhe IKShPK, mbulimi i te gjitha punkteve përvëç gjate sezonit te verës ku stafi shfrytëzon pushimin vjetor dhe nuk ishte e mundur te mbulohen te gjitha punktet shëndetësore.

Puna me mjekë ka qenë e organizuar mirë, mbulimi i te gjitha punkteve përvëç gjate sezonit te verës ku stafi shfrytëzon pushimin vjetor dhe nuk mund te mbulohen te gjitha punktet shëndetësore.

Në sektorin e Infermierisë: Është arrite, koordinimi i mirë ne organizimin dhe shpërndarjen e punëve, si në kryerjen e raportimeve me kohë, planifikimin dhe shfrytëzimin e pushimeve pa penguar procesin e punës, si dhe mbajtja e disa takimeve radhazi lidhur me përmirësimin e cilësisë se punës infermierore ne bashkëpunim me drejtorinë dhe koordinatorën e QEV-it janë organizuar planifikim i trajnimeve te stafit dhe shënim i ditëve të caktuara në shëndetësi. Po ashtu ky shërbim po bart punën e kryerjes se stazhit te gjithë praktikantëve të infermierisë, gjithsej 162 praktikant/e.

Në sektorin e barnatores: Kemi një përmirësim ne shpërndarjen, planifikimin si dhe evidentimin e stokut. Barnatorja është pajisur me higroskop, termometra për ambientit të deponimit te barnave dhe frigorifereve

-Ne planifikimin e dozave te insulinës dhe intervenimin sipas mundësive buxhetore në blerjen e barnave komerciale, sepse furnizimi me barna nga lista esenciale ne Barnatoren Qendrore te MSH është tejet i dobët nga sasia e planifikuar diku rrëth 45%.

-Janë kryer planifikimi për vitin 2022. Kemi kriju dosjet për secili patient me "diabet, neuroleptik psiko trop po vazhdojmë t'i identifikojmë grupe të caktuara të domosdoshme për dosjet shëndetësore.

-Patient insulinë varës janë rreth 330, kurse me tabletave rreth 1850

Në sektorin e shërbimit te emergjencës:

Shërbimi i urgjencës dhe materniteti në QKMF ofron shërbime 24 ore ne dite.

Ne këtë shërbim gjate një ndërrimi, janë nga dy mjek për arsyen e vëllimit të madh të punës dhe mundësia e daljes ne terren e ekipes mjekësore me prezencën e mjekut. Ky shërbim është i ngarkuar me numër te madh të pacientëve dhe kështu edhe shpenzuesi i me shumë se gjysmës se furnizimit me material mjekësor dhe terapi shpenzohet nga ky shërbim.

Në sektorin e Stomatologjisë: Kemi një gjendje ku aparatura është ne gjendje të përmirësuar, ka rritur cilësinë e ofrimit te shërbimeve stomatologjike. Pas renovimeve ne këtë shërbim si dhe pajisjen me karrige stomatologjike sipas planifikimit kemi përmirësimin e cilësisë te vizitave stomatologjike. Kemi kryer servisimin e disa aparaturave përfshi edhe rtg te dhëmbëve e cila është kthyer në funksion por është e vjetruar.

Në sektorin e Maternitetit: Ky shërbim ka shënuar rënie te lindjeve, por tani e kemi orientuar vizitat dhe këshillat për nena dhe fëmijë deri ne tre vjeç, dhe jemi duke realizuar vizita shtëpiake, kurse vizitat gjinekologjike-obstetrike kryhen nga dy mjek gjinekolog. Risi në këtë shërbim është funksionalizimi i shërbimit "Klasat për nana". Renovimi i objektit ka permiresuar dukshem kushtet e punës si dhe pajisja me ECHO e CTG aparat.

Në sektorin e Pneumoftiziologjise: Kemi zvogëlim te numrit te sëmurëve me TB, për dy raste me pakë se ne vitin 2020, shërbimi funksionon pa ndonjë ndryshim të veçantë.

Në sektorin e vaksinimit dhe SISH-it: Përveç realizimit te vaksinimit sipas planifikimit kemi zhvilluar një fushat vaksinimi anti-covid, vaksinimi ne shkolla, vaksinimi per persona me ekipen mobile per persona me aftesi te kufizuar dhe vaksinat e gripit sezonal.

Në sektorin e Laboratorit: Kemi një aparature të mirë tani analiza e HbA1c/Hemoglobina e glikogenizuar, por gjate vitit kemi pas veshtiresi ne furnizim me material laboratorik, Teste rapide me antigjen rreth 18000 qytetarë.

Në sektorin e mirëmbajtjes: janë kryer një numër i madh i punëve, ndër me më rendësi janë:

Mbikqyrja e kontraktorit për instalimin e rrjetit të ri të ujësjellësit në QMF-Janjevë dhe Magure.

Mbikqyrja e kryerjes së punëve në renovimin e AMF-së, Kraishtë nga AQH

Mbikqyrja e projektit nga AQH (ndërtimi i ashensorit në QKMF)

Dhe mbikqyrja me përgjegjësi e realizimit të furnizimeve dhe renovimit. Sigurimi me kohë i lëndeve për ngrohje si dhe ngrohja e mire në të gjitha objektet e QKMF-së dhe punkteve.

Në sektorin e autogarazhe: Kemi rënie te shpenzimeve te derivateve, por kemi edhe një orar te ri me pacientet e hemodializes si dhe shtimin e pacientëve te ri. Formimin e komisionit për vërtetimin dhe evidentimin e shpenzimeve të derivateve në automjetet e QKMF-së. Servisim me kohe dhe mbajtje ne funksion te mire te gjitha automjetet e QKMF-se.

Edukimi Posdiplomik Specialistik:

Në kuadër të Edukimit specialistik nga QKMF-Lipjan janë gjashtë (6) mjekë në specializim të mjekësisë familjare.

Ku pas përfundimit të këtyre specializimeve Komuna e jonë do të jetë ndër Komunat e para që i afrohet planit strategjik kombëtar një Mjek Familjar në 2000 - 2500 banor.

Ne do të kemi një MF në 2000 banorë

Specializime me mbështetje të QKMF- së për nevoja të QKMF janë 3 mjek (2 në Biokimi, 1 Pediatri).

Raporti mjeke infermier/e, Nivel vendi ky raport llogaritet të jetë

1 mjek F/MP : 2000-2500 banore

1 infermier/e : 1000 banore

QKMF-Lipjan ka një kuadër të specializuar Mjekë Familjar 24 dhe gjashtë mjekë/e specializant të Mjekësisë Familjare.

-Kemi planifikuar edhe tre mjekë familjar për gjeneratën e ardhshme të specializimeve nga mjekësia familjare, duke u bazuar ne moshën e pensionimit te mjekeve ne tri vitet e ardhshme.

Konkluzione: Ofrimi i shërbimeve shëndetësore ne KP shëndetësor ne komunën e Lipjanit përkundër vështirësiveme pandeminë, nuk është ndërprerë asnjë shërbim tjetër dhe janë realizuar një besueshmëri nga qytetari ku dëshmohet me **213084** Vizita mjekësore dhe **282123** shërbime shëndetësore.

Prioritet i vittit 2022 do te jete promovimi i KPSH-se dhe puna ne teren ne edukimin dhe promovimin e shëndetit, implementimi i telemjekësisë, në veçanti me sëmundjet kronike jo ngjitime dhe grupet me te ndjeshme.

SFIDAT- Pengesa ne rritjen e performancës gjatë vittit 2021 ishin:

Pandemia Covid-19, vala e Gushtit 2021,

Furnizimi i mangët me barna dhe materiale medicionale nga depo qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë.

Gjatë gjithë periudhës janar-dhjetor, Drejtori i Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka vazduar punën duke pranuar kështu dhe shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të kérkesave dhe lëndëve.

STATISTIKAT

Pasqyra totale e kérkesave për vitin 2021

Nr	Lloji i kérkesës	Të pranuara	Të aprovuara	Të refuzuara	Në procedurë
1	Kérkesa për Strehim në Strehimoren Magure	5	/	5	/
2	Kérkesat për vazhdimin e kontratave për banim në Strehimore	12	12	/	/
3	Kérkesa për ndërtim, meremetim të shtëpijave	44	3	41	/
4	Kérkesa për ndarje të banesave	4	/	4	/
5	Kérkesa nga QKMF	62	51	11	/
6	Kérkesa nga QPS	53	48	5	/
7	Kérkesa nga Shtëpia e Komuniteteve	47	45	2	/
8	Kérkesa për mjete financiare	267	78	189	/
9	Kérkesa për shërim jashtë vendit	18	18	/	/
10	Kérkesa për realizimin e të drejtave të familjeve të veteraneve të luftë së UÇK, dëshmove, invalidëve, viktimave civile.	4	4	/	/
11	Kérkesa për certifikata të shtesave fëminore për punëtoret në boten e jashtme.	42	42	/	/
12	Aktvendime për pagesën e punëve jashtë orarit të punës për Shtëpinë e Komuniteteve	37	35	2	/
13	Aktvendime për pushim pa pagës në QKMF	7	7	/	/
14	Aktvendime për vazhdimin e qëndrimit të rezidente në Shtëpinë e Komuniteteve	10	10	/	/
15	Aktvendime për pushim pa pagës në Shtëpinë e Komuniteteve	1	1	/	/
16	Kérkesa për punësim në QKMF	75	8	67	/
17	Kérkesa për punësim në Shtëpinë e Komuniteteve	13	1	12	/
18	Kérkesa për praktik në QKMF	458	423	35	/
19	Kérkesa për pagë jubilare nga punëtoret e QKMF-së	4	4	/	/
20	Ankesa për pagë jubilare për punëtoret e QKMF-së	4	4	/	/
21	Vërtetime të ndryshme	48	48	/	/
22	Kérkesa të ndryshme	52	52	/	/
	Nr.i përgjithëshum i kérkesave	1267	894	373	/

Pasqyra totale e kérkesave vjetore për të cilat nuk udhëhiqet procedurë administrative

Nr.	Lloji i kérkesës	
1	Kérkesa për derivate të QKMF-së	271
2	Kérkesa për derivat të QPS-së	50
3	Kérkesa për material furnizues për QKMF	53
4	Kérkesa për material furnizues për QPS	34
	Nr.i përgjithëshum i kérkesave	408

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Qendra për Punë sociale në kuadër të veprimtarisë së saj gjatë kësaj periudhe raportuese ka ofruar një gamë shërbimesh të përkujdesjes sociale, të cilat shërbime ndërlidhen me nevojat e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare, përfshirë:

- Kujdestaria për të mitur (për fëmijët pa prindër, të braktisur, fëmijët pa të drejt prindërore)
- Kujdestari për raste të veçanta (përfaqësim i një çeshtje)
- Kujdestari për fëmijët e pa shoqëruar (me mbrojtje ndërkombëtare)
- Kujdestari për persona që i është hequr zotësia veprimit
- Adoptim (përfshirë kërkosat me element vendor)
- Mendim profesional mbi vlerësimin e familjeve adoptuse
- Ndërmjetësim të raporteve familjare
- Sanim i marrëdhënieve familjare dhe bashkim familjar
- Këshilla familjare dhe martesore për bashkëshortët
- Strehim për viktimat e dhunës në familje
- Strehim për viktimat e trafikimit (rehabilitim dhe mbikqyerje në ri-integrim)
- Shërbime për personat e moshuar pa përkujdesje familjare
- Strehim për fëmijët pa përkujdesje familjare (institucional dhe familjar)
- Strehim për fëmijet e keqtrajtuar, abuzuar, neglizhuar (institucional dhe familjar)
- Mendim profesional për besimin e fëmijëve (kujdestaria e fëmijëve për njërin prind)
- Realizimi i kontakteve prind- fëmijëve në mbikqyerje të organit të kujdestarise.

SHËRBIMET SOCIALE NË QPS

Qendra për Punë Sociale në kuadër të veprimtarisë së shërbimeve sociale dhe familjare gjatë këtij vitit pandemik, ka ofruar mbështetje sociale të individëve dhe familjeve në nevojë, përfshirë përkujdesjen sociale të ofruar në partneritet dhe bashkëpunim me institucionet e specializuara për shërbime sociale në komunitet.

Gjatë kësaj periudhe raportuese vlenë të potencohet se rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe shërbimeve integruese në komunitet, përfshirë programin: "Shërbime sociale dhe shëndetësore të integruara në komunitet për personat mbi 65 vjet me sëmundje kronike", po ashtu programi për nëna dhe foshnje dhe përfshirë përkujdesjen sociale të vëganta nëpër shkolla. Shërbimet sociale si çdo herë edhe përgjatë këtij viti kanë realizuar aktivitet përfshirje sociale që në parim; askush mos të mbetet mbrapa, përkundër një periudhe jo të zakonshme dhe mjaft sfiduese si rrjedhojë e Covid 19.

Në vazhdën e aktiviteteve sociale nuk ka munguar aktiviteti mbështetës dhe profesional me institucionet, organizata vendore dhe ndërkombëtare dhe shoqëri civile, përfshirë: OFAP – Organizatën për Mbrojtje të Fëmijëve pa Përkujdesje Familjare-Prishtinë (mbështetje sociale përfshirë përgjatë periudhës Covid 19), KOMF- Koalicioni i OJQ-ve, përfshirë Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë, "Terre Des Hommes" përfshirë mbrojtje të fëmijëve me rrezik të mesëm dhe të lartë, Shqatën Bëmirëse "Nëna Terezë", Kryqin e Kuq, OSBE, HANDIKOS, OMPAK, "Save the Children" dhe UNICEF, Programin përfshirë Drejtë Civile – CRPK, "Zyren përfshirë Juridike Falas" Lipjan, Qendrën e Azilit në Magure, pastaj Aeroporti "Adem Jashari", Qendra Korrektuese përfshirë Mitur, Strehimorja e Sigurisë së Lartë, strehimoret përfshirë mbrojtje të fëmijëve dhe viktimate dhunës në familje, AQH (shërbime shëndetësore dhe sociale të integruara), Qendra e Paraburgimit, Divisionin e Administratës Pensionale të Kosovës, Zyra Rajonale në Lipjan, Shoqërinë Civile etj.

Në kuadër të aktiviteteve të bashkërenduara përfshirë bashkëpunim vlenë të potencohet bashkëpunimi shumë i mirë me gjykatat, policinë, prokurorinë, mbrojtësit e viktimate dhunës në familje, MFPT dhe MPB.

Si çdo herë qëllimi i shërbimeve sociale mbetet trajtimi profesional i kategorive të caktuara në nevojë përfshirë mbrojtje sociale, bazuar në parimin e barazisë, paanshmërisë, drejtësisë sociale dhe përfshirë sa më afër nevojës së qytetarit.

NUMRI I PËRFITUESËVE NGA SKEMA SOCIALE E STREHIMIT FAMILJAR

Nr.	Muaji	Fëmijë në strehim familjar	Vlera për person	Shuma
1.	Janar	16	100	1,600.00€
2.	Shkurt	16	100	1,600.00€
3.	Mars	16	100	1,600.00€
4.	Prill	16	100	1,600.00€
5.	Maj	16	100	1,600.00€
6.	Qershor	16	100	1,600.00€
7.	Korrik	16	100	1,600.00€
8.	Gusht	16	100	1,600.00€
9.	Shtator	16	100	1,600.00€
10.	Tetor	16	100	1,600.00€
11.	Nëntor	16	100	1,600.00€
12.	Dhjetor	16	100	1,600.00€
				19,200.00 €

PËRKRAHJA MATERIALE E FAMILJEVE ME FËMIJË ME AFTËSI TËKUFIZUAR

Nr.	Muaj	Famileje me femijë AK	Vlera	Shuma	Lëvizja - M
1.	Janar	93	100	9,300.00€	
2.	Shkurt	93	100	9,300.00€	
3.	Mars	93	100	9,300.00€	
4.	Prill	91	100	9,100.00€	
5.	Maj	101	100	10,100.00€	+10
6.	Qershor	101	100	10,100.00€	
7.	Korrik	101	100	10,100.00€	
8.	Gusht	101	100	10,100.00€	
9.	Shtator	101	100	10,100.00€	
10.	Tetor	101	100	10,100.00€	
11.	Nëntor	101	100	10,100.00€	
12.	Dhjetor	101	100	10,100.00€	
				117,800.00€	

Përmes tabelës në vijim pasqyrohet numri i përfituesëve të ndihmave sociale përfshirë detajet e numrit të familjeve dhe antarëve, njëherit edhe shuma e mjeteve financiare.

Nr.	Muaji	Nr.i familjeve sipas etniteteve			Nr. i anetareve	Shume materiale ne euro
1	JANAR	1043	202	1245	5641	278,407.50
2	SHKURT	1061	206	1267	5726	285,737.50
3	MARS	1057	214	1271	5725	285,177.50
4	PRILL	1064	208	1272	5702	184,113.00
5	MAJ	1065	210	1275	5707	183,204.00
6	QERSHOR	1048	211	1259	5624	181,810.00
7	KORRIK	1053	211	1264	5627	181,354.00
8	GUSHT	1051	212	1263	5639	179,907.25
9	SHTATOR	1051	212	1263	5639	179,907.25
10	TETOR	1069	211	1280	5678	182,703.50
11	NËNTOR	1057	214	1271	5631	343,366.50
12	DHJETOR					
	GJITHSEJ					2,465,688.00

SKEMA E PËRFITUESVE – AZILKËRKUESVE

Nr.	MUAJI	NR. I FAMILJEVE	NR. I ANËTARVE	SHUMA MATERIALE NË EURO
1	JANAR	92	10	11,970
2	SHKURT	77	0	10,170
3	MARS	76	6	10,780
4	PRILL	66	3	5422
5	MAJ	57	0	4827
6	QERSHOR	59	8	4862
7	KORRIK	55	4	4548.50
8	GUSHT	46	4	4007.25
9	SHTATOR	38	4	4863.50
10	TETOR	28	4	2657.25
11	NËNTOR	46	4	7605
12	DHJETOR	30	4	/
	GJITHSEJ	670	51	69,312.50

Sqarim: Numri i rasteve në të gjitha skemat varion nga muaji në muaj në rënje dhe ngritje, mirëpo ne prezentuam shumën totale të mjeteve, si dhe numrin më të lartë të përfituesve brenda vitit/2021.

Administrimi i shkresave

ADMINISTRIMI I SHKRESAVE	Administrimi i akteve.	Nr i vertetimave në SHS	Nr.i vertetimeve në SHNS	Gjithësej
Protokollimi i shkresave	1466	428	122	550

AKTIVITETET BASHKËRENDEUE STRATEGJIKE DHE PLANIFIKUESE ME IMPAKT SOCIAL PËRGJAT COVID – 19

Gjatë kësaj periudhe raportuese u realizua aktivitet me impakt social me shumë organizata vendore e ndërkombëtare, përfshirë:

Shërbimi i Asistencës Sociale:

- UNDP në mbështetje të familjeve me asistencë sociale me kupon në vlerë prej 60-70 €, për gjashtë muaj gjithsej: 395 familje, në vlerë prej: 153,840.00 euro, ndërsa në mbështetje për një muaj janë përfshirë 85 familje, në vlerë prej: 141.00€.
- IOM në mbështetje të familjeve me asistencë sociale me kupon në vlerë prej 60-70 €, për gjashtë muaj gjithesej 124 familje, në vlerë prej 46,680.00 euro.
- Ambasada e Emiratëve të Bashkuara në bashkëpunim me MFPT- DPSF, impakt mbështetës me pako ushqimore për 70 familje.
- Bashkësia Islame dhe "Shoqata Bereqeti" mbështetje të familjeve me pako ushqimore për 30 familje.
- Impakt mbështetës edhe nga "Islamic Relief Kosova" me pako ushqimore për 250 familje.
- Islamic Relief Kosova impakt mbështetës për prindërit vet-ushqyes të identifikuar në komunën e Lipjanit për 56 prinder vetushqyes.
- Donacion nga personi fizik Xhemajl Krasniqi në vlerën materiale prej 2,000.00 për familje ne nevojë sociale, të cilat i janë shpërndar 20 familjeve ne shumë prej 100 euro.
- Ndihmë momentale për pesë familje nga DPSF.
- Donacion nga Dogana e Kosovës përmes MFPT me veshmbathje për 140 familje
- Donacion nga UNDP pagesa e faturave të ujit për 62 familje
- Donacion nga UNDP furnizimi me lëndë djegëse përkatësisht dru për 54 familje (tani është në proces, lista e familjeve përfitues i është dërguar MFPT dhe UNDP, pritet ne javën e ardhshme ardhja e pakos)
- Organizata "The Ideas Partnership" me projektin "Gratë dhe të Rinjtë për zhvillimin e komuniteteve dhe trashëgimia kulturore" mbështetje për 12 gra shfrytëzuese të ndihmës sociale, që të trajnohen me kurse të rrobaqepësisë.

Impakti social në: Shërbimin Social -Profesional:

- Strategjia dhe plani afat-mesëm për shërbime sociale dhe familjare në Lipjan 2022-2024.
- AQH shërbime integruese shëndetsore dhe sociale në komunitet për të moshuarit me smundje kronike mbi 65 vjet.
- OFAP shërbime për fëmijët dhe familjet strehues në komunitet.
- Impakt mbështetës nga Shoqata Bëmirëse "Nëna Trezë" për personat e moshuar në nevojë për mbështetje materiale dhe shëndetësore për njëzetë të moshuar.
- Impakt mbështetës për zyren e kontakteve prind-fëmijë, nënshkrimi i MM për donacion, implementimi 2022.
- Impakti mbështetës me staf përkrahës nga UNDP, DPSF, UP.
- Impakti social në kuadër të SHAF – QPS.
- Plan-programi për shërbime sociale dhe familjare 2021.
- Plani në kornizën afatgjate buxhetor 2021-2023.
- Plani buxhetor 2021.
- Plani i prokurimit për shërbime sociale/2021
- MM me UNDP për investim kapital (krijimi i arkivës dhe zyrës së kontakteve, donacion)
- Impakt mbështetës përgjatë Covid 19 nga programi i fizibilitetit 2021, për investim përgjatë/2022 në krijimin e kushteve sipas standardeve të BE-së, në qasjen e pësonave me AK në objektin e QPS-ës.

Përparsësitë në realizimin e aktivitetave në QPS

Shërbimet Sociale gjatë kësaj periudhe raportuese kanë arritur që krahas shërbimeve të përkujdesjes familjare të ofrojnë edhe mbrojtje të fëmijëve, mbështetje sociale dhe bashkëpunim me 'Terre Des Homes', OFAP, SOS-Kinderdorf, CRPK, ShoqatenBereqeti, BIK, Save the Children, UNDP, IOM, Islamik Relif Kosova, Unicef, Qendrën e Azilit në Magure strehimore, qendra rezidenciale dhe akter tjerë vendorë e ndërkombëtar.

Mbështetja në hartimin strategjisë dhe planit për shërbime sociale dhe familjare në kuadër të politikës sociale.

Përfshirje sociale të të gjitha kategorive në nevojë për mbështetje sociale dhe materiale.

Zbatim i planit për shërbime sociale dhe familjare 2021.

Pjesëmarrje në grupe vepruese, punuese për hartimin e strategjive akteve ligjore për shërbime sociale në nivel komunal dhe të Qeverisë, konkretisht në MFPT dhe MPB.

SHTËPIA ME BAZË NË KOMUNITET

Përshkrimi i përgjithshëm

-Gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë e mirë në përgjithësi në përjashtim të disa krizave psiqike që kanë pasur disa rezidentë, mirëpo janë menaxhuar mirë. Gjithashtu ka pasur vizita dhe monitorime nga zyrtarët ligor nga QPS, vizita nga Shtëpitë tjera të komunitetit në nivel të Kosovës, vizita nga familjarët e rezidentëve, por edhe vizitat e rezidentëve në familjet e tyre.

-Vizitat nga familjarët të ndaluara një kohë për shkak të Pandemisë, pastaj janë liruar me lirimin e masave.

-Periudha Janar – Shkurt ka qenë kryerja e të gjitha obligimeve rreth borgjeve buxhetore të cilat janë bartë nga vitit 2020.

-Gjatë këti viti janë vaksinuar të gjithë rezidentët dhe stafi i Shtëpisë së Komunitetit me dy doza të vaksinave në mbrojtje të Covid-19.

-Gjatë këti viti është pranuar edhe një infermiere pasi që ishim në mungesë të një punëtori.

-Edhe këtë vit ka pas sigurimin fizik të objektit ku është lehtësuar puna për stafin shëndetësore pasi që kanë punuar vetëm në shërbim të rezidentëve duke mos pas obligime për pjesen e jashtme të objektit.

-Në muajin Tetor dhe Dhjetor janë dërguar të gjithë rezidentët e Shtëpisë së Komunitetit për qendrim në kohëzgjatje prej shtatë (7) netë dhe tetë (8) ditë në Prevallë.

Aktivitetet

-Furnizimi të mjaftueshëm të artikujve ushqimor, artikujve higjenik, furnizime me veshmbathje, furnizime medicionale, furnizim me naftë për nxemje qendrore, furnizime me naftë për veturë, furnizim me tv, furnizim me thithëse elektrike, furnizim me antifriz për nxemje qendrore, furnizim me enë dhe gjëra të imëta për kuzhinë.

DISKUTIME PUBLIKE

Diskutime publike kanë qenë të anuluara për shkak të Pandemisë. Kemi realizuar takime në platformën online kryesish. Takime të rregullta me Kryetarin dhe me ekzekutivin e Komunës për menaxhimin e situatës për shkak të Pandemisë, poashtu edhe me bordin e drejtoreve për punët e realizuara dhe problemet apo sfidat në realizmin e objektivave të punës dhe menaxhimin sa më të mirë të situatës.

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DPUMM) gjatë vitit 2021 ka kryer detyrat e caktuara me përgjegjësi dhe në përputhje me Planin vjetor të punës. Fokusi themelor i Drejtoratit ishte në fushën e planifikimit hapësinor, hartimit të dokumentacionit planor në infrastrukturë dhe në shqyrtimin e kërkesave të palëve për çështje të ndryshme urbanistike.

Në kuadër të këtyre angazhimeve themelore, duhet veçuar miratimin e Hartave Zonale të Komunës, planifikimin dhe hartimin e dokumentacionit për zbatimin e projekteve në infrastrukturën rrugore, infrastrukturën shoqërore dhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Po ashtu nga 672 lëndë të pranuara dhe 55 të tjera të bartura nga vitit 2020, janë shqyrtuar 599 prej tyre dhe ate të kategorive të ndryshme urbanistike.

Megjithatë, viti 2021 është përcjellur me vështirësi të natyrave të ndryshme, të cilat në një masë e kanë ndikuar realizimin e aktiviteteve, sidomos në fushën e trajtimit të kërkesave për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje përkatëse.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE DHE AKTIVITETEVE TË CAKTUARA

Bazuar në Planin e punës së DPUMMM për vitin 2021, veprimitaria e DPUMMM ishte e orientuar në përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat ligjore nga fusha e planifikimit, ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit. Objektivat e përcaktuara vjetore për realizim ishin:

1. Ngritura e kapacitetave me qëllim të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe efektive sipas kërkesave të qytetarëve dhe në harmoni me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit;
2. Hartimi dhe zbatimi i dokumenteve planore për projektet e planikuara për vitin 2021;
3. Ngritura e nivelit të transparencës dhe llogaridhënieve në cilësinë e shërbimeve;
4. Senzibilizimi i qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit.

Objektivi 1. Ngritura e kapacitetave me qëllim të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe efektive sipas kërkesave të qytetarëve dhe në harmoni me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit.

-Në kuadër të kësaj objektive, DPUMMM ka zhvilluar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të parashtruara nga palët, si dhe ka kryer aktivitetet të tjera të caktuara. -Gjatë vitit 2021 janë pranuar gjithsejt 672 lëndë, kurse të bartura nga viti 2020 ishin 55 lëndë. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve janë shqyrtuar gjithsejt 599 lëndë, perkatesisht 82.39% e tyre, ndërsa 128 janë bartur në vitin 2022. -Të dhënët për finalizimin e dokumentacionit teknik të projekteve sipas kategorive të caktuara është prezantuar në Tabelën 2.

Tabelën 2. Ngritura e kapacitetave me qëllim të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe efektive sipas kërkesave të qytetarëve dhe në harmoni me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit.

- Në kuadër të aktivitetave të tjera dhe të kryera gjatë vitit 2021 përfshihen edhe aktivitetet si në vijim:
- Janë përgaditur dhe plotësuar Formularët TM4 dhe TM5, sipas kërkesës së ASK-së - raportimi për ndërtimet;
 - Është plotësuar Pjetësori i kërkuar nga OSBE, Procesi i Legalizimit duke theksuar komunitetet joshumicë dhe personat e zhvendosur, Planifikimi hapësinor dhe banimi social;
 - Janë përfunduar të gjitha aplikacionet e dorëzuara nga palët për aplikim në grante të MBPZHR, për të cilat janë lëshuar Informacione urbane;
 - Është përgaditur materiali për prezantim në Kuvend për vazhdimin e afatit zbatues për Qendrën për Trajtimin e Kafshëve në Hanroc;
 - Është plotësuar Raporti për përbushjen e obligimeve nga Agjenda evropiane.

Objektivi 2. Hartimi dhe zbatimi i dokumenteve planore për projektet e planikuara për vitin 2021,

Në kuadër të kësaj objektive, DPUMMM ka zbatuar procedurat dhe ka zhvilluar aktivitetet për realizimin e detyrate të caktuara si:

- Është zhvilluar procesi i finalizimit të Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit e cila është miratuar në Kuvendin e Komunës, që konsiderohet një arritje e madhe në nivel komunal;
- Eshtë filluar hartimi i Raportit monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave të deklaruara në Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit, i cili bazohet në Planin e Veprimit;
- Eshtë realizuar trajnimi i stafit të DPUMMM në fushën e GIS-it lidhur me zbatimin praktik të GIS-it në Drejtorinë e Urbanizmit, për përdorimin e të dhënave nga Harta Zonale e Komunës së Lipjanit.
- Në kuadër të Komisionit për hartimin e programit komunal 3 vjeçar për banim në bashkëpunim me ekspert nga VORAE është hartuar dokumenti në nivel të Draftit, dhe është proceduar në MEA për verifikim te aspektit ligjor dhe të drejtën për shpalljen e dokumentit në shqyrtim publik dhe miratimin në Kuvendin e Komunës.

Objektivi 3. Ngritura e nivelit të transparencës dhe llogaridhënieve në cilësinë e shërbimeve

Në kuadër të kësaj objektive, DPUMMM ka zhvilluar aktivitetet për realizimin e detyrate të caktuara si:

-Bashkëpunimi me Drejtoratet përkatëse rreth finalizimit të të dhënave për Sistemin e menaxhimit të performancës komunale 2020.

-Eshtë zhvilluar procesi i kalkulimit, publikimit, vlerësimit të Taksës administrative, tarifës rregullative për Leje ndërtimi i dhei rrënim i përvitit 2021 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe miratimi i Rregullores nga Kuvendi i Komunës;

-Janë propozuar taksat e njëjtë përvitit 2022 të cilat janë dërguar për miratim në MMPHI;

Objktivi 4. Senzibilizimi i qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit

Në kuadër të kësaj objektive, DPUMM ka zbatuar procedurat dhe ka zhvilluar aktivitetet për realizimin e detyrate të caktuara si:

Është realizuar takimi senzibilizues dhe informues me nxënësit e shkollave fillore me rastin e 22 Prillit Dita ndërkombëtare e tokës.

KRYERJA E DETYRAVE, CILËSIA, EFIKASITETI DHE SFIDAT

- Aktivitetet e caktuara janë realizuar në një masë të konsiderueshme dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- Ndër çështjet më komplekse që janë zhvilluar gjatë vitit 2021 ishte procesi i hartimit të Hartave Zonale të Komunës dhe procesi i legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje përkatëse.
- Hartimi dhe miratimi i HZK është zhvilluar në përputhje me procedurat e përcaktuara ligjore, mirëpo edhe pse DPUMM është në fillim të zbatimit të tyre, vërehet se ka disa çështje të cilat në një masë i ndikojnë zhvillimet urbane. Megjithate një vlerësim i zbatueshmërisë së HZK duhet bërë gjatë javëve në vijim.
- Në procesin e legalizimit të objekteve pa leje ndërtimi, efikasiteti i trajtimit të kërkesave – veçanërisht atyre të kategorisë së II-të nuk ishte në nivelin e pritur. Një ndër faktorët themelor në këtë çështje ishte mungesa e personelit.

KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA

- Në kryerjen e aktiviteteve të caktuara, DPUMM ka komunikuar me palët sipas interesimit të tyre. Në faqen zyrtare të internetit janë publikuar format e kërkesave të nevojshme që parashtrohen nga palët dhe informacione të tjera nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit. Po ashtu janë të publikuara edhe aktet përkatëse nënligjore që ndërlidhen me planifikimin urban dhe çështjet e ndërtimeve.
- Njëkohësisht DPUMM ka zhvilluar edhe diskutimet publike për HZK dhe për caktimin e taksave në fushën e ndërtimit.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr	Llojet e kërkesave	Nr i kërkesave të pranuara 2021	Nr. i kërkesave të bartura nga v. 2020	Të Pezulluara	Miratuara	Refuzuara	Të bartura në sektor tjera	Në procedurë
1	Kushte ndërtimore	103	7	5	54	31	2	18
2	Leje ndërtimi	56	7	1	48	10	-	4
3	Leje rrënimë	12	-	-	9	3	-	-
4	Certifikatë perdonimi	18	2	-	12	7	-	1
5	LMK	14	2	-	16	-	-	-
6	Certifikatë legalizimi/ leje legalizimi	192	33	1	96	6	-	97
	Në listë të pritjes				25			
7	Kërksa të tjera	277	4	7	212	6	48	8
	Gjithsejt	672	55	14	472	63	50	128

Të dhënat për finalizimin e dokumentacionit teknik të projekteve sipas kategorive të caktuara është prezantuar në tabelë:

Nr	Aktiviteti	Emri i projektit	Lokacioni	Të arriturat
I.	ZBATIMI I PROJEKTEVE KOMUNALE			
A.	DOKUMENTE PLANORE			
1.	Menaxhimi i procesit dhe bashkepunim me GIZ EKK dhe EKP	Harta Zonale e Komunës	Lipjan	Miratuar me Vendimin e Kuvendit te Komunës
B.	INFRASTRUKTURË RRUGORE			

	Hartimi i i dokumentacionit teknik	Asfaltimi i rruges Marie Shllaku- tranziti	Lipjan	Finalizuar / Projekt i dorezuar
2		Asfaltimi i rrugicave në Grackë të Vjetër	Grackë të Vjetër	-//-
3		Asfaltimi i rrugicave në Bujari faza II-të	Bujan	-//-
7		Asfaltimi i Rrugicave në Hallaq të Vogel, Rufc të Ri dhe Rufc të vjetër	Hallaq	-//-
8		Asfaltim i rrugicave në Medvec	Medvec	-//-
10		Asfaltimi i rrugicave faza III-të në Gadime të Epërmë dhe Gadime të Ultë	Gadime	-//-
11		Asfaltimi i rrugicave ne Varigovc	Vargovc	-//-
13		Asfaltimi i rrugicave, trotuareve, ndriqimi publik në fsh. Bregu i Zi	Bregu i Zi	-//-
14		Asfaltimi i rrugicave në Mirenë	Mirene	-//
15		Asfaltimi i rrugicave në Sllovi faza III-të	Sllovi	
16		Asfaltimi i rrugicave në Jeten e Re (Topliqan i Ri) Faza II-të	Jata Re	
17		Asfaltimi i rrugicave ne Grackë të Vogel	Gracke	
18		Asfaltimi i rrugicave në Kraishtë	Kraishte	
21		Ndricimi publik Llugaxhi, Gadime dhe ndertimi i trotuarit me ndriqim publik Lipjan Janjevë rrreth rrotullimi.	Llugaxhi	
22		Asfaltimi i rrugicave Shalë	Shale	
23		Ndricimi publik Shalë- Kroimir	Kroimir	
24		Ndricimi publik Ribar Zllakuqan	Zllakuqan	
25		Ndertimi i rruges Gryka e Shpetimit- Kroimir	Kroimir	
26		Ndriqimi publik ne Leletiq dhe Vershevci	Leletiq	
27		Ndriqimi publik në Hallaq të Madh	Hallaq I Madhe	
28		Asfaltimi i rrugicave në Llugaxhi dhe Banullë	Llugaxhi	
29		Ndriqimi publik në Dobrave e Vogel, Lluga dhe Gllanicë	Dobrave	
30		Zgjerimi i ndriqimit publik ne Ribar te Vogel	Ribar I V.	

C	INFRASTRUKTURE TEKNIKE - MJEDIS			Finalizuar / Projekt i dorezuar
1	Ndërtimi i shtratit të lumit ne Bujari	Bujari		
2	Ndërtimi i murit mbrojtës ne lumen Janjeva			-//-
3	Ndertimi i kolektorit te ujерave te zesa Blinajë,Qylagë,Dobrajë e Madhe			-//-
4	Fasadimi,renovimi i objekteve shumë banesore Lipjan	Lipjan		-//-
5	Ndertimi i Lapidarve, Khavit Kozhani, Haradin Bajrami, Ruzhdi Shabani ne Lipjan.	Lipjan		//
6	Ndërtimi i shetitores te pishat ne Gadime	Gadime		-//-

D	INFRASTRUKURË SHOQËRORE			
1	Ndertimi i Qerdhes ne fshatin Gadime e Ulet	Gadime		
2	Renovimi i kulmit te qedhes dhe Deposë	Lipjan		
3	Rikonstruimi i dyshemesë dhe toaleteve në Gjimnazin "Ulpiana"	Lipjan		
4	Renovimi i objektit të Stomatologjisë dhe Pulmologjisë në QKMF	Lipjan		
5	Ndertimi i rrrethojave, parkingjeve, parqeve ne QMF dhe AMF	Lipjan		

DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtorati për Gjeodezisë dhe Kadastrit, për këtë periudhë raportuese ka vazduar të bëjë ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët, duke ofruar informacione dhe azhurnime të ndryshme sipas detyrës zyrtare.

STATISTIKAT

SEKTORI I GJEODEZISË

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në formë tabelare punët e kryera brenda vittit 2021

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Të pranuara	Nga viti paraprak	Gjithsej	Të miratuar	Të refuzuar	Të pezulluar	Gjithsej
559	6	565	561	4	-	565

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT NUK ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Kopje Plani	1492
2	Konsultime me pale	233
3	Marrje e produkteve	509

Në tabelen e poshtë shënuar janë paraqitur punët e kryera nga të gjitha kërkesat gjatë vittit 2021.

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I PUNËS	NR. LËNDËVE	I	SHËNIM(vërejtje)
1	Ndarje të parcelave (regjistrim i ndarjeve)	470		Në zyrë
2	Punë për shërbimin prorsor- juridik	17		Në terren
3	Rirregullim kufiri	7		Në zyrë
4	Ndërrimi kultures së parcelave	6		Në zyrë
5	Matje e objekteve	6		Në zyrë
8	Bashkim i parcelave	15		Në zyrë
9	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave	11		Në teren

SEKTORI I KADASTRIT:

Gjatë vittit 2021 janë kryer numër i madh i shërbimeve për qytetarë duke ju përgjigjur të gjitha kërkesave të tyre. Sektori i Kadastrit për vitin 2021 ka pranuar një numër të madh të kërkesave që kërkojnë procedurë administrative dhe atyre me procedim administrativ, ndër më të madhin që nga viti 2000. Të gjitha kërkesat ka marrë përgjigje branda afatit ligjor.

FORMA TABELARE E KRYERJËS SË PUNËVE

	Lloji i kërkesës	Gjithësej	Të Kryera	Në Procedurë	Të Refuzuara
1	Regjistrim i Pronës	1549	1526	18	5
2	Regjistrim dhe Fshirje Hipotekës	198	197	/	1
3	Të Tjera : Historiat, Modifikim i të dhënave, Regjistrim i Masës së Përkohshme	220	216	/	4
4	Çertifikata të pronësisë	7912	7912	/	/

5	Vërtetima për: Raste Sociale, rregullim, dokumentacioni, viza turistike,etj.	1699	1699	/	/
6	Gjithsejtë lëndë	11536	11526	/	10

DISKUTIME PUBLIKE

Takime me Qytetarë kemi pasur me rastin e shpronësimit të projektit të rrugëve: "Afrim Zhitija", "Mbreti Zog" dhe rrugës unazore që lidhë rrugët "Sadik Shala"- "Halil Metaj" dhe rrugën e re që lidhë rrugën Lipjan Janjeve ("Bajram Gashi").

SFIDAT

Gjatë këtij viti, për shkak të pandemisë COVID-19, kemi pasë ngarkesa me palët për shkak të ruajtjes së distancës sociale dhe mungesës së zyrtarëve tonë gjatë kohës sa kanë qenë të sëmur nga pandemia. Perioda e subvencioneve nga komuna dhe Ministria e Bujqësisë është ngarkesë shumë e madhe për shkak të fluksit shumë të madhë të bujqësive që aplikojnë për subvencione bujqësore.

Sfidë e veçantë është mos azhurimi i lëndëve nga ana e MMPH, për parcelat e shpronsuara nëpër të cilat kalon autostrada "Arbër Xhaferi" dhe autostrada Prishtinë-Smallushë-Gjilan-Dheu i Bardhë.

DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Sipas natyrës së punëve dhe bartësve të aktiviteteve në kuadër të sektorëve të DSHP-së, aktivitetet e kryera gjatë vitit 2021 në raport, janë paraqitur në dy forma: në formë të shkruar dhe në formë tabelare. Drejtorati për Shërbime Publike përkundër vështirësive të natyrave të ndryshme, ka arritur t'i realizojë objektivat e veta me sukses dhe në mënyrë profesionale.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Në kuadër të përgjegjësive, detyrave dhe obligimeve që dalin nga Drejtorati, të përcaktuara me Statutin e Komunës dhe aktet tjera normative në fuqi, janë kryer punë dhe aktivitete të përgjithshme sipas planit vjetor të DSHP-së, si dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga subjektitë e ndryshme drejtar DSHP-së.

Aktivitetet e përgjithshme të DSHP-së

- Pranimi, evidentimi, arkivimi dhe zgjedhja e kërkesave të arritura nga qytetarët apo institucionet tjera,
- Janë zgjidhur kërkesat e parashtruara,
- Është bërë hartimi i ndryshimit të planit të transportit të udhëtarve me autobus,
- Janë dhënë Vendime për shfrytëzim të hapësirës publike,
- Është punuar në Projekt-Rregulloren për dhënien në shfrytëzim të pronës publike dhe Projekt- Rregulloren përvendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.
- Janë dhënë 40 pëlqime sipas kërkesave të qytetarëve dhe Institucioneve,
- Është bërë shpallja publike për dhënien e licencave për autotaxit që operojnë në qytetin e Lipjanit
- Janë bërë 55 kërkesa në Drejtoratin e Prokurimit përinicim të procedurës së prokurimit për projektet e buxhetuara dhe 4 kërkesa Shërbimit Pronësoro - Juridik dhe DGJK-së për definimin e pronës. Gjithashtu është bërë kërkesë DPUMM-së përhartimin e projektëve detale përkëtë vit.
- Janë bërë kërkesa Drejtorisë së Inspektoratit për obligimin e operatorëve përlargim të paisjeve nga shtyllat e ndriqimit publik.
- Janë bërë kërkesa KEDS-it: përvendosje të pikës matëse në ormanin e ndriqimit publik në Rr. "Haredin Bajrami", furnizim me njëhsor elektrik në rastet kur nevojiten përealizimin e projekteve.
- Janë plotësuar formularët përförmancë komunale nga fusha e DSHP-së.
- Është bërë vendosja e shenjëzimit horizontal dhe vertikal në rrugët e qytetit dhe në fshatra.

- Janë bërë zhbllokime të rrjetit të kanalizimit në: Sllovi, Rufc i Ri, Rufc i Vjetër, Magurë, Tapijan, Grackë e Vogël, Kraishtë, Smallushë, Gadime P. Torinë, Gadime e Epërme, Varigovc, Dobrajë e Madhe, Vrellë e Goleshit, Bujan, Baincë, Ribar i Madh, Medvec, Janjevë dhe lokalitete tjera sipas kërkesave të palëve.
- Janë menaxhuar projektet e asfaltimit të rrugëve, ujësjellsve, kanalizimit, trotuareve, rregullimi i lumenjve si dhe projektet tjera të planifikuara për vitin 2021,
- Hartimi i paramasave dhe paralogarive sipas kërkesave të drejtorateve në nivel komunal,

Mbikqyrja e kontratave kornizë:

- Kontrata për shenjëzim horizontal dhe vertikal ku është bërë shenjëzimi horizontal dhe vertikal në rrugët e qytëtit të Lipjanit.
- Kontratat sipas lotëve të ndara për pastrimin e borës në qytet dhe në fshatra: Loti 1- për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror brenda qytetit të Lipjanit, Loti 2- pastrimi i bores në anën lindore dhe Loti 3- pastrimi i borës në anën perëndimore.
- Kontrata për pastrimin veror të rrugëve dhe trotuarve gjatë sezonit veror.
- Kontrata për mirëmbajtjen e tregjeve
- Kontrata për mirëmbajtjen e parceve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike në qytetin e Lipjanit
- Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugëve të asfaltuara dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit
- Mirëmbajtja e varrezave në Komunën e Lipjanit
- Mirëmbajtja e lumenjëve në Komunën e Lipjanit
- Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes dhe shtigjeve të bicikletave
- Mirëmbajtja e kanailizimit në qytet edhe në fshatra.

Aktivitetet në ndriçimin publik

Në rrjetin e ndriçimit publik është intervenuar në eliminimin e prishjeve dhe ndërrimin e poqave në rrugët e qytetit të Lipjanit dhe të fshatrave ku shtrihet rrjeti i ndriçimit publik.

Është intervenuar në eleminimin e lidhjeve të shkurta të kabllove në fshatin Sllovi, Janjevë, shtyllave të aksidentuara përgjat rrugës Lipjan –Magurë, qytetin e Lipjanit dhe fshatra tjera sipas kërkesave të kryetarve të fshatrave dhe policisë. Është bërë demolimi i rrjetit furnizues të ndriçimit publik për gjatë rrugës "Hajredin Bajrami" dhe në rrugën Shyqueri Hoxha është bërë ndërrimi i kabllos së djegur. Gjithashtu është intërevenuar në eliminimin e prishjes dhe ndërrimin e poqave të djegur në fshatrat Sllovi, Gadime e Ultë, Grackë e Vogël etj.

Aktivitetet e veçanta

Nder aktivitetet më të rëndësishme të DSHP-së që karakterizojnë periudhën kohore të raportimit janë:

- Kërkesë për planifikimin e mjetëve bugjetore për disa projekte të infrastrukturës mes Komunës së Lipjanit dhe MMPHI
- Është plotësuar aplikacioni për programin komunal për zhvillim të infrastrukturës socio ekonomike në komunat e Republikës së Kosovës, ku kemi aplikuar për dy projekte: rehabilitimi i rrugës Lipjan – Rubofc dhe ndërtimi i trotuarit me ndriçim publik në fshatrat Kojskë Rubofc i Madh dhe Rubofc i Vogël.
- Kërkesë MI-së për bashkëfinancim të projekteve: rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Llugaxhi dhe asfaltimi i rrugëve Banullë, Torinë, Toplijan, Kraishtë dhe Shalë.
- Kërkesë Byros Kosovare të Sigurimeve për kompenzim të dëmit të shkaktuar në shtyllat e ndriçimit publik.
- Kërkesë policisë për dërgimin e raporteve për dëmtimin e aseteve në infrastrukturë.
- Kërkesë QRA Lipjan për numrin e veturave të regjistruara gjatë vitit 2020.
- Është bërë përgatitja dhe janë plotësuar formularët për përfomancë komunale

Aktivitetet e zhvilluara në sektorin e trafikut

Në lëmin e transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, DSHP-ja sipas ndarjes së orareve dhe Planit të transportit të udhëtimit për transportin e udhëtarëve me autobus janë duke operuar 13 operatorë, ku janë të përfshira 57 fshatra me 194 vend ndalje përmarrje dhe zbritje të udhëtarëve, ku 174 prej tyre janë të shenjëzuara

Numri i përgjithshëm i operatorëve të transportit publik të licencuar që kanë operuar gjatë vitit 2021 është gjithsej 13 kompani.

Numri i auto taxi-ve të licencuar që kanë operuar në vitin 2021 në teritorin e Komunës së Lipjanit është 60, ndërsa në Aeroportin Ndërkontrollor “Adem Jashari” gjithsej janë 100, ku 31 prej tyre janë nga Komuna e Fushë Kosovës sipas Marrëveshjes së dy komunave.

- Vendparkingjet për autotaksi janë 8 lokacionë në qytet dhe Aeroporti Ndërkontrollor “Adem Jashari”. Ndërsa parkingje në hapësira publike në shirita rrugor, parkingje të bizneseve, shkollave etj janë 61 me kapacitet rreth 3172 automjete. Në kuadër të këtyre vendparkingjeve 120 vende janë të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara.

STATISTIKAT

Në vazhdim janë të paraqitura në formë tabelare aktivitetet e përgjithshme dhe të veçanta të DSHP-së gjatë vitit 2021.

Pasqyra e lëndëve të pranuara dhe të zgjidhura gjatë vitit 2021				
Nr. i kërkesave të pranuara	Të zgjidhura	Të hedhura poshtë	Në kompetencë	Në procedurë
574	540	1	28	3

Aktivitetet e DSHP-së zhvillohen sipas planit dinamik të punëve, mirëpo për tu njoftuar me problemet dhe nevojat e qytetarëve janë realizuar takime të ndryshme me qytetarë. Për të nxjerrur donacione të jashtme, nga DSHP-ja, janë dërguar kërkesa dhe projekte ideore të ndryshme Institucioneve qeveritare dhe organizatave të ndryshme joqeveritare.

Aktivitetet e DSHP-së janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr	Lloji i aktivitetit	Nr. i aktiviteteve
1	Kërkesa dhe njoftime të ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	330
2	Takime me organizata të huaja	30
3	Takime zyrtare me Ministrinë e Infrastrukturës, KEDS etj	25
4	Vizita në teren	1564
5	Pjesëmarrja në konferanca dhe trajnime të ndryshme	12
6	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderve	60

Në sektorin për menaxhimin e projekteve gjatë periudhës një vjeçare janë zhvilluar aktivitete të ndryshme si: menaxhimi i projekteve, vizita punë në teren, paramasa dhe paralogari sipas kërkesave të drejtoreve dhe komuniteteve, vertetim përshtëpi të djegur, të cilat janë paraqitur më poshtë.

Pasqyra e aktiviteteve të Sektorit për P.H.M.P		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr. i aktiviteteve
1.	Menaxhimi i projekteve	70
2.	Paramasa dhe paralogari	40
3.	Vertetime përshtëpi të djegura	3
	Vizita punë në teren (vlerësim situate)	1564

Në mënyrë tabelare janë paraqitur Investimet Kapitale për Komunën e Lipjanit të menaxhuara nga DSHP për vitin 2021

	Përshkrimi	Data e fillimit	Data e përfundimit
1	Ndërtimi i objektit të ri të administratës së Komunës Lipjan	08.11.2019	Duke vazhduar
2	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Lipjanit dhe fshatra	22.06.2020	07.05.2021
3	Asfaltimi i rrugës Shqipëria-Hajredin Bajrami	/	Duke vazhduar
4	Rikonstruimi i dyshemesë dhe toaleteve në Gjimnazin Ulipiana në Lipjan	01.08.2021	28.10.2021
5	Asfaltimi i rrugicave në Grackë të Vjetër	16.06.2020	07.07.2021
6	Ndertimi i trotuarve dhe ndriqimi publik në fshatin Dobrajë e Madhe	17.07.2020	02.06.2021
7	Zgjerimi i ndriqimit publik në Magurë faza II dhe në hyrje të fshatit Sllovi	08.10.2021	12 2021
8	Asfaltimi i rrugicave në Konjuh dhe zhavorimi i rrugës në Branesh	22.04.2021	15.07.2021
9	Asfaltimi i rrugicave në Bujari faza II	19.04.2021	27.05.2021
10	Asfaltimi i Rrugicave në Hallaq të Vogel, Rufc të Ri dhe Rufc të Vjeter	07.06.2021	05.08.2021
11	Riasfaltimi i rrugës Shen Flori dhe Skenderbeu- Lipjan	30.06.2021	01.09.2021
12	Asfaltimi i rrugicave në Medvec	30.04.2021	30.06.2021
13	Asfaltimi i rrugicave faza III në Gadime të Eperme dhe Gadme të Ulet	24.05.2021	08.07.2021
14	Ndertimi i shetitores të pishat në Gadime	28.04.2021	16.09.2021
15	Asfaltimi i rrugicave në Varigovc	15.04.2021	22.06.2021
16	Asfaltimi i rrugicave , trotuareve, ndriqimi publik - Bregu I Zi	25.04.2021	30.06.2021
17	Asfaltimi i rrugicave në Mirenë	22.04.2021	28.06.2021
18	Asfaltimi i rrugicave në Sllovi faza III	09.05.2021	11 2021
19	Asfaltimi i rrugicave në Jeten e Re Faza II	15.04.2021	08.06.2021
20	Asfaltimi i rrugicave në Grackë të Vogel	17.06.2021	25.10.2021
21	Asfaltimi i rrugëve në Lipjan Faza III	27.07.2021	Dy vjeqare - 2022
22	Ndertimi i rrugës Gryka e Shpetimit-Kroimir	24.06.2021	Dy vjeqare - 2022
23	Ndriqimi publik në Leletiq dhe Blinajë	11.05.2021	15.07.2021
24	Ndriqimi publik në Hallaq I Madh	26.04.2021	04.06.2021
25	Ndriqimi publik në Dobrajë e Vogel, Lluga dhe Gllanicë	11.05.2021	10.07.2021
26	Zgjerimi i ndriqimit publik në Ribar të Vogel	16.09.2021	/
27	Ndertimi i kolektorit të ujërave të zeza Blinajë, Qylagë, Dobrajë e Madhe	13.09.2021	Dy vjeqare - 2022
28	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gllavicë, Magurë , Dobrajë	10.05.2021	Dy vjeqare - 2022
29	Ndertimi i shtratit të lumit në Bujari	20.07.2021	02.11.2021
30	Fasadimi,renovimi i objekteve shumë banësore Lipjan- MCC	01.07.2021	Duke vazhduar-2022
31	Ndertimi i parqeve dhe rregullimi hapësirave publike	28.06.2021	Dy vjeqare - 2022
32	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit faza II Blinajë, Krojmir, Gadime, Ribar I Madh	18.10.2021	Dy vjeqare - 2022
33	Ndertimi i ndriqimit publik Lipjan deri të rrethrrotullimi Janjevë dhe Llugaxhi- Gadime	14.06.2021	07.09.2021
34	Ndertimi i trotuarit në Lipjan Rr. Bajram Gashi	04.10.2021	20.12.2021
35	Rregullimi i infrastrukturës (rrethojave, parkingjeve) në oborret e shkollave	28.12.2020	30.07.2021
36	Instalimi i nxemjeve qendore në shkollat Akllap,Qylagë dhe Resinovc	22.04.2021	16.07.2021
37	Ndertimi i shkolles në Gadime e Eperme	25.11.2020	22.09.2021
38	Ndertimi i shkollës fillore në Lipjan	25.02.2021	12 2021

39	Ndertimi i qerdhes së femijëve në Gadime	14.05.2021	12 2021
40	Ndertimi i palestres së sporteve në Lipjan	16.10.2019	Duke vazhduar
41	Ndertimi i stadiumit të qytetit të Lipjanit faza II	25.11.2020	Duke vazhduar
42	Furnizimi me energji elektrike i ndriqimit publik të shtigjet e ecjes përgjatë lumenit Sitnicë	17.05.2021	24.05.2021
43	Ndertimi i poligonit sportiv të shkolla e mesme në Lipjan	15.11.2020	26.05.2021
44	Ndertimi i qerdhes në fshatin Sllovi	01.05.2021	Dy vjeqare 2022
45	Reabilitimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ujравe të zeza në Grackë të Vjetër	30.06.2021	13.08.2021
46	Instalimi i ndriqimit publik në Baincë dhe Resinovc faza II	05.10.2021	28.10.2021
47	Ndertimi i trotuareve me ndriqim publik në Gadime rruga për Gjilan	20.11.2021 2020	Duke vazhduar Duke vazhduar
48	Shtigjet e ecjes faza II		
49	Asfaltimi i rrugicave në Rubofc, Janjevë, Akllap, Rufc, Banullë, Zllakuqan, Krojmir dhe Vërshevë	13.12.2021	Duke vazhduar-dy vjeqare
50	Ndërtimi i rrrethojave, parkingjeve, parqeve në QKMF, QMF dhe AMF	29.11.2021	Duke vazhduar
51	Ndriqimi publik në Shalë dhe Krojmir	30.07.2021	27.10.2021
52	Ndriqimi publik në Ribar i Madh dhe Zllakuqan	02.08.2021	20.10.2021
53	Ndriqimi publik në Kraishtë	02.08.2021	15.10.2021
54	Ndriqimi publik faza e II në Smallushë	27.08.2021	15.10.2021
55	Ndriqimi publik faza e II në Janjevë	23.07.2021	14.09.2021
56	Ndërtimi i rezervuarit të ujit dhe rehabilitimi i rrjetit të ujesjellësit në Janjevë	20.06.2021	11 2021
57	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Gllogovc	10.10.2021	12 2021
58	Asfaltimi i rrugës Llugë-Radevë	16.10.2020	04.10.2021
59	Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në fsh. Llugaxhi dhe asfaltimi i rrugicave. në fsh Torinë, Banulle, Topiqan, Kraishtë dhe Shale	18.05.2021	10 2021
60	Asfaltimi i rrugës Sllovi-Akllap	2020	Duke vazhduar
61	Asfaltimi i rr. Marie Shllaku dhe ndertimi i urës mbi lumin Sitnicë në Rufc të Ri	23.05.2021	Tre vjeqare
62	Asfaltimi i rrugës së Shkupit dhe rrugës së Lumit në Gadime të Ulet	19.10.2020	Duke vazhduar
63	Asfaltimi i rrugës tranzit lagja e Konjuhit deri të rruga regionale Lipjan-Janjevë	19.10.2020	Duke vazhduar
64	Asfaltimi i rrugës "Sadik Shala"	2020	/
65	Rregullimi i trotuareve, hapësirave, publike dhe ndriqim publik në fsh. Rubofc I Madh, Rubofc I Vogel dhe Kojskë	28.10.2021	Duke vazhduar
66	Reabilitimi i rrugës Lipjan-Rubofc	17.11.2021	Duke vazhduar – dy vjeqare
67	Rregullimi i kanalizimit në lagjen e komunitetit dhe asfaltimi i rrugicave në Gadime	20.08.2021	Duke vazhduar

	KONTRATAT E MIREMBAJTJEVE	Koha e fillimit	Koha e perfundimit
1	Shënjëzimi horizontal dhe vertikal në Komunën e Lipjanit	10.12.2018	10.12.2021
2	Mirëmbajtja e lumenjeve në Komunën e Lipjanit	13.12.2019	07.07.2021
3	Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonit veror në qytetin e Lipjanit	01.04.2020	15.11.2021
4	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në territorin e Lipjanit 3 lote	15.11.2021	31.03.2022
5	Mirëmbajtja e infrastrukturës, rrugëve të asfaltuara dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit	20.11.2020	19.11.2022
6	Mirëmbajtja e varrezave në Komunën e Lipjanit	27.11.2020	26.11.2022
7	Mirëmbajtja e tregjeve	26.02.2021	26.03.2023

8	Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes	13.12.2020	13.12.2022
9	Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike në qytetin e Lipjanit	01.08..2019	31.07.2022
10	Mirëmbajtja e ndriqimit publik në qytet dhe fshatra	15.04.2021	Dy vjetqare 2023
11	Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në qytet e fshatra	05.06.2021	04.06.2023

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetar)

DSHP-ja gjatë vitit 2021 ka mbajtur takime të ndryshme me qytetar, që kan paraqitur kërkesa individuale, grupore dhe nga përfaqësuesit e vendbanimeve të caktuara:

- Janë mbajtur takime me asociacionin e komunave dhe GIZ-in për fushën e menaxhimit të mbeturinave,
- Vizitë në teren së bashku me ekipin dhe GIZ-in për identifikim dhe inqizimin e deponive ilegale të mbeturinave,
- Takime me MCC – Banka Botërore dhe qytetarët lidhur me projektin fasadimi i objekteve shumë banesore në qytetin e Lipjanit.
- Vizita në teren së bashku me kompaninë projektuese për hartimin e projekteve për renovim të shkollave dhe projekteve tjera të infrastrukturës të përcaktuara sipas planifikimit për vitin 2021.

SFIDAT

- Kërkesa të shumta për investime në lokalitete të ndryshme
- Mungesa e inçizimeve digitale të rrjetit rrugor, ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Efektet e pandemisë Covid-19 në realizimin e projekteve- vonesa në implementim të projekteve

REKOMANDIME

- Mbështetje më e lart buxhetore për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore, hapësirave publike, ndriqimit publik.
- Incizimi i rrjetit rrugor, ujësjellësit dhe kanalizimit në formë digitale.

DREJTORATI I PROKURIMIT

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtorati i Prokurimit, ka një shkallë të lartë të përgjegjësisë për të sigruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondevë publike dhe burimeve publike dhe menaxhimit sa më të mirë të fondevë pulike. Në këtë Raport, janë të përfshira të gjitha aktivitetet e prokurimit që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Lipjanit ka zhvilluar gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetmujore, për t'gjitha kategoritë e shpenzimeve, për mallra, shërbime dhe punë.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë kësaj periudhe raportuese, shenojmë këto aktivitete të Prokurimit:

- Zhvillimi i procedurave të prokurimit nga kërkesat e njësive kërkuese,
- Ankande Publike
- Hapje dhe vlerësim të tenderëve dhe Ankandeve Publike
- Kërkesa për referencë nga OE për punët e kryera.
- Në AQP, kemi dërguar Planin e Prokurimit për Vitin Fiskal 2021,
- Në KRPP, kemi dërguar Raportin Vjetor të Kontratave të nënshkruara Publike për Vitin 2020

AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR PUNË		
Nr	Lloji i dokumentit	Lënda e prokurimit / grupei
1	613 021 060 521	Ndërtimi i rrethojave, parkingjeve, parqeve ne QKMF, QMF dhe AMF

2	613 021 088 521	Reabilitimi i rrugës Lipjan-Rubovc
3	613 021 087 521	Rregullimi i trotuareve, hapsirave publike dhe ndriqimi publik në fshatin Rubofc i Madh, Rubofc i Vogël dhe Kojskë
4	613 021 086 521	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit faza II, Vërshefc, Krojmir, Gadime, Ribar i Madh
5	613 021 084 521	Ndërtimi i trotuarit me ndriqim në rrugën për Gjilan në Gadime
6	613 021 083 521	Zgjerimi i ndriqimit Publik në lagjet e fshatit Magure faza II, dhe në hyrje të fshatit Sllovi
7	613 021 082 521	Rregullimi i kanalizimit në lagjen e komunitetit pakicë dhe asfaltimi i rrgicave ne fshatin Gadime
8	613 021 081 521	Instalimi i ndriqimit publik ne Baicë dhe Resinovc faza II
9	613 021 080 521	Ndërtimi i trotuarit në Lipjan Rr.Bajram Gashi
10	613 021 078 536	Furnizimi dhe montimi i skajoreve ne fushen ndihmese ne Dobrajë
11	613 021 077 536	Nivelizimi i fushës së futbollit Dobrajë e Madhe
12	613 021 039 521	Renovimi i shtepise se komunitetve
13	613 021 069 536	Rregullimi i rrjetit të ujit në QMF-Magure dhe QMF-Janjevë
14	613 021 068 521	Asfaltimi i rrugëve në Lipjan faza III
15	613 021 062 521	Ndërtimi i rezervuarit të ujit dhe rahabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Janjevë
16	613 021 063 521	Ndërtimi i rrgicave në fshatin Gllogovc
17	613 021 061 521	Lot 1 Ndriqimi publik ne Kraishtë;
		Lot 2 Ndriçimi publik faza dytë në Smallushë
		Lot 3 Ndriçimi publik në faza dytë Janjevë;
		Lot 4 Ndriqimi publik në Shalë dhe Krojmir;
		Lot 5 Ndriqimi publik në Ribar dhe Zllakuqan;
18	613 021 059 521	Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrjeteve të kanalizimit në qytet dhe fshatra
19	613 021 052 521	Reabilitimi i rrjetit te kanalizimit atmosferik dhe ujrale te zeza ne Grackë te Vogël
20	613 021 031 521	Ndertimi i parqeve dhe rregullimi i hapsirave publike
21	613 021 045 521	Ndërtimi i rrugës Gryka e Shpëtimit Krojmir
22	613 021 048 521	Renovimi i banjove ne SHFMU Ibrahim Banushi – Shalë
23	613 021 037 521	Ndërtimi i kolektorit të ujrale të zeza Blinajë, Qylagë, Dobrajë e Madhe
24	613 021 040 536	Furnizimi me energji elektrike i ndriqimit publik shtigjet e ecjes per gjat Lumit Sitnica
25	613 021 036 521	Ndertimi i ndriqimit publik në rrugen Llugaxhi-Gadime, Gadime e Ulet si dhe ndertimi i trotuarit në rrugën Lipjan-Rrethrrrotullimi Janjevë
26	613 021 025 521	Ndërtimi i bazamenteve përvendosjen e lapidarve dhe pllakës përkujtimore
27	613 021 033 521	Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi lumin Sitnica në Rufc të Ri
28	613 021 032 521	Asfaltimi i rrgicave në Sllovi faza e III
29	613 021 030 521	Ndërtimi i shtratit të Lumit në Bujari
30	613 021 023 521	Rikonstruimi i dyshemes dhe toaleteve në Gjimnazin Ulpiana
31	613 021 027 521	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gllavicë, Magure, Dobrajë
32	613 021 029 521	Riasfaltimi i rrugës Shën Flori dhe Skenderbeu në Lipjan
33	613 021 026 521	Asfaltimi i rrgicave në Gadime të Eperme dhe Gadime e Ultë faza e III-te
34	613 021 019 521	Renovimi i objektit te Stomatologjisë dhe Pulmologjisë në QKMF
35	613 021 024 521	Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në fshatin Llugaxhi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat Torinë, Banullë, Topliqan, Kraishtë dhe Shalë
36	613 021 022 521	Asfaltimi i rrgicave, trotuaret dhe ndriqimi publik ne Breg te Zi
37	613 021 021 521	Asfaltimi i rrgicave në Hallaq të Vogel, Rufc të Ri dhe Rufc të Vjetër
38	613 021 018 521	LOT 1- Asfaltimi i rrugëve në Mirenë LOT 2 - Asfaltimi i rrugëve ne Grackë të Vjetër
39	613 021 016 521	Asfaltimi i rrgicave në Bujari faza e II-të
40	613 021 015 521	LOT 1 - Asfaltimi i rrgicave në Jeta e Re- Faza e II-të
		LOT 2 - Asfaltimi i rrgicave në Varigovc
		LOT 3- Asfaltimi i rrgicave ne Medvec
41	613 021 004 521	Mirëmbajtja dhe rregullimi i ngrohjes qendrore ne objektet e IEA

42	613 021 013 521	Instalimi i nxemjeve qendrore në shkollat, Akllap, Qylagë dhe Resinovc
43	613 021 010 521	Ndërtimi i shetitores te pishat në Gadime
44	613 021 011 521	Asfaltimi i rrugicave në Konjuh dhe zhavorrimi i rrugës në Branesh
45	613 021 006 521	Llot 1- Ndertimi i qerdhes se femijeve ne fshatin Gadime Llot 2- Ndertimi i qerdhes se femijeve ne fshatin Sllovi
46	613 221 007 521	Llot 1 - Zgjerimi i ndriçimit publik në Ribar të Vogël Llot 2- Ndriçimi publik në Hallaq të Madh; Llot 3 - Ndriçimi publik në Dobrajë e Vogël, Llugë dhe Gllanicë; Llot 4- Ndriçimi publik ne fshatin Leletiq dhe Vërshevc;
47	613 020 044 521	Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan-Ritenderim

AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR FURNIZIME

Nr	Lloji i dokumentit	Lënda e prokurimit / grupi
1	613 021 091 121	Furnizim me veshëmbathje për rezidentët e Shtëpisë me bazë në Komunitet-Lipjan
2	613 021 079 136	Furnizimi me rere speciale per barin sintetik ne Dobrake
3	613 21 076 136	Furnizimi me pompa shytëse
4	613 021 075 121	Furnizimi me pelet për disa shkolla
5	613 021 074 136	Furnizimi i disa bibliotekave shkollore me tituj librash të autorëve të ndryshëm
6	613 021 073 126	Furnizimi me kosë bari
7	613 021 071 121	Furnizimi me qanta për mjek dhe shërbimin e urgjencës të kompletuara me paisjet bazike
8	613 021 028 121	Furnizimi dhe montimi i xhamave ne Intitucionet Edukativo Arsimore dhe institucionet tjera komunale -Ritenderim
9	613 021 066 136	Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime
10	613 021 058 111	Furnizimi i aparaturave mjeksore për QKMF-Lipjan
11	613 021 056 121	Furnizimi me barna dhe material medicinal për nevojat e QKMF-së
12	613 021 055 136	Furnizim me inventar për SHFM. Vllëzërit Frashëri dhe SHMP. Adem Gllavica -Lipjan
13	613 021 057 111	Furnizimi dhe montimi i serrave 50m ² per fermeret e K.Lipjan
14	613 021 047 121	Furnizimi me material laboratorik për QKMF-Lipjan-Kontratë kornizë
15	613 021 046 121	Furnizimi me materiale te ndryshme per nevojat e KK LIPJAN
16	613 021 041 121	Furnizimi me material higjenik ne QKMF-Lipjan, shtepine e komuniteteve si dhe te gjitha IEA-te komunale - kontratë dy vjeqare
17	613 021 053 121	Furnizimi me material stomatologjik
18	613 021 044 121	Furnizimi i te gjitha IEA me vegla (paisje) te ndryshme pune - kontratë dy vjeqare
19	613 021 038 121	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative
20	613 021 043 121	Furnizimi me material për mirëmbajtjen të Objekteve në të gjitha IEA.
21	613 020 099 121	Furnizimi me shporta për mbeturina materiali plastikë, me vëllim 120 litra
22	913 021 017 136	Furnizimi me pem e perime
23	613 021 008 121	Furnizimi me mallrat per mbjelljet pranverë-vjeshtë (per periudhen 2021-2023)
24	613 020 100 121	Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore.

AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR SHËRBIME		
Nr	Lloji i dokumentit	Lënda e prokurimit / grupi
1	613 021 095 221	Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror (fshirja e rrugëve) në Komunën e Lipjanit - Zona urbane e qytetit.
2	613 021 094 221	Mirëmbajtja e lumenjëve në Komunën e Lipjanit
3	613 021 093 236	Renovimi i hapsirave të brendshme në objektin me bazë në komunitet

4	613 021 086 236	Shërbimet e akomodimit dhe fjetjes se rezidentëve të Shtëpisë së Komunitetit gjatë muajit shtator - totor
5	613 021 072 236	<p>Shërbimi me binë dhe pjesë tjera përcjellëse për ditën e diasporës-Ritenderim</p> <p style="text-align: center;">Transporti i nxënësve në relacionet sipas Lot 1 deri Lot 16</p> <p>Lot 1 Transporti i nxënëseve nga fshati Dobrave e Vogel, Gllanicë dhe Llugë deri te shk. "Dy Deshmoret" Dobrajë e Madhe dhe anasjelltas - 2 ndrrime,</p> <p>Lot 2 Transporti i nxënëseve nga fshati Hallaq i Madh dhe Gracke e Vjetër deri te shk. "Ismail Luma" Lipjan 2 ndrrime,</p> <p>Lot 3 Transporti i nxënëseve nga fshati Qellapek deri te shk "Emin Duraku" Banulle,</p> <p>Lot 4 Transporti i nxënëseve nga Lagjeja e Puturëve deri te shk. "Hasan Zuko Kamberi" Sllovi,</p> <p>Lot 5 Transporti i nxënëseve nga fshatrat Ribar i Vogel dhe Rufc i Vjetër deri te shk. Migjeni Rufc i Ri,</p> <p>Lot 6 Transporti i Nxënësve nga fshatrat Teqe dhe Metallac deri te shk."Shtjefen Gjeqovi" Janjeve,</p> <p>Lot 7 Transporti i Nxënësve nga fshati Plitkoviq deri te SHFMU."Zenel Hajdini" Gadime e Eperme- 2 ndrrime</p>
6	613 021 067 211	<p>Lot 8. Transporti i nxansave nga fshati Varigovc deri te shk. "Skenderbeu" Kraishte,</p> <p>Lot 9. Transporti i nxansave nga fshati Mirene deri te shk."Haradin Bajrami" Magure,</p> <p>Lot 11 -Transporti i Nxënësve nga fshati Vrelle deri te shk."Zenel Hajdini" Gadime e Eperme</p> <p>Lot 12-Transporti i nxënësve nga fshati Breg i Zi deri te shk. "Nezë Bujani"- Bujan dhe anasjelltas,</p> <p>Lot 13- Transporti i nxënësve nga Lagjët Karpuzve, Drenica, Hetimi, Shala, Ademi dhe Pojata deri te shk. "Ibrahim Banushi"-Shalë dhe anasjelltas,</p> <p>Lot 14- Transporti i nxënësve nga Fshati Zllakuqan deri te shk. "Kadri Beba"- Ribar i Madh dhe anasjelltas</p> <p>Lot 15- Transporti i nxënësve me nevojat veçanta ne relacionin Sllovi, Ribar i Madh, Zllakuqan deri te shk. "Haredin Bajrami" - Magure dhe anasjelltas,</p> <p>Lot 16-Transporti i nxënësve me nevojat veçanta ne relacionin Shalë, Dobravë e Vogel, Dobravë e Madhe dhe Magurë deri te SHFMU "Haredin Bajrami" - Magure dhe anasjelltas</p>
7	613 021 064 536	Renovimi i nyjeve sanitare në tualetet në QPS
8	613 021 054 221	<p>Llot 1- Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve në QKMF-Lipjan,</p> <p>Llot 2 -Mirëmbajtja dhe riparimi i aparaturave mjekësore në QKMF-Lipjan-Kontratë kornizë</p>
9	613 021 049 221	Mirembajtja e teknologjisë informative
10	613 021 042 236	Transporti i nxënsëve nga Lagjëja Karpuzi, Drenica, Hetemi, Shala, Ademi dhe Pojata deri te SHFMU "Ibrahim Banushi" - Shalë
11	613 021 020 236	Organizimi i punëtorisë dy ditore me zyrtarët e raportimit për SMPK
12	613 021 014 221	Asgjësimi i mbetjeve mjekësore të mprehta dhe jo të mprehta, medikamenteve mjekësore me afat të skaduar, të prodhua nga Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor në Lipjan - Kontrate 3 vjeqare
13	613 021 009 536	Mbjellja e barit në stadionin Dobravë e Madhe
14	613 021 012 221	Mirembajtja e ndriqimit publik ne Qytet dhe fshatra
		Llot 1 -zona Qender Lipjan, Konjuh
		Llot 2 - zona perendimore
		Llot 3 -Zona Lindore
15	613 021 005 221	Shërbime hoteliere në byfenë e ndërtës së Komunes së Lipjanit
16	613 021 002 235	Servisimi i ngrohjes qendrore në SHF Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan dhe SHFMU "Emin Duraku" - Banullë
17	613 021 003 221	Shërbimet e sigurimit te automjeteve zyrtare ne pronësi te komunës së Lipjanit
18	613 020 001 221	Mirëmbajtja e tregjeve në Komunën e Lipjanit

--	--	--

ANKANDE PUBLIKE

	Emërtimi	Lloji i procedurës	Vlera e parashikua	Data e vendosjes
1	Shitja e mases drunore te pa prera- të cilat gjenden ne vendin e quajtur Lugu i Kukës në Gadime	Ofertave publike të mbyllura	2,588.60	15.09.2021
2	Shitja e prodhimeve bimore - Grurit	Ofertave publike të mbyllura	1,600.00	08.07.2021

STATISTIKAT

1	Aktivitete të Prokurimit për punë	47
2	Aktivitete të Prokurimit për shërbime	18
3	Aktivitete të Prokurimit për furnizime	24
4	Ankand Publik	2

SFIDAT

- Për shkak të përhapjes së pandemisë me koronavirusin Covid 19, Drejtoria e Prokurimit ka punuar me staf të reduktuar
- Ankesat e OE për rishqyrtimin e vlerësimit të ofertave nga Drejtoria e Prokurimit si dhe tek Organi Shqyrtues i Prokurimi (OSHP).

REKOMANDIMET

Edhe gjatë kësaj periudhe raporuese, detyrë parësore e Dreitorisë së Prokurimit do të jetë ulja e kostos së shpenzimeve për gjitha llojet e shpenzimeve, realizimi me kohë dhe në mënyrë cilësore i gjitha kërkuesave të njësive kërkuese, si dhe identifikimi real dhe vlerësimi i nevojave, në bashkëpunim të ndërsjellët me shfrytëzuesit e gjitha shtyllave të buxhetit.

Kujdes i vazhdueshëm do ti kushtohet edhe implementimit të kontratave të lidhura në vitet paraprake e të cilat sipas planifikimit dhe planit dinamik duhen të përfundohen në vitet vijues, me thekes të veçant kontratat e punës.

QËSHTJE TË TJERA

Një bashkëpunim të ngushtë, Drejtorati i Prokurimit do ta ketë edhe me AQP-në, për të ofruar informata të nevojshme për te, kur AQP-ja në planin e saj ka udhëheqjen e prokurimeve të centralizuara për nevoja të autoriteteve kontraktuese të nivelit lokal ose atij qendror, ashtu sikurse është rregulluar me dispozitat e nenit 94 dhe 95 të LPP-së.

Drejtorati do të bashkëpunoj ngusht edhe me USAID-in dhe organizatat e caktuara jo qeveritare mbi bazën e marrëvehjes së bashkëpunimit e lidhur mes Komunës së Lipjanit dhe USAID-it, e cila në fokus ka bashkëpunimin, ofrimin e ndihmës dhe monitorimin e aktiviteteve të punës në Komunën e Lipjanit, me theks të veçantë trajnimin e stafit për kryerjen me sukses të aktivitetetve të punës, hapje tenderëve, vlerësim dhe menaxhim të kontratave dhe punë tjera të nevojshme.

DREJTORATI PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Bashkëpunimi profesional: Janar - Dhjetor 2021

- Përforcimi i shërbimeve këshillimore të organzuara nga MBPZHR.

- Avancimi i Qendrës informative për Shërbime Këshillimore bujqësore, poashtu në kuadër të Sherbimeve Këshillimore janë organizuar trajnime me tema të ndryshme për bujqësi.
- Pjesëmarrje në punitoninë e organizuar nga MBPZHR, Lidhur me Strategjinë e subvencionimit.
- Kemi mbajtur takime me grupe të fermerëve, për të sqaruar procedurat e drejta të aplikimit për grante dhe subvencione. Përveq takimeve me fermer përinformatat lidhur me aplikimet për subvencione i kemi plasuar edhe në webfaqen zyrtare të komunës.
- Përshkak të pandemisë nga Covid 19 dhe pamundësisë që takimet të mbahen me prezencë fizike, një pjesë të madhe të takimeve kemi realizuar onlinje.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Subvencionet Komunale

Gjatë vitit 2021 janë shpërndarë gjithësej 440 serra në sipërfaqe prej 0.50m² të cilat kanë kaluar në pronësi të përfituesve. Po ashtu, brenda mundësive buxhetore të limituara që kemi pasur, kemi përkahur disa fermerë për dëmet e shkaktuara në sektorin e bujqësisë.

Takime me organizata:

Kemi pasur takime me disa Organizata si ajo me IADK, Organizata IKC, Shoqata dhe me kompani bujqësore. Po ashtu në kuadër të Grupit Lokal të Veprimit (GLV) janë majtura trajnimet temë të ndryshme për fermerë.

Memorandum-Bashkëpunimi

Nga Memorandumet e bashkëpunimit në mes të Komunës dhe Organizatës IADK-së, në këtë vit janë mbështetur 18 fermerë të sektorit të perimtarisë, pemtarisë dhe blegtorisë, si dhe 3 studentë të Fakultetit të Bujqësisë dhe të Teknologjisë Përpunuese me pages. Po ashtu nga ky bashkëpunim janë pisur me certifikata 28 fermerë nga IADK si dhe është bërë perzgjedhja e fermerës perfituse të Njesisë perpunuse të qumështit.

Vlera e pergjithshme e këti bashkpunimi Komunë - IADK është **73.450.00 €**.

STATISTIKAT

Planifikimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore 2021

Fushata e të mbjellurave pranverore ka filluar me kohë dhe janë realizuar mbjelljet pranverore me sukses.

Planifikimi dhe realizimi i të mbjellurave pranverore i paraqitur në form tabelare:

Forma tabelare

Nr	KULTURAT	Sipërfaqja e planifikuar në /ha	Sipërfaqja e realizuar në /ha
1	Misër pë kokërr	1050	980
2	Misër me fasule	170	113
3	Misër i gjelbër	800	720
4	Elb	44	28
5	Tërshër	105	122
6	Bimë foragjere	55	35
7	Luledielli	10	4
8	Perime	195	175
9	Patate	120	105
10	Fasule monokultur	22	17
Gjithsej		2571/ ha	2299/ ha

Sipërfaqet e mbjellura me kultura vjeshtore për vitin 2021

Kultura bimore	Mbjelljet vjeshtore /ha
Grurë	4870/ha
Elb vjeshtorë	17/ha

Thekér	4/ha
B. foragjere	21-ha
Gjithsej	4472/ha

Fushata e korrje-shirjeve

Në bazë të përbledhjes së shënimeve nga terreni Komisioni i formuar nga Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari i cili ka percjellur edhe fushaten e korrje-shirjeve në Lipjan konstaton me sa vijon:

Me datë **09.07.2021** ka fulluar fushata e korrje – Shirjeve. Komisioni i korrje - Shirjeve ka konstatuar se kjo fushatë ka përfunduar me sukses në komunen e Lipjanit me datë **02.08.2021**.

Depot për grumbullimin e drithërave kanë qenë të përgaditura mirë ku paraprakisht është bërë D.D.D. (Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi) dhe kapaciteti i tyre ka qenë i mjaftueshëm për grumbullimin e gjithë sasisë së drithërave në territorin e Komunës së Lipjanit

Shumica e Mullinjëve janë të paisur me sillos (hambar) për pranimin e drithit me çka sigurohen kushte të mira për ruajtjen e grurit.

Në kuadër të sektorit të Pylltarisë kemi keto të dhëna

Pasqyrë e fletëparaqitjeve për kundërvajtje

Pasqyrë e fletëparaqitjeve për kundërvajtje	Nr. i fletëparaqitjeve	Vëllimi i dëmit në m ³	Vlera e dëmit në €
Viti 2021	195	324.13	44.225.00

Pasqyrë e fletëparaqitjeve penale.

Pasqyrë e fletëparaqitjeve penale	Nr. i fletëparaqitjeve	Vëllimi i dëmit në m ³	Vlera e dëmit në €
Viti 2021	16	44.47	6.067.00

Seancat Gjyqësore në Gjykatat për Kundërvajtje dhe Penale (ballafaqim me palë)

Kundërvajtje	Penale	Gjithësejt
8	24	32

Aktvendimet nga Gjykatat për Kundërvajtje dhe Komunale.

Pozitive	Pezulluara	Negative	Dëmi në m ³	Dënim i gjykata në €
127	7	1	314.97	47.323.00

Në sektorin e pylltarisë është organizuar puna rreth prerjes së pyjeve në pyjet private sipas kërkesave të palëve të cilët i kemi paisur me damkim dhe fletëpërcjellje për transportimin e masës drusore nga pyjet private.

Kërkesat për prerje në Pyje Private

Të pranuara	Të Shqyrtuara	Të refuzuara	Në shqyrtim	Damkim në cung m ³	Damkim në Stivë m ³
12	10	0	2	664.46	197.80

Nga bllokat për Pyje Private janë shfrytëzuar 84 fletë përcjellje dhe janë përcjellë 197.80 m³ dru zjarri.

Në terren të Gadimes ngastra nr.114 vendi i quajtur Lugu i kukës kemi damku pisha të thata: 174.91m³ dhe 1.60m³ të cilat jan tharë nga smundjet dhe demtusit (instektet) dhe jan shitur me ankand publik.

Në vitin **2021** në teritorin e komunës së Lipjanit janë pyllzuar **7/ ha** me fidane të llojit pishë e bardhë. Pyllzimi është bërë në terinen e Sllovisë vendi i quajtur: **Kodra e Sllovisë** dhe **Quka e Sllovisë**

Pasqyrë e regjistrimit të tereneve pyjore

Bazuar në Ligjin e Pyjeve të Kosovës kemi bërë edhe regjistrimin e tereneve ku janë shkaktuar dëme nga dëmtuesit illegal të pyjeve.

Nr	Dëmi i konstatuar në m ³	Dëmi i arsyetuar në m ³	Dëmi pa arsyetuar në m ³
1.	348.76	271.15	77.26

Po ashtu kemi pergaditur dhe realizuar Planin operativ për kontrolla të përbashkëta me Policin. Këto kontrolla kanë qenë të orjentuara: në tregje, rrugë pyjore dhe jo pyjore, në terrenin e komunës së Lipjanit, dhe kanë qenë gjithësej 185 kontrolla.

SFIDAT

Numri i madh i kërkesave për perkrahjen e fermerëve në lami të ndryshme që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe mundësia e kufizuar për ti përkrahur të gjithë aplikuesit.

Ballafaqimi i vazhdueshem i pylltarëve me dëmtues të pyjeve

REKOMANDIME

Rritja e buxhetit brenda munësive për subvencionim të bujqësisë. Kjo do të ndikonte që t'i përmbushim kërkesat në një masë më të madhe, qoftë me paisje të ndryshme bujqësore, plehra si dhe trajnime profesionale nga keshilltarët e ndryshem të bujqësisë.

DREJTORATI MBROJTJE DHE SHPËTIM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIT.

Drejtatori për Mbrojtje dhe Shpëtim ka vazduar të kryej punë dhe detyra që dalin nga Ligji për mbrojtje nga fatkeqësië natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, ligji për mbrojtje nga zjarret etj.

DMSH në vitin 2021 ka kryer aktivitete dhe punë në bazë të Planit vjetor të punës së DMSH-së, dhe obligimeve që dalin nga rregulloret e Qeverisë së Republikës të Kosovës për hartimin dhe vlerësimin e rezikut dhe rregulluren për përbajtjen dhe procedurat e hartimit të Planit të reagimit emergjent. Po ashtu u jemi përgjigjur thirrjeve për intervenime emergjente të ndryshme në teren: zjarre fushore, zjarre malore, zjarre në shtëpi banimi dhe në objekte të ndryshme, aksidente trafiku apo aksidente tjera, vërshime etj.

Për çdo muaj kemi përgaditur rapor të rregullt ku janë paraqitur të gjitha aktivitetet dhe punët e kryera, si dhe sfidat dhe nevojat. Gjithashtu raportime të rregulla javore në takimin e bordit të drejtorëve.

Në fillim të vitit, në muajin janar jemi ballafaquar me reshje të shumta atmosferike të cilat kan kaluar kuotën maksimale të reshjeve dhe për pasojë është vërshuar pjesa lindore e teritorit të komunës së Lipjanit. Këto vërshime shkaktuan dëme të konsiderueshme në infrastrukturë, në bujqësi si dhe në amvisëri, prandaj edhe u kriju komisioni që ka vlerësuar këto dëme.

Përveq drejtorateve dhe sektorëve brenda institucioneve komunale, ne kemi vazduar të kryejm punë dhe detyra duke qenë në bashkëpunimë edhe me institucionet tjera të cilan ndërlidhen me sigurin si: Agjpcionin për menagjim të

emergjencav, Policinë e Kosovës, si dhe me gjithë qytetarët të cilët kanë dhënë një kontribut të veçant në identifikimin e kanosjeve dhe incidenteve të ndryshme, e që kanë mundësuar intervenim më efikas dhe të drejtëpërdrejtë në rastë të incidentit apo fatëkeqësisë.

Kemi vazhduar me mirmbajtjen e objektit dhe teknikes intervenuese të Njësisë Profesionale të zjrrfiksëve duke kryer servisimin e rregullta te makinerisë intervenuese, regjistimin e tyre, furnizimin me derivate, riparimin e tyre në rast të ndonjë defekti, ndrrimin e gomave për sezonin veror dhe dimëror, mbulimin e shpenzimit për komunal si p.sh ujë, mbetuarina, shpenzime të rrymes për stacionin e zjarrfiksëve, furnizim me material shpenzues për nevoja të stacionit , furnizim me material higjenik etj.

Kemi marr pjesë në të gjitha takimet e rregullta të KKSBB-së dhe kemi pergaditur raport të cilin e kemi paraqitur para anëtarëve të këtij këshilli.

STATISTIKAT

Intervenimet nga NjPZSH për vitin 2021

Nr.	Intervenime në teren	Numri i intervenimeve
1.	Zjarre	450
2.	Shërbime	32
3.	Shpëtime	27
4.	Intervenime teknike	44
	Gjithsej	553